Prill-Maj-Qershor 2006 • Rebiul Evvel-Rebiul Ahar-Xhumadul Ula 1427 • Numri: 3 • 150 Lek - 1 Euro - 60 DEN

ETIKA

Tremujore

Shembull i shkëlqyer

Si u bënë muslimanë?

Personaliteti i Muhammedit (s.a.s.)

Roli i sunnetit në formimin e Personalitetit Islam

Përse e studiojmë jetën e Profetit Islam?

Sa e duam ne atë?

Edukimi i njeriut

PERSONALITETI I PROFETIT,

shembull i përsosur

Viti: I Numri: 3
Prill-Maj-Qershor 2006
Rebiul Evvel-Rebiul Ahar-
Xhumadul Ula 1427

Botoon
SH. E. A. VËSHTRIMI:
Sead MORINA

Kryeredaktor:
Sead MORINA

Përkthyes:
Fatmir Sulaj
Alija Barlovic
Adem Pizga
Tasim Darsi
Ilir Hoxha
Luan Afmataj
Roland Çarçiu

Lektor dhe korrektor:
Ermal Nurja

Marketing:
Sead MORINA

Këshilli redaktues:
Sead Morina
Abdusamed Zeqiri
Muhamet Ali Yildirim
Ramadan Uka
Shuajb Bashan
Arif Qerazi
Idris Keskin
Irfan Islami
Arjan Ymeraj

Shtyp: Shtëpia Botuese ERKAM
Tel: +90 212 671 07 00

Dizenjo - Grafik:
Rasim SHAKIROV

Ngjyra: IBS Grafik
Tel: +90 216 342 85 99

Adresa:
Dardania Rr. banesore 4/7-d-6
kati përdhes banesa Nr. 1 Prishtinë
Tel: +381 385 423 85

Adresa e përfaqësisë në Shqipëri:
Shoqata Vëllazërore Humanitare
Kulturore Stamboll
Bulevardi Zogu I pall. 97
ap. 21 shk. 2 Tiranë / Albania
Tel: +355 424 81 12

Çmimi: 60 DN / 1 Euro / 150 Lek

Për artikuj:
e-mail: veshtrimi@hotmail.com
revistaetika@gmail.com
etika05@yahoo.com.tr
etika_05@hotmail.com

Abonimet:

Abonimi vjetor për Shqipërinë, 600 Lekë; për Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi, 4 €.
Për Evropën, 10 € ose vlerën e saj. Ndërsa për shtetet e tjera, çmimi vjetor, 15 $.

Të interesuarit, pasi të njoftojnë qendrën e revistës, pagesën mund ta bëjnë tek numrat e llogarisë (IBAN):
në $:
TR910020800058007092040002
në € :
TR640020800058007092040003
në CHF :
TR370020800058007092040004

Të dashur lexues!

بسم الله الرحمن الرحيم

Eshtë kënaqësi të takohesh sërish me ty, lexues i nderuar i rradhëve tona një herë në tre muaj përmes botimit të kësaj reviste, e cila i ka vënë synim vehtvetes që të mund ta pasuroj sadopak botën e botimeve islame për trevat shqiptare, më saktë, për të gjithë shqipfolësit ngado që ndodhen.

Këtë herë gëzimit të takimit tonë ju shtua edhe një tjetër gëzim, hareja që na pushton të gjithëve me rastin e Mevludit, ditëlindjes së profetit tonë të dashur, Muhammedit (a. s.). Prandaj edhe ne këtë numër të revistës tonë kemi menduar t'ia kushtojmë kësaj ditëlindjeje, që zë një vend të veçantë në zemrat e çdo besimtari, pasi në këtë ditë lindi i dërguari i fundit i Allahut, mëshirë për mbarë botët, udhërrëfyesi ynë deri në ditën e gjykimit. Madhështia e figurës së tij konsistonte në thjeshtësinë e cila e karakterizonte atë në çdo moment të jetës së përditshme. Atij do ti shpallej edhe zbulimi i fundit hyjnor i mishëruar në librin e shenjtë të Allahut, Kur'anin.

Në udhën e jetës së tij, teksa shfletojmë faqe nga historia islame, secili nga ne mund të gjej një pjesë së jetës së tij, secili mund të thotë se Muhammedi (a. s.) kishte qënë dhe kishte jetuar edhe ato që ai po përjeton. Muhammedi (a. s.) kishte jetuar vetminë e të qënit jetim, kishte punuar edhe si çoban, tregtar. Ai kishte qënë një bashkëshort i mirë. Kishte përjetuar gëzimin e fëmisë, por edhe shijen e hidhur që lë humbja e tyre në shpirtin e prindit. Ai kishte qënë komandant, bashkëluftëtar, prijës shteti, por deri atë ditë që i kishte mbërritur ishte përballur me përbuzjen, nënçmimin, dhunën, shpifjen, mjetet e ashpra që i kishin vënë përpara bashkëqytetarët e tij që ta pengojnë nga misioni i lartë hyjnor. Por ai me shembullin e tij na mësoi se mund të kapërcejmë të gjitha këto me mbështetjen te Allahu, pa u larguar nga parimet e shenjta. Ky është shembulli të cilit i mungon çdo njeri, për të cilin ka aq shumë nevojë çdo besimtar.

Dita e Mevludit nuk është si gjithë ditët e tjera, ajo ruan veçantinë e saj. Një e vërtetë kjo që e mësojmë nga vetë goja e të Dërguarit të Allahut. Prijësi në shkencat e hadithit, imam Muslimi në librin e tij "es-Sahih" transmeton se njëri nga shokët e profetit e pyeti atë përse agjëronte ditën e hënë. I Dërguari i Allahut, Muhammedi (a. s.) ju përgjigj : "Kjo është ditë që unë linda".

Kultura shqiptare e besimit musliman është e njohur që herët me tekstet e mevludit (bejtexhiu i famshëm Hasan Zyko Kamberi). Pas tij ne njohim edhe autor të tjerë mevludesh siç janë Ismail Floqi, Hafiz Ali Ulqinaku, Tahir Popova, Abdullah Sëmlaku, Zejnullah Jashari, Hafiz Ibrahim Dalliu, Idriz Lamaj, Fahrudin Osmani etj. plot 20 tekste të ndryshme mevludesh, gjë që tregon familjari-zimin e hershëm të shqiptarve me pjesët e mevludit që këndoheshin me rastin e ditëlindjes së Profetit.

Në këtë numër, si përherë, përveç teksteve të hartuara në lidhje me rastin e festës tonë jubilare, nuk mungojnë edhe krijimtarit poetike, kuriozitet, grimcat humoristike e shkrime të tjera. Do të prisnim me kënaqësi shkrimet dhe krijime nga lexuesit tanë, edhe vërejtjet e tyre me dëshirën e mirë që të mund tu përgjigjemi kërkesave tuaja në botën e letrave dhe shkrimeve.

Do të dëshironim ta përmbyllim këtë editorial me 4 vargje të shqipëruara nga mevludi i famshëm i Çelebiut:

Pra ejani, mëkatet tona t'i kujtojmë,
Të qajmë, të klithim e të vajtojmë,

Dhe vuajtjet e vdekjes t'i përjetojmë,
"O Zot, na fal!"- pendesë të kërkojmë!

Në këtë numër do të gjeni:

Personaliteti shembullor

Nëse ne nuk ekzistojmë sot, është për arsye se ne nuk e kemi mbartur atë në jetën tonë, për arsye se syri ynë nuk shikon me syrin e tij, për arsye se veshi ynë nuk dëgjon me veshin e tij, për arsye se buzët tona nuk janë në përputhje më gojën e lumtur të tij, për arsye se zemrat tona nuk i përshtaten harmonisë së zemrës së tij.

Ahmet Tashgetiren 3

Dashuria dhe shembulli njerëzor / **Prof. Dr. H. Kamil Yëllmaz**.....6

Prof. Ismail Koshi

Personaliteti i Muhammedit s. a. v. s.

Islami nuk është komb. Në Kur'an thuhet: "Popujt janë lule plot ngjyra të një kopshti." Prandaj, Islami nuk ideologjizohet, nuk materializohet dhe nuk instrumentalizohet. Atëherë ç'është Islami? Veçse realitet natyror dhe qiellor.

.....10

Allahu, atij i dha një vlerë të madhe / **Jashar Kandemir** 14

Jeta e Ali Jakup Çenkçiut / **Tasim Darsi** 17

Pse e studiojmë jetën e Profetit Islam? / **Evans Hazir** 22

Sa e duam ne atë? / **Naim Drijaj** 25

Roli i sunnetit në formimin e personalitetit islam / **Ilir Hoxha** 30

Mrekullitë e Kur'anit / **Mr. Hamdi Thaqi** 36

Përse rinia bie ne depresion? / **Roland Çarçiu** 40

Personaliteti Islam / **Lutfi Nexhipi** 42

Edukimi i njeriut / **Ismail Ozxhan** 44

Cilin nga ne do më shumë i Dashuri i Allahut? / **Mustafa Erish**.....48

Shembull i shkëlqyer

Cilësia jote le të jetë çfarë të jetë, në ç'do lloj gjendjeje që të ndodhesh, mbrëmje-mëngjez, do ta gjeshë Muhammedin sallallahu alejhi ue sellem si një udhëzues më të shkëlqyer për veten tënde!

Dije se bijografia e Tij, ishte një kopësht trëndafilash i zbukuruar me trëndafila me erë misku nga lule të rralla dhe të hijshme!

Osman Nuri Topbash 32

Dua Mamin 54

Mjekësia në Egjiptin e lashtë / **Arjan Ymeraj** 55

Naim Drijaj

I Dërguari i Allahut (s. a. s.) paralajmëron të gjithë kohërat!

Profeti (a. s.) ka thënë: "Së shpejti do të vijë koha kur drejt jush do të sulmojnë popuj sikur sulmojnë bishat e uritura drejt ushqimit të vet. E pyetën: "A është kjo për shkak të asaj se do të jemi pak, o i Dërguari i Allahu?" Ai tha: "Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën nga ju, kurse në zemrat taja do të vë dobësinë? Ç'është dobësia, o i Dërguari i Allahut? "Dahuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja" tha ai. 20

Arti i kaligrafisë / **Ilir Hoxha** 58

Liria e mendimit të mos ngjallë urrejtje! / **Alija Barlovic** 60

Teknologji 63

Alixhan Tatllë

Si u bënë muslimanë?

Ejani të lexojmë sëbashku tregimin ku shpaloset shembulli dhe sjellja atë ditë e një muslimani që me një personalitet të lartë dhe një karakter të lidhur ngushtë me besimin e tij (Islam), sot është bërë shkak për udhëzimin e 200 milion banorëve 37

Personaliteti shembullor

Nëse ne nuk ekzistojmë sot, është për arsye se ne nuk e kemi mbartur atë në jetën tonë, për arsye se syri ynë nuk shikon me syrin e tij, për arsye se veshi ynë nuk dëgjon me veshin e tij, për arsye se buzët tona nuk janë në përputhje me gojën e lumtur të tij, për arsye se zemrat tona nuk i përshtaten harmonisë së zemrës së tij.

Ai është boshti i botës sonë. Ai është vatra e jetës sonë. Shkojmë, kthehemi është pika që do të vijmë. Është udhëzuesi që do të aplikojmë. Është limani ku do të strehohemi. Është klima ku do të gjejmë ngushëllim.

Ai është dhurata e Allahut për gjithësinë.

Ai është Profet.

Është transmetuesi i lajmit më të drejtë.

Është njeriu shembullor i jetës më të bukur.

Ai është lideri që e ka përqëndruar identitetin në edukatën hyjnore.

Një libër i tillë, që secilës rrokje të tij t'i lidheni, do t'ju udhëzojë dhe do t'ju falë gjallëri.

Në çdo fjali të tij do të ndërtoni një shembull jetësor.

Ai nuk është një fjalë e vetme, është një e vërtetë. Ai është një njeri që ka jetuar 63 vjetë plot e përplot dhe është një njeri, që në çdo aspekt të 63 vjetëve ka shfaqur bukuritë e kaluara nga pastërtia e edukatës hyjnore.

Ai është një fëmijë, një jetim, një djalosh, një baba, një bashkëshort, një biznesmen, një shok, një kryetar shteti, një fitimtar, një i mundur, një lider që ka përjetuar vuajtjen dhe gëzimin…

Një njeri në vëzhgim…

Një jetë në mes të ditës…

Një njeri, që çdo aspekt i jetës së tij, nga buzëqeshja e deri te ecja, regjistrohet dhe shumohet në miliona. Një njeri që gjithmonë lexohet, që lexohet me shekuj, që lexohet nga miliona.

Një njeri që dinte se do të lexohej kështu dhe që jetonte me atë përgjegjësi.

Ngado që të shikosh, është një shembull që mund të marrësh maturi.

Ai ka një përkufizim shumë të qartë: Kur'an i Gjallë.

Çfarëdo që të jetë Kur'ani, ai, është mbledhja në personalitetin e tij e gjithë shembullit hyjnor. Sikur është shembulli shoqërorë që do të ndërtojë Kur'ani, jeta e tij është bërë e zgjidhur, gjurmësh ngjyra-ngjyra e skica-skica… Ai jeton në çdo besimtar… Do të thotë çlirimi i jetës sonë, do të thotë të formohemi me ngjyrat e tij. Do të thotë struktura e një shoqërie sipas Islamit, do të thotë qarkullimi në damarët e shoqërisë dhe qytetit në formën e një esence në botën e zemrës së tij.

Ai duhet të jetë për ne më i nderuar se shpirti ynë, sepse kuptimi i shpirtit tonë është ai. Nëse shpirti takohet me të, do të thotë që është takuar me të dashurin e tij. Nëse e dashuron atë, ka gjetur dashurinë. Nëse takohet me të, qëndron me të.

Nëse ne nuk ekzistojmë sot, është për arsye se ne nuk e kemi mbartur atë në jetën tonë, për arsye se syri ynë nuk shikon me syrin e tij, për arsye se veshi ynë nuk dëgjon me veshin e tij,

Ai ishte bujar, i dashur, i dhembshur, mëshirues, guximtar, miqësues, i butë, i matur, e mposhte zemërimin e tij, ishte i buzëqeshur, e ndiente dashurinë në përqafim, ishte i respektueshëm dhe shumë cilësi të tjera që e përshkruajnë...

për arsye se buzët tona nuk janë në përputhje më gojën e lumtur të tij, për arsye se zemrat tona nuk i përshtaten harmonisë së zemrës së tij.

Nëse popujt myslimanë janë në dhimbje nga brezi në brez, është për arsye se nuk është ndërtuar me duart e shenjta të tij dhe se duart tona nuk i ngjajnë dorës së tij.

Nëse shtëpitë tona nuk i ngjajnë Shtëpisë së Lumtur, nuk mund të bëhet një ndërtesë muslimane. Nëse xhamitë tona nuk mbartin ind nga Xhamia e Profetit, është dhimbjedhënëse. Nëse themeli i shoqatave tona nuk është hedhur bashkë me Darul Erkam (shtëpinë e Profetit), mbi to nuk mund të ndërtohet Medine-ja. Nëse liderët tanë nuk marrin nga pastërtia e të dhënave të tij administruese, ngelim në rrugë dhe çdokush nga ne, kur të mos rrethojë përgjegjësinë që e ndien një besimtar tjetër i çiltër nga profetësia e tij, humbasim veten tonë.

Mosarritja në asnjë lloj mënyre e zbukurimit të popullit të Muhammedit, është për shkakun se ne nuk i ngjajmë brezit që e ka edukuar ai.

Pas XIV shekujve, kur të mundohemi të futemi në klimën e zemrës së tij, kur të ndërtojmë një rrugë zemre nga këtu e deri atje, kur të sigurojmë shembujt jetësorë gdhendës nga atje e deri këtu, do të regjistrohemi në bibliotekën e popullit.

Ai filloi i vetëm, por zemra e tij ishte hapur aq shumë sa që brenda saj mund të merrte gjithë universin. Kur thoshte: "Ejani", sikur po thirrte të gjithë universin. Thirrte njerëzit edhe xhindët.

Kur shkonte derë më derë, në zemrën e tij kishte vend për secilin.

Kur iu hodh plëndësi i devesë mbi të, e dinte mosndihmën e përgjegjësisë që mbarte për shpenzimin në shtigje.

Ai nuk ishte një personalitet historik. Ai ishte lideri i të gjithë shekujve deri në kijamet. Domethënë, lideri ynë dhe i atyre që vijnë pas nesh. Historia do të shkruhej gjithmonë rreth Tij.

Madje edhe zemrat më të forta, i vizitoi për t'i zgjidhur.

Për t'u bërë përkrahës i një ftese, duhet të shohësh atë. Për kulmin e zemrës së tij të zbukuruar me përforcimin hyjnor...

Nëse bëhemi flutura rreth këtij kulmi, nëse lidhemi me të, nëse vrapojmë tek ai, nëse ushqehemi nga ai, nëse marrim forcë nga ai...

Nëse kërkojmë një zemër si zemra e tij, që hapej në gjithë universin, kur të jemi një, bëhemi njëmijë dhe shekujve u sjellim dobi.

Ai ishte bujar, i dashur, i dhembshur, mëshirues, guximtar, miqësues, i butë, i matur, e mposhte zemërimin e tij, ishte i buzëqeshur, e ndiente dashurinë në përqafim, ishte i respektueshëm dhe shumë cilësi të tjera që e përshkruan...

Të gjitha këto janë cilësitë e njeriut besnik. Nëse në çdo vend të botës janë mbledhur 3-4 vetë, kjo është realizuar rreth njerëzve që i mbartin këto cilësi.

Ai të gjitha këto cilësi i mbarte në personalitetin e tij, në pikën më të përsosur.

Lidhjet që na takojnë ne sot si popull, duhet të kenë grimca që bien mbi ne nga cilësitë individuale të tij. Nëse ka rënë diçka nga bujaria e tij, jemi dhënës. Nëse në zemrën tonë ka

rënë një grimcë nga dashuria e tij, ushqejmë dashuri për njëritjetrin. Butësia jonë, përzemërsia jonë, maturia jonë, buzëqeshjet tona pa dashje... Bukuri që mund të ngelin nga ai... Ato janë gjërat që ne na bëjnë të mirë.

Çdo të thotë të jesh Kur'an i gjallë?

Do të thotë të jesh njeri parimor.

Do të thotë cilësia e administrimit të domosdoshëm.

Do të thotë të jesh rob të cilin e ka rijuar dhe e do Zoti. Do të thotë që në çdo lëvizje, të strehohesh te Ai. Do të thotë të jeshë i zgjedhur për shfaqje e sipër të kënaqësisë së Zotit.

Do të thotë që maturinë që ua ka sjellë njerëzve, në fillim dhe gjithmonë ta praktikosh në jetën tënde. Do të thotë të jesh më i pari në nënshtrim (ndaj Zotit) dhe për këtë shkak do të thotë të ndiesh përherë mbi gjithçka shikimin e Zotit. Do të thotë çdo lloj gjendje kontrolli gjaku... Do të thotë të jeshë i gjallë në çdo çast.

Të kesh mundësinë për të thënë "O Zot mos ma lër veten time mua"...

Kjo do të thotë të jesh si një fener qelqi që si brendësia ashtu edhe e jashtmja janë një.

Ai nuk ishte një personalitet historik. Ai ishte lideri i të gjithë shekujve deri në kiamet. D.m.th lideri ynë dhe i atyre që vijnë pas nesh. Njeriu në udhëheqjen e tij do të perceptojë njerëzimin, pastaj... Historia do të shkruhej gjithmonë rreth Tij.

A bën ta harrojmë ne Atë?

A kalojnë ditët tona pa të?

Sa ekziston ai në jetën tonë?

Sa e duam ne atë?

Sa është ai mik i shtëpisë sonë?

Sa e ndjejmë shtëpinë tonë si Darul Erkam?

Sa dinë fëmijët tanë rreth tij?

Qoftë kur ushqejmë jetën tonë, qoftë kur ushqejmë personalitetin e fëmijëve tanë, sa ka nga bukuria e tij në aspektin e burimit?

Ta duash atë, ta përfaqësosh atë, të bashkohesh me të, të jeshë bashkë me të... Kjo është veçoria themelore e të dashurve të çdo shekulli... Të bashkohesh me karvanin e tyre... Ja pra ky është pasioni që duhet të ketë djegia e zemrës sonë. Për këtë arsye i lutemi Zotit tonë... O Zot, na bëj njerëz të dashur për Ty dhe për të dashurin Tënd...

O Zoti ynë, na jep zemra që i mbështeten dashurisë...

Amin!

Përktheu: **Fatmir Sulaj**

Je ti...

Në piedestalin e mirësisë qëndron
Plagët e gdhendura në kohë i shëron
Çdo njollë në shpirtin e mëkatarit pastron
Me fjalën e ëmbël në rrugë të drejtë e udhëzon
Je ti o Profet ylli i gjithësisë
Je ti o Muhammed mishërimi i drejtësisë
Je ti ai që ishe shembull për ne
Që qëndrimi yt ngrihej lart mbi re
Je ti vetëm ti që dritën na ofrove
Dhe xhennetin më shumë na afrove

Elmira Lani

Dashuria dhe shembulli njerëzor

Njeriu është një krijesë që dëshiron gjithmonë bashkim. Kurse shkaku më i fuqishëm që e shtyn atë drejt bashkimit është dashuria. Dëshira për t'u bashkuar, e dërgon ujin e përroit dhe të lumit drejt detit dhe nga deti në oqean. Çdo atom i Universit vrapon drejt njëritjetrit me këtë dëshirë. Veçoria themelore e ligjit të tërheqjes në Univers, është dashuria dhe joshja. Për këtë shkak, Allahu Teala dëshiron që dashuria ndaj Tij të arrijë përsosmërinë duke u bashkuar me dashurinë për profetin dhe ndjekjen në çdo hap të porosive të tij (a. s.): "Thuaj, nese e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë mëkatet tuaja..." (Ali Imran, 3/31)

Me fjalën "pasoj" nënkuptohet marrja e dikujt shembull. Të marrësh dikë shembull, do të thotë të ecësh nëpër gjurmët e hapave të tij, me dashuri dhe me dëshirën e zemrës. Kur'ani, për të Dërguarin e Allahut kërkon një dashuri të tillë, një dashuri të zjarrtë dhe të lidhur ngushtë me të. Sepse Kur'ani, Profetin (a. s.) e paraqet si shembull i personalitetit njerëzor. "Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, (kuptohet) për atë që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër dhe për atë që e përmend shumë shpesh Allahun." (el-Ahzab, 33/21) Kur'ani, përveç Profetit (a. s.), këtë termë e përdor edhe për Ibrahimin (a. s.) dhe profetët e tjerë. (shih. el-Mumtehine, 60/4, 6)

Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, (kuptohet) për atë që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër dhe për atë që e përmend shumë shpesh Allahun. (el-Ahzab, 33/21)

Fjala "usve" ose "isve", sipas Ragib el-Isfahanit, do të thotë karakteristikë që formon shembullin e mirë ose të keq, mërzitjen ose gëzimin tek të tjerët. Te'essi: do të thotë t'i bindesh personit shembull ose model dhe ta pasosh atë. Muhammedi (a. s.) nuk është dërguar udhërrëfyes vetëm për ata që janë të dhënë pas kërkimit të zbukurimeve në këtë botë, e që nuk mendojnë Allahun dhe Ditën e Ahiretit, por njëkohësisht, ai është dërguar për të qënë shembulli më i mirë për ata të cilët e përmendin shpesh Allahun dhe besojnë në botën tjetër. Sepse ai (a. s.), është paraqitur si shembulli i maturisë dhe ndjëkesi i një rruge të mesme për ata të cilët duke u dhënë pas adhurimeve dhe jetës mistike, pretendojnë të kryejnë më tepër adhurim se Profeti (a. s.) dhe më shumë se sa i urdhëron Islami ata. Këtë e tregojnë më së miri kritikimet dhe paralajmerimet e të Dërguarit të Allahut (a. s.) bërë atyre që pasi mësonin mënyrën dhe kohën që i jepte Profeti (a. s.) adhurimeve, duke i menduar këto adhurime si të pamjaftueshme, jepeshin pas agjërimit gjithë kohën, vazhdimisht merreshin me faljën e namazit ose dëshironin që të mos martoheshin kurrë, me frikë se martesa do i largojë ata nga adhurimi.

"... ç'ka t'ju jap Pejgamberi merreni, e çka t'ju ndalojë largohuni prej saj..." (el-Hashr, 59/7)

Ky ajet, që paraqet si shembull të personalitetit njerëzor karakterin e të Dërguarit të Allahut, në të vërtetë, sjell në rendin e ditës veçorinë e modelit në eduki-min moral të njeriut. Njerëzit dëshirojnë

më tepër të përgjithësohen me shembujt ku praktikohen rregullat, sesa t'i mësojnë e pastaj t'i praktikojnë ato. Personaliteti model, sikurse morali, në tematikën teorike, është një shembull konkret dhe lehtësues për njerëzit. Karakteristika e ndikimit të njerëzve tek njëri-tjetri dhe influenca në reflektimin dhe gjendjen e tyre, e bën të domosdoshëm në edukim faktorin "model".

Nëse do t'i hidhej një sy historisë njerëzore, popujt të cilët mbartin mbi vete shembuj heronjësh dhe personalitete modele për brezat e tyre pasardhës, janë gjithmonë më të suksesshëm në udhëhqejen e masës dhe zhvillimet sociale. Modelet e injeksionuara në zemrat e rinisë i shtyjnë këta të rinjë drejt horizonteve të reja. Popujt që nuk gjejnë një model për t'ia treguar kësaj rinie, fillojnë të dobësohen dhe të humbasin entuziazmin e ekzistencës së tyre.

Sëbashku me ndryshimet e kulturës që po zhvillohej në perëndim në fillim të shek. XX., ndryshoi edhe modeli njerëzor. Mendimtarët dhe dijetarët perëndimorë duke u zhveshur nga petku i modelit të vjetër njerëzor, me anë të televizionit, teatrit, kinemasë etj. filluan të prodhojnë heronj të rinj për njeriun perëndimor. Kështu që, sipas përmasave të vlerave të reja, duke paraqitur nga historia një sërë modelesh,

Pejgamberi është më i ndieshëm sesa ata ndaj vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre...

Juve ju erdhi i dërguari nga mesi juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndieshem dhe i mëshirshëm për besimtarët.

arritën të endin personalitetin e njeriut perëndimor të shekullit të XX. Ndikimi kulturor solli në popujt muslimanë të njëjtët modele. Për këtë shkak, edhe rinia jonë, në mesin e fundit të këtij shekulli, u përzie me heronjtë e filmave të paraqitur si "model" nga popujt perëndimorë dhe ai Amerikan, duke e shtyrë veten drejt tërësimit me ta.

Kërkimet e një modeli janë shumë të rëndësishme. Në vitet e fundit, në botën Islame dhe në vendin tonë gjithashtu, dëshira për të prezantuar figurat e personaliteteve muslimane me në krye persnalitetin e të Dërguarit të Allahut (xh. sh.), po fitojnë një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Sepse ata që nuk gjejnë modele të përshtatshme për botën e tyre të brendshme, përballë modeleve të tjera të paraqitura, mbesin të nguruar.

Gjëja më me rëndësi në këtë pikë, është formimi i një ure dashurie mes modelit dhe njerëzve. Nëse nuk formohet kjo urë, njohuritë e harxhuara mbesin të pamjaftueshme.

Sot, çështja më me rëndësi për ne, është dashuria ndaj Profetit (a. s.) dhe prezantimi i tij tek njerëzit ashtu siç e meriton. Sepse dituria dhe dashuria janë gjëra të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në fillim njeriu kërkon ta njohë dikë, më pas fillon ta dojë dhe pastaj dëshiron të bëhet si ai që do. Për shkak të revolucionit që ka kryer Islami jashtë kufijve të tij, si dhe në perëndim, figura e Muhammedit (a. s.), qëndron në krye të 100 personaliteteve më të rëndësishme të historisë.

Në krye të artikullit përmendëm fjalët "të pasosh, ndjekësh", si dhe fjalët "shembull, model". Të njohësh Profetin (a. s.), ta duash, ta pasosh, ta marrësh si shembull dhe model me të gjitha këto, u munduam të tregojmë se dashuria për Profetin (a. s.) është prej besi-

Nëse do t'i hidhej një sy historisë njerëzore, popujt të cilët mbartin mbi vete shembuj heronjësh dhe personalitete modele për brezat e tyre pasardhës, janë gjithmonë më të suksesshëm në udhëhqejen e masës dhe zhvillimet sociale. Modelet e injeksionuara në zemrat e rinisë i shtyjnë këta të rinjë drejt horizonteve të reja. Popujt që nuk gjejnë një model për t'ia trguar kësaj rinie, fillojnë të dobësohen dhe të humbasin entuziazmin e ekzistencës së tyre.

mit. Domethënë, imani i besimtarit përsoset duke dashur të Dërguarin e Allahut (a. s.). Kjo është dashuria që kërkohet nga ummeti (besimtarët muslimanë).

Përballë kësaj dashurie shikoni se si e shpreh Kurani dashurinë e Profetit (a. s.) për ne: "Pejgamberi është më i ndieshëm sesa ata ndaj vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre..." (el-Ahzab 33/6). "Juve ju erdhi i dërguari nga mesi juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndieshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." (et-Tevbe 9/128)

Në të vërtetë, kjo është ajo çka i ka hije një profeti të dërguar meëshirë për të gjithë botët. Shembujt e tij (a. s.) të dhembshurisë dhe mëshirës, tregohen më gjerë në librat e sijerit (historise së Profetit Islam) dhe hadithit. Por, në thelbin e kësaj dhembshurie dhe mëshire qëllimi është i qartë: Dashuri.

"Nga kjo dashuri lindi gjithçka për Muhammedin

Ç'farë dashurie mund të lindi pa Muhammedin!"

Çdo pejgamber e ka një lutje të pranueshme të Allahu. Muhammedi (a. s.) e ka ruajtur këtë lutje për ummetin e tij në Ahiret. Ky është një shembull tjetër që tregon dashurinë e tij (s. a.) për besimtarët. Nga ana tjeter, dashuria për Profetin (a. s.) është një garanci shpëtimi në Ditën e Gjykimit. Në lidhje me këtë tregohet në një hadith se, vjen një sahabi dhe e pyet të Dërguarin e Allahut (a. s.): "Kur do të ndodhë kijameti?" Muhammedi (a. s.) i thotë: "Po ti ç'farë ke përgatitur për kijametin?" Sahabiu i përgjigjet: "Unë nuk kam punuar shumë punë të mira, por e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij". Atëherë Profeti (a. s.) tha: "Njeriu është bashkë me atë që do." (Shih: Buhari Edeb 96; Muslim 165; Tirmidhi, Zuhd 50). Trasmetuesi i këtij hadithi Enes b. Malik thotë: "Që nga ardhja e Islamit, nuk kam parë gjë më të gëzueshme për muslimanët sesa kjo fjalë."

Ebu Leheb është i njohur për torturat dhe të këqijat që i ka bërë Profetit (a. s.) dhe muslimanëve. Pas vdekjes së tij, një pjesëtar i familjes e shikon atë në ëndërr dhe e pyet se si ishte gjendja e tij. Ebu Leheb i përgjigjët: "Më jepet ujë për të pirë, për shkak se (kur isha në këtë botë) e kam lënë të lirë robëreshën time Suvejbe, e cila i ka dhënë gji Profetit (a. s.).

Për të kaluar nga një botë e përkohëshme si kjo në të cilën ne jetojme, drejt një bote të përherëshme ku do të jemi më afër Krijuesit tonë, padyshim nuk është diçka e lehtë. Rruga që të çon drejt saj është t'i hapim krahët dashurisë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe të duam ata të cilët i kanë mbushur zemrat me këtë dashuri. Shembull i bukur për këtë është kjo lutje: "O Zot, më mundëso të të dua Ty, ata që të duan Ty, dhe ata që duan punët që të afrojnë drejt dashurisë Tënde?" Amin...!

Përktheu: **Luan Ahmeti**

Ceremoni mortore

Shikim i randë
E sotmja,
Mezi ngrihet nalt
Drejt yjeve
Që vizatojn
N'sfondin e kaltër
Librin e fluturimit t'qellimt

Shenja
Lapidarsh mishnor
Mshehen
Nën Ikura
T'kalbuna qytetnimesh

Copa t'brishta qiejsh
Mbi krah të thyem
Bahën gur të mdhej
Varresh pa zot.

Aty
Vëgime të zeza
E ofshama cinike
Dridhen
N'guven e frigës.

Jeta
S'qenka kurrgja tjetër
Veçse fusha e zez
Ku vallzon
Me njerzit
E vetme
Vdekja e parakohshme...

O Zot
Ma mir nën dhe me krymat e me Ty
Sesa mbi dhe me njerzit e pa Ty

Alban KALI - Shkodër 2005

Prof. Ismail Koshi

Personaliteti i Muhammedit s. a. v. s.

Islami nuk është komb. Në Kur'an thuhet: "Popujt janë lule plot ngjyra të një kopshti." Prandaj, Islami nuk ideologjizohet, nuk materializohet dhe nuk instrumentalizohet. Atëherë ç'është Islami? - veçse realitet natyror dhe qiellor.



- I -

Aman, O Zot më ndihmo dhe më shpëto që të mos gaboj në përshkrimin e personalitetit të Muhammedit s.a.v.s.

Fjala Muhammed ka kuptim të gjërë, që nga lind dhe perëndon. Ky emër madhështor esencialisht dhe morfologjikisht do të thotë për njeriun e zakonshëm: Toka dhe qiejt, pronarë i të cilave është Allahu xh.sh. që është Një e s'ka të dytë.

Muhammedi s.a.v.s., udhëheqësi ynë në Islam, na shpalosi thjeshtë e bindshëm si teorikisht ashtu edhe praktikisht Islamin në gjallërimin dhe zbatimin e vet, për të gjitha kohërat e të dy botërave të jetës ekzistente dhe të jetës së përtejme.

Për çudi njeriu ynë, që është qenie jo e fortë e stoike, për të cilin edhe Allahu xh.sh. e përmend në Kur'an si qenie e dobët kur thotë: "Zoti nuk ju ngarkon me atë që nuk mund ta mbani", atëherë përse njeriu nuk përfill e t'i zbatojë ligjet e Zotit, që janë jo vetëm të pakëta, por janë edhe të mundshme të realizohen. Si: Namazi, Zekati, Sadakaja, prerja e kurbanit, Haxhi (për këto dy të fundit sipas mundësisë materiale), dhe deklarimi se Zoti është Një e Muhammedi është rob dhe i dërguar i Zotit. xh.sh.

Zoti nuk ju detyron t'ia përfillni obligimet e tij plot begati. Fundi fundit, nuk ka imponim në Islam. Zoti është i begatë, ne jemi nevojtarë për Atë.

Hë, si thua ti, o njeri?! Të preku ndokush vullnetin tënd të lirë? Jo, askush, as nga qielli as nga toka, as nga Zoti xh.sh. Por, ti harron o njeri, për një gjë që veç dihet: Zoti asnjë pikë ujë nuk ta jep kot. Gjithçka që dihet dhe nuk dihet është e Tij. Po, Ai neve na lehtësoi rrugën me të Dërguarin e Tij, Muhammed (s. a. v. s.), që të bëhemi të qetë dhe të lumtur në këtë botë. Njeriu, pati ngritje e s'pati ngritje shkollore, këtë e kërkon, e që të arrishë këtë, atëherë duhet dëgjuar Muhammedi (s. a. v. s.). Sepse kështu thotë vetë Zoti në Kur'an: "Kush nuk e dëgjon Muhammedin, Ai nuk më ka dëgjuar Mua."

Për çudi njeriu ynë, që është qenie jo e fortë e stoike, për të cilin edhe Allahu (xh. sh.) e përmend në Kur'an si qenie e dobët kur thotë: "Zoti nuk ju ngarkon me atë që nuk mund ta mbani", atëherë përse njeriu nuk përfill e t'i zbatojë ligjet e Zotit, që janë jo vetëm të pakëta, por janë edhe të mundshme të realizohen. Si: Namazi, Zekati, Sadakaja, prerja e kurbanit, Haxhi, dhe deklarimi se Zoti është Një e Muhammedi është rob dhe i dërguar i Zotit. (xh. sh.)

Paskajshmëria Islamike na bën t'ia vëmë gishtin kokës, apo siç thotë vetë Zoti në Kur'an: "O ju njerëz që keni mend". Islami nuk është komb. Në Kur'an thuhet: "Popujt janë lule plot ngjyra të një kopshti." Prandaj, Islami nuk ideologjizohet, nuk materializohet (atë e materializon Zoti) dhe nuk instrumentalizohet. Atëherë ç'është Islami? - veçse realitet natyror dhe qiellor.

Deceniet e shekullit të kaluar shfaqi njerëzit e arsimuar në botë etshëm për lexim, e filluan të imponohen në vetvete, pa ditur mirë ligjet islamike, apo edhe pse i dinin e i anashkalonin të dehur vetëm me literaturë permanente pa censurë diturie islamike, siç veprojnë edhe sot (pa qenë kompetent apo supermjeshtror) e nxjerrin mendime gjithëfarëshe me degëzime e informacione të ndryshme, me reforma e moderime e idera terciale dhe i vënë në vend të parë mbi rrugën e shtruar siratul mustekim të Zotit, që e trasoi Muhammedi (s. a. v. s.) sa na bënë që neve edhe më tutje natyrshmëria jonë të lëkundet, të zbehet e të plasaritet si mos më keq. Këto të meta e këto lëshime që u bartën nga e kaluara, ruajna Zot të mos na shtohen si sot ashtu edhe nesër. Kjo e pamirë u thellua edhe në çështjen tronditëse: Namazi ynë sakat - pse nuk japim zekatin si duhet. Kur dihet se nuk ka namaz pa zekat, as që ka zekat pa namaz. Këto dy shtylla janë binjake, nuk ndahen, apo të themi më thjeshtë: A qëndron trupi i njeriut pa kokë, apo koka pa trup? Kështu qëndrojnë namazi dhe zekati. Apo të themi më shtruar: Kjo i ngjan si një musliman i arsimuar, që do të ndërtojë një pallat shtatë katësh dhe themelin e shtron me guralecë dhe baltë.

As sadakaja nuk mund të vihet në rendin e dytë.

Mjerisht, sot muslimani në

Kur'ani është privilegji e aristokracisë së inteligjences, kur dihet mirëfilltë nga hadithi i Buhariut: Çdo ditë apo çdo natë të lexohet Kur'ani.

Sunnetet e hadithet e Resulullahut, as nuk janë maksima të shkruara inerte nëpër mure e nëpër libra, por janë gjallërime substanciale zbatuese Kur'anore.

botë fle mendjen për këtë çështje. Ruajna Zot! Si do të shpëtojmë para Teje.

Këtu në fund do përmendur edhe çështja e leximit të Kur'anit, pasi që Kur'ani është privilegji e aristokracisë së inteligjencës, kur dihet mirëfilltë nga hadithi i Buhariut: Çdo ditë apo çdo natë të lexohet Kur'ani.

Sunnetet e hadithet e Resulullahut, as nuk janë maksima të shkruara inerte nëpër mure e nëpër libra, por janë gjallërime substanciale zbatuese Kur'anore.

O Zot, ki mëshirë për mua, se mu lodh dora nga frika e ndonjë gabimi duke shkruar për personalitetin e Muhammedit (s. a. v. s.)

-II-

Duke u nisur që nga fjala personalitet, njeriu ndalet e thotë: "Si është e mundur të konceptohet fjala personalitet për një krijesë permanente të pakontestueshme për të gjitha kohërat e të dy botërave tokësore dhe qiellore?"

Fjala personalitet mund të përdoret për një person fizik, ushtarak apo shtetëror të një vendi apo të ndonjë shteti, që vepron për një kohë të caktuar dhe përmendet në arkivat shtetërore, që shekujt i fosiletojnë deri në harresë.

Ndoshta nga varfëria jonë gjuhësore u desh të emërtojmë me fjalën personalitet, kur dihet mirë se ai quhet Hazreti Muhammed, profeti më i lartësuar dhe vula e Profetisë deri në amshim të pandërprerë.

Tjetër, si mundet njeriu të karakterizojë krijesën më të dashur dhe madhështore të Zotit?!

Sado i etshëm të jetë dhe sado që ka guxim të vlerësojë gjithë fuqinë e tij, prap do të jetë i mangët në përshkrimin e tij.

Ne lindemi e rritemi, mësojmë e punojmë, por nuk dimë dhe harrojmë se çfarë rrjedhimesh do të kemi pas, gjatë jetës. Njerëzit nga dobësia e tyre, rrallë, kush u afrohet mësimeve të Profetit Muhammed (s. a. v. s.) shumë kush ikën nga këshillimet e tij. Ç'është më keq, i teket dikuj e thotë: "A di çka po marrë, fjala vjen, librin e hadi-theve të Buhariut dhe po e lexoj. Pasi ta lexojë thotë në vete: "Po, qartë po na flet Profeti. Këto gjëra janë nga jeta të pakontestueshme." Dikush e mbyll librin dhe vazhdon jetën, duke pandehur si të sihte libër i zakonshëm.

Sunneti dhe hadithi nuk lexohen, por studjohen edhe pse është e shtruar aq thjeshtë, bindshëm dhe saktë për të gjitha fenomenet e ekzistences materiale dhe njerëzore. Por, njeriu prap nuk kupton përgjegjësinë e vet dhe vazhdon jetën ashtu si do vetë. E kur i kërcënohen rrjedhimet në tortura e tragjedi, atëherë thërret: Ç'ka më gjeti, o Zot më ndihmo!" Andaj, afrohuni hadi-theve sa të keni jetë, sepse ato janë ligje që rrjedhin nga ligjet e shëndritshme kur'anore. Hadithi është kryesisht kuptimor tredimencional e le më që të shkojmë në thellësinë e mrekullive hyjnore të tyre. Ja, ky është Muhammedi s. a. v. s., rob e Profet i Zotit, qenia më e dashur e Tij.

Së pari duhet cekur fjalët e Zotit xh.sh. drejtuar Muhammedit s. a. v. s.: "Ti vetëm këshilloi dhe tërhiqu vërejtjen njerëzve se Unë veproj me ta." E këto këshilla dhe hadithe janë udhërrëfyese për të shpëtuar në këtë jetë ashtu edhe në jetën e amshuar.

Po qe se ndokush do të thotë s'po kuptoj këtë e atë hadith, kërkoje dijetarin apo mjeshtrin e shpjegimit të çfarëdo hadithi, p.sh.: po përmendim dy hadithe: "Dy rekate të sabahut kanë vlerë më shumë sesa ka pasuria nën tokë dhe mbi tokë".

Hadithi i dytë: "Muslimani i ngjan shpendëve, që zgjohen të uritur në mëngjes dhe në mbrë-mje kthehen të ngopur".

Ja pra, hadithet janë fjalë të Profetit (s. a. v. s.)

Pa këto hadithe ne do të mbeteshim sakat. As jeta nuk ka kuptim. Ndoshta as që mund të ekzistojë shumë kohë ky sistem diellor. Pse? Sepse hadithet tregojnë ç'është natyra, njeriu, qiejt, yjet dhe lëvizshmëria e tyre, pozicionet e tokës, hënës dhe diellit, ç'është jeta e njeriut, ç'farë duhet ta ketë, fenomenologjia e materialeve natyrore, harmonia dhe shkaku disharmonizues i botërave bimore, shtazore dhe njerëzore, sjelljet e njeriut në prodhim nga resurset e këtyre tri botërave të lartëpërmendura, jodhunimi, por fisnikërimi i natyrës, ngritja e njeriut në piedestalin e duhur, llojshmëria e personaliteteve njerëzore. Shkallëzimet në ngritjet shpirtërore, profilet materiale, mënyrat e fitimeve, dëmet që vijnë nga mashtrimet tregëtare, tolerancë dhe ndalesat limitative. Ç'është gjinia njerëzore, detyrimet dhe liria e tyre? Ç'është familja, përgjegjësia e saj në Islam dhe në jetë?

Ç'është gjinia njerëzore, detyrimet dhe liria e tyre?

Ç'është familja, përgjegjësia e saj në Islam dhe në jetë? Pse njeriu i rëndomtë është shoqërizues.

Ç'është koprraci dhe ç'është i gjymerti (bujari, dorëliri), pse punëtorit i jepet paga para se t'i thahet djersa në ballë.

Pse njeriu i rëndomtë është shoqërizues. Ç'është koprraci dhe ç'është i gjymerti (bujari, dorëliri), pse punëtorit i jepet paga para se t'i thahet djersa në ballë. Ç'janë lojrat e fëmijëve, obligimi i tyre për ngritje civilizuese, qytetëruese. Kush është prindi, nëna -obligim tri herë më shumë se ndaj babait-sepse pas rrespektimit të Zotit vjen rrespektimi ndaj prindërve, kur ka luftë e kur s'ka luftë. Cila është luftë e drejtë e cila është ajo e padrejtë. Apo, mos i hyjë në hak të robit në këtë botë, pavarësisht ç'farë moshe, gjinie, rrace apo religjioni është. E shumë e shumë detyra, obligime të tjera i gjejmë në mësimet e tija. P. sh.: si jetoi Muhammedi (s. a. v. s.) në jetën e kësaj bote? Si u soll në familjen e tij? Pse nuk gjejmë asnjë gabim apo lëshim tek ai? E sot, dikush në botë hedh gurë mbi diellin, që i bënë hi e pluhur.

Ai thotë: "Më i miri i gjithë njerëzisë është ai që i bënë mirë gjithë njerëzisë." Shumë e shumë mësime, mijëra e mijëra këshillime na i dha Resulullahi. Para se të kalonte në shtëpinë e qetësisë së përhershme, në Medine tha: "Ja, jua dhashë komplet të plotësuar moralin islamik.

Në fund nuk na mbetet tjetër veç se të themi duke u dridhur i tëri: "Kuku për ne, po qe se nuk i zbatojmë madje së paku 40 hadithe të Resulullahit, Muhammedit (s. a. v. s.), sepse Islami nuk është ligjeratë, por është zbatim praktik.

Allahu, atij i dha një vlerë të madhe

Po të dojë Allahu (xh. sh.) të gjithë do të merrnin xhehennemë. Por, në mesin e tyre ishte i Dashuri i Allahut. Në vendin ku ishte i Dashuri i Tij, nuk binte zjarr por, binin trëndafila. Faktikisht, Zoti i Gjithësisë të Dashurit të Tij i foli duke thënë: "Po Allahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre."

Allahu i Madhëruar do t'ia përulte (gjunjëzonte, bindte) arrmiqtë e tij më të mëdhenj. Mekën, të cilën e donte shumë e që i ka dhënë një vlerë të madhe dhe që një natë është larguar prej saj pa dëshirën e vet, do t'ua merrte nga duart arrmiqëve të tij dhe do t'ia jepte atij.

A është e mundur të gërvishtësh diellin me thikë? A është parë ndonjë trim të shuaj hënën? A i takon njeriut të rrëzojë nga sytë të Dashurin e Allahut? Tani, le të fillojmë punën nga fillimi. Le të shohim se Zoti i gjithësisë ç'vlerë i ka dhënë të Dërguarit të Tij. Allahu (xh. sh.) ka marrë premtimin nga gjithë profetët se: "Më vonë (në të ardhmen) do të vijë një Profet nga Unë. Ai do të vërtetojë librat që do t'ju jap Unë. Ndërsa ju do t'i bindeni atij dhe do ta ndihmoni atë. A më jepni fjalën në lidhje me këtë çështje?

Të gjithë profetët thanë: "Po, të japim fjalën." Sipas kësaj, çdo profet do t'i kumtojë popullit të vet Profetin tonë. Po të arrinin në kohën në të cilën jetonte ai, do të porositnin njëritjetrit t'i bindeshin atij. Allahu tha: "O profetët e Mi. Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju!" (Ali Imran 3/81)

Shkurtimisht, i Dashuri i Allahut është profet për gjithë njerëzit që do të vijnë deri në Ditën e gjykimit dhe për gjithë njerëzinë. (Buhari, Tejemmum 1, Salat 56; Muslim, Mesaxhid 3)

Ndërsa ishe ti në mesin e tyre

Por, jobesimtarët mekas, ishin zhytur në një mohim të thellë. Mrekullitë që tregoi i Dërguari i Allahut, atyre nuk u thoshte gjë. Këta të mjerë, zemra e të cilëve u ishte nxirë, për mrekullitë thonin se ishin "magji". Ata, siç nuk njohën Kur"anin Famëlartë, si Allahun ashtu edhe të Dërguarin e Tij, nuk i përfillnin dhe më e keqja është se thonin "O Allah! Nëse është ky (Kur'ani) vërtet prej Teje, lësho gur nga qielli kundër nesh, ose sillna ndonjë dënim të idhët." (Enfal 8/32)

O Zot, ç'fjalë injorance dhe urrejtjesh ishin.

Si mund t'i thoshte njëri që ka mendje të kthjellët në kokë? Po të dojë Allahu, të gjithë do të merrnin xhehennemë. Por, në mesin e tyre ishte i Dashuri i Allahut. Në vendin ku ishte i Dashuri i Tij, nuk binte zjarr por, binin trëndafila. Faktikisht, Zoti i Gjithësisë të Dashurit (Habibit) të Tij i foli duke thënë: "Po Allahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre." (Enfal 8/33) Megjithatë, në periudhat e mëparshme, mohuesit që nuk i janë bindur Profetit kur i thanë: "Nëse thua të vërtetën, atëherë na e sill ndëshkimin.", janë shfarrosur me ndëshkime të ndryshme.

E ardhmja është e jotja dhe e ummetit (popullit) tënd

Allahu i Madhëruar, Profetin e Tij e ka njoftuar se ç'eardhme e pret atë që nga momenti që është bërë profet. I tha se do ta përhapte islamin anekënd. Nga ana tjetër, Profeti ynë i dashur ngaqë ishte një njeri që kishte më shumë frikë nga Allahu, Ai i largoi disa

brenga dhe i fali të gjitha mëkatet e kaluara dhe ato që do të vijnë. Atij i dha sihariq se nuk do t'i kërkonte llogari për asgjë. Madje, ajetet e para të sures Fatih, të Dërguarin e Allahut e bëri të gëzohej shumë. Sipas kësaj, Allahu i madhëruar do t'ia përulte (gjunjëzonte, bindte) arrmiqtë e tij më të mëdhenj. Mekën, të cilën e donte shumë e që i ka dhënë një vlerë të madhe dhe që një natë është larguar prej saj pa dëshirën e vet, do t'ua merrte nga duart arrmiqëve të tij dhe do t'ia jepte atij. Famën e tij do t'ia lartësonte, ndërsa emrin e tij do t'ia prezantonte gjithë botës. Do ta udhëzonte në rrugën e drejtë që do ta çojë në parajsë. Për t'i shtuar ummetit të tij besimin, do t'iu zbriste qetësi (prehje) dhe rehati në zemrat e tyre.

Besimtarëve, në botën e amshueshme (ahiret), do t'u jepte të mira pa fund. Shkurtimisht, ata do t'i bënte të gëzuar. Do t'ua falte fajet, dhe do t'ua mbulonte mëkatet. O Zot, sa sihariqe (lajme të mira) që ishin këto!..

Do t'i plotësonte begatitë

Allahu i Madhëruar atij, në një ajet të sures Fatih i tha se do t'i plotësonte të gjitha të mirat. Kuptimi i saj shkurtimisht është kështu: "Zoti Botëve, para së gjithash atij i tha: "i Dashuri Im". Atë do ta dërgonte për gjithë njerëzinë. Për të treguar rëndësinë e tij, në Kur'anin Famëlartë u betua për të. Ai tasi u bë profet, hoqi të gjitha ligjet (sheriatet) e profetëve të tjerë. Atë e ngriti në Miraxh. E lartësoi në pozitën më të lartë, në "Kabe Kefthejn".

Në Ditën e Gjykimit atij i është dhënë kompetenca e sheriatit. Dhe kështu që, të Dashurin e Tij, e ngriti në nivelin e "Zotëriu i Njerëzisë". Emrin e tij e përmendi bashkë me emrin e Vet. Ka vënën konditë që ku të thuhet "La ilahe ilallah" atje më pas të thuhet Muhammedun Resulullah". Ai është i kënaqur me ato që kënaqet Profeti i ynë. Ja, atij kështu ia ka plotësuar të mirat.

Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty. Ta shpallëm vetëm këshillë (përkujtim) për atë që frikësohet.

Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiqu idhujtarëve. S'ka dyshim se Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që tallen, të cilët Allahut, i kundërvejnë zot tjetër, e më vonë ata do ta kuptojnë (prapavinë e tyre). Ne e dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata.

Për hir të të Dashurit

Dashuruesi, bën çdo gjë për atë që do. Për të lodhet, përpiqet dhe vrapon. Nuk i jep rëndësi po t'i prishet rehatia dhe nuk mendon se i ikën qejfi. Ndërsa, Profeti ynë, përpiqej t'i dhuronte falenderime Zotit të Madhëruar. Në disa ditë falte namaz me orë të tëra. Lodhej, ngaqë rinte gjatë në kijam, përpiqej duke ia dhënë peshën e trupit herë njërës këmbë e herë këmbës tjetër. Ja pra, atëherë, Zoti Mëshirues ja si e përshkruan mosdëshirën që ai të vuante në këmbë dhe ta shkatërronte veten në këtë mënyrë: "Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty. Ta shpallëm vetëm këshillë (përkujtim) për atë që frikësohet." (Taha 20/2-3)

Mjafton të mos mërzitesh, zemërohesh

"Përse nuk punonin urdhërat e Allahut këta jobesimtarë mohues? Përse nuk u bindeshin vërtetësive të qarta? Ja, kështu mendon Profeti ynë. Mërzitej shumë nga mosbesimi i banorëve të Mekës. Ndërsa Allahi i Madhërishëm, nuk dëshironte që i Dërguari i Tij të mërzitej kështu. Ai, gjithnjë i thoshte kështu: "Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiqu idhujtarëve. S'ka dyshim, se Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që tallen, të cilët Allahut, i kundërvejnë zot tjetër, e më vonë ata do ta kuptojnë (prapavinë e tyre). Ne e dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata." (Hixhr 15/94-97)

Kurthe pa mbarim

Por, armiqtë e Islamit, kishin mër për Profetin. Të gjithë donin ta shfarrosnin atë dhe ta zhduknin nga Islamin. Allau i Madhërishëm, ja si e informonte të Dërguarin e Tij, se si ua ka prishur kurthet që kanë

Të gjithë profetët thanë: "Po, të japim fjalën." Sipas kësaj, çdo profet do t'i kumtojë popullit të vet Profetin tonë. Po të arrinin në kohën në të cilën jetonte ai, do të porositnin njëri-tjetrit t'i bindeshin atij. Allahu tha: "O profetët e Mi. Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju!".

Shkurtimisht, i Dashuri i Allahut është profet për gjithë njerëzit që do të vijnë deri në Ditën e gjykimit dhe për gjithë njerëzinë.

thurrur jobesimtarët për të: "Përkujto (O i Dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje; të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë. Ata bënin plane, e Allahu është më i miri që asgjëson (dredhitë)." (Enfal 8/30)

Dhe, të Dërguarit të Tij, ja ç'sihariq i ka dhënë:

"O ti i dërguar! Komunikoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon." (Maide 5/67)

Kështu, shkurtimisht të Dërguarit të Allahut, gjithë jetën i kanë thurrur kurthe. Janë munduar ta shfarrosnin atë. Ngaqë nuk e dinin se mbrapa tij (ishte) qëndronte Allahu dhe ngaqë nuk dinin urdhërat e Tij: "Ti bën durim në vendimin e Zotit tënd, se ti je nën mbikëqyrjen Tonë dhe kur të ngrihesh madhëroje me falënderim Zotitn tënd!" (Tur 52/48), pothuajse u çmendën duke thënë: "Nuk e shfarrosim dot atë."

Kaluan vite, koha ndryshoi. Por, mendja e atij, që nuk përfillte Allahun, nuk ndryshoi. Nga ana tjetër, Zoti që mbroi të Dërguarin e Tij, e bëri që gjithë jetën, populli (ummeti) i tij ta donte atë fort nga zemra. Kjo dashuri, në zemrën e ummetit Muhammed, u rrit, u zgjat, lulëzoi dhe arriti përsosshmërinë...

Përktheu: **Arjan Ymeraj**

JETA E ALI JAKUP ÇENKÇIUT

Unë kam lindur ne Gjilan në vitin 1913 fillë një vit pas luftës Ballkanike. Familja ime është me prejardhje nga Shkodra dhe janë bërë musliman me ardhjen e Osmanllive në Ballkan. Kur arrita moshën 12 vjeç fillova të mësoj arabisht. Pasi studjova tre vjet, mbarova liceun në të njëjtin vit, por u godita nga një sëmundje. Ndërkohë edhe im atë vdiq.

Në Egjipt kam studiuar 10 vjet, ndërsa 10 vjet të tjera kam punuar si insepktor i librave në Bibliotekën e Universitetit të Kajros. Pra, atje qëndrova nga viti 1936 deri në vitin 1956. Që në vitin 1956 erdha nga Egjipti me punë në Konsullatën Egjiptiane në Ankara.

Ali Jakup Hoxha vdiq në muajin maj të vitit 1988 në moshën 75 vjeçare dhe u varros në Varrezët e Edirne Kapës. Allahu e mëshiroftë...

Siç transmetohet edhe në hadithe të të dërguarit të Allahut, dijetarët janë pasardhësit e të dërguarve. Ky hadith përfshin të gjithë dijetarët që do vijnë deri në ditën e gjykimit. Dijetarët mund të jenë nga të gjithë kombet, racat, ngjyrat.

Ashtu sikurse ka pasur dijetarë islam edhe në shekujt e kaluar nga vendi ynë, edhe në shekullin e 20-të kemi pasur dijetarë të njohur siç janë Muhammed Nasirudin Albani, Abdulkadir Arnavudi, Shuajb Arnavudi, Sulejman Gavoçi. Kësaj plejade të nderuar dijetarësh u bashkngjitet edhe Ali Jakup Çenkçiu.

Disa nga dijetarët bëhen të njohur duke dhënë mësim, disa nëpërmjet librave që shkruajnë, disa duke i bashkuar edhe dhënien e mësimit edhe shkrimin e librave.

Dijetari për të cilin ne do të flasim, i përket grupit që njihet nëpërmjet nxënësve, punës të palodhur dhe shërbimit që i ka dhënë Islamit që nga rinia e tij deri në vdekje.

Kush eshte ali jakupi?

Për ta njohur më mirë se kush qe Ali Jakup Çenkçiu do të na ndihmonte një reportazh që ai ia ka dhënë njërit prej nxënësve të tij me qëllim që të jetë edhe kujtim por edhe ta botoj në një nga revistat që botohej në Stamboll.

Ali Jakupi tha: "Unë kam lindur ne Gjilan në vitin 1913 fillë një vit pas luftës Ballkanike. Familja ime është me prejardhje nga Shkodra dhe janë bërë muslimanë me ardhjen e Osmanllive në Ballkan. Nga mesi familjes time gjithmonë kanë dalë imamë dhe dijetarë islam. Gjyshi im është Haxhi Jakupi. Ishte njeri i mirë, i devotshëm dhe në të njëjtën kohë kishte fituar edhe dashurinë e të krishterëve. Kur gjyshi kishte shkuar për të kryer obligimin e Haxhit një nga të krishterët kishte shprehur këto fjalë: "Iku njeriu më i mirë i lagjes tonë. Ai është evlija." Ndërsa njeri nga të krishterët që mbërrita më thoshte: "Gjyshi juaj ka qënë evlija, i drejtë në shpirt dhe i devotshëm".

Kur arrita moshën 12 vjeç fillova të mësoj arabisht. Në lagjen tonë ishte një medrese me një kapacitet për 80 nxënës. Edhe unë u rregjistrova këtu dhe çdo ditë pas namazit të sabahut dhe te ikindisë lexonim nga një xhuz të Kur'anit. Atë shije mësimi nuk kam arritur ta marr as në Shkup, as në Bosnjë dhe as në Egjipt.

Në këtë medrese mësova arabishten, aty mbarova edhe mësimet e tetëvjeçares. Po këtë vit në Beograd kishte plasur një konflikt dhe po mblidheshin gjithë dijetarët e Ballkanit. Edhe im atë do të merrte pjesë. Unë ju luta shume tim eti të më merrte edhe mua për në Begrad. Isha në moshën 16 vjeçare. Im atë më mori.

Në kohën kur ne po rrinim në kafe pashë një burrë serioz dhe me një fytyrë të ndritshme që po afrohej. Ai ishte dijetari i madh i Bosnjës Mesihoviç ose Mesih Efendia. Iu afrova dhe filluam të flisnim arabisht me njëri-tjetrin.

Mesihoviçi Pasi biseduam me të Mesihoviçi më në fund

më tha se nëse deshiroja të vazhdoja studimet pas tetëvjeçares do të më duhej ta dija mirë arabishten dhe të futesha në provim që të pranohesha në lice. Unë u ktheva ne Gjilan i mbarova të gjithë mësimet, hyra në provim dhe fillova liceun.

Pasi studjova tre vjet, mbarova liceun në të njëjtin vit, por u godita nga një sëmundje. Ndërkohë, edhe im atë vdiq kështu që të gjithë problemet e familjes më mbesnin mua për ti zgjidhur sepse isha fëmija më i madh.

Rruga e gjatë me vështirësi…

Pasi më kaloi sëmundja, në vitin 1936 vendosa të shkoj për studime në Egjipt. U nisa dhe shkova në Athinë për të marrë vizën tek konsullata Egjiptjane. Konsullata në fillim nuk ma dha vizën dhe më tha se më duhej të prisja dy muaj. Kur morra këtë përgjigje u habita dhe nuk dija ç'të bëja. Në këto momente pashë një njeri, që mbante një takije nga ato që përdorin muslimanët, i cili po vinte drejt meje. E përshëndeta me selam dhe edhe ai ma ktheu selamin. Më tha se qe çam nga ata të Shqipërisë dhe se kishte ardhur për të marr mall për tregti me rastin e bajramit. Më tha se po të shkoja në fshatin e tyre mund të qëndroja atje. U nisa dhe shkova në krahinën çame ku më kishte drejtuar ai tregtar. Banorët musliman të fshatit më respektuan aq shume a thua se kisha zbritur nga qielli.

Një sprovë tjetër!

Teksa rrija në fshatin e çamëve një ditë prej ditësh erdhi një xhandar dhe më mori me vete. Ai më dërgoi në komisarat. Në të vërtet një ditë më parë tregtari dhe një banor më kishin thënë se mund të më ndodhte një gjë e tillë.

Atë mbrëmje polici më tha se duhet të rrija në dhomën që shërbente si dhoma e arrestit, por më pas duke menduar se unë nuk kisha pamjen e një njeriu keqbërës më lejoi që atë darkë të bujtja në hotel me kusht që të nesërmen të paraqitesha në gjykatë.

Të nesërmen nisi gjygji kundër meje ku kishin ardhur për të marrë pjesë shumë njerëz. Grekët dhe Armenët pandehni se ishte kapur ndonjë agjent. Aty kishin sjellë dëshmitar, librat e shenjtë Kur'anin dhe Ungjillin. Ata u betuan në Ungjill, kurse unë në Kur'an. Kërkova të sillnin një musliman dhe m'u përgjigjën se ka njerëz që dinë shqip. Unë u thashë se ata nuk e njihnin dialektin shqip të trevës time.

Pasi më pyetën rreth shkakut që kisha ardhur aty, ju përgjigja se ne muslimanët në muajin e Ramazanit shkojmë për të punuar dhe kështu fitojmë para për shpenzimet tona personale. Këtë pohim e aprovoi edhe një Armen nga të pranishmit. Përfundimisht u shpalla i pafajshëm.

Pastaj mora vizën për Egjipt dhe u nisa të përmbush atë që kisha bërë nijet.

Njëzet vjet në Egjipt.

Në Egjipt kam studiuar 10 vjet, ndërsa 10 vjet të tjera kam punuar si insepktor i librave në Bibliotekën e Universitetit të Kajros. Pra, atje qëndrova nga viti 1936 deri në vitin 1956.

Në kohën kur punoja në bibliotekën në Kajro, Konsullata Egjiptiane në Ankara kërkonte një person që zotëronte shumë mirë gjuhët osmanisht, turqisht dhe arabisht. Kështu që në vitin 1956 erdha nga Egjipti me punë në Konsullatën Egjiptiane në Ankara.

Në këtë punë qëndrova dy vjet dhe pastaj dhashë dorëheqje sepse lloji i punës dhe ambjenti ku punoja nuk më përshtatej.

Gëzimi që ka nxënësi i dijes të takohet me dijetarë…

Rruga e Egjiptit ishte entuziazte për mua, se do të takohesha me njerëzit që i kisha njohur nëpërmjet librave të tyre.

Do te njihesha me Mehmet Akif Ersojin. Por për fat të keq kur arrita në Shkup lexova në gazetë se Mehmet Akifi kishte vdekur. U dëshpërova shumë, por vazhdova rrugën se e dija që përsëri kisha kë të takoja në Egjipt.

Njeriu i dytë që do të takoja ishte Mustafa Sabriu, shejhulislami i fundit në perandorinë Osmane. Mustafa Sabriu qe muxhahid, modest, dijetar serioz, i ndershëm dhe mik për kokë. Kishte ndikim mbi dijetarët e Ezherit. Ai zotëronte fikhun Islam në të gjitha fushat dhe e mbronte atë në përgjithsi.

Personi tjetër që do të takoja në Egjipt ishte Zahid Kevtheri. Ai ishte një dijetar i madh fikhu dhe hadithi. Nuk e kishte shokun në fushën e njohurive rreth transmetuesve të hadithit.

Zahid Kevtheri nuk merrej me politikë, ndërsa shkrimet e tija ishin të nivelit akademik.

Dashuria dhe respekti i dijetarit për dijetarët...

Ali Jakupi ushqen një

dashuri të madhe për imam Gazaliun dhe këtë dashuri e ka shprehur duke dhënë leksione rreth librit të tij me titull Ihjau ulumi din, leksione që i jepte privatisht në shtëpin e tij në Turqi. Ditën që vdiq thonë se i kishin mbetur edhe tetë faqe pa përfunduar së lexuari, në fund të të cilave ai kishte thënë se do të priste kurbanin e premtuar.

Miqtë e Ali Jakupit në Turqi..

Mes miqve më të njohur dhe më të dashur të tij në Turqi qenë Nexhip Fazëll, Sami Efendiu, Mahmut Efendiu, Nasuhi Bilmeni etj.

Sa gjuhë zotëronte ky dijetar?

Ali Jakupi gjuhën shqipe e kishte gjuhën e nënës, arabishten e zotëronte shumë mirë në shkrim, lexim dhe e fliste shumë pastër. Zotëronte edhe anglishten, frëngjishten, persishten, osmanishten e vjetër dhe turqishten e sotshme. Duhet tëmos lëmë pa përmendur faktin se ai zotëronte edhe serbishten.

Aq shumë e ka dashur Mustafa Sabriu Ali Hoxhën saqë në parathënien e librit të tij "Mevkiful akl ve ilm ve alim" e përmend Ali Jakup Çenkçiun si nxënësin e tij të dashur.

Pasi dha dorëheqje nga puna në konsullatë erdhi në Stamboll ku u martua në moshën 46 vjeçare me një grua te devotshme dhe vazhdoi të punonte si llogaritar në një fabrikë.

Edhe pse nuk pati femijë gjithmonë thoshte: "Falënderoj Allahun fëmijë nuk më dha, por më ka dhënë shumë nxënës."

Në këto vite, komuniteti musliman i Turqisë formoi institutin e Hasekiut. Në këtë insitut kërkohej një njeri që zotëronte gjuhën arabe shume mirë, por edhe gjuhë të tjera. Me ndërhyrjen e Ministrisë së Arsimit, Ali Jakupi pranoi të jetë profesor në këtë institut ku punoi dhjetë vjet në Kur'an, kurse të vajzave "Tuba Kur'an Kursu".

Ai thoshte: "Nga tre vetë jam ndikuar: nga imam Gazzaliu dhe Mustafa Sabriu."

Si e komentonte perçarjen e muslimanëve dhe këshillat e Ali Jakupit.

Ali Hoxha thoshte se përçarja e muslimanve është si shkak i egoizmit të tyre, një sëmundje e keqe që ka kapluar ummetin është egoizmi. Për këtë shkak ne jemi të coptuar sot. Nëse me të vërtetë duam të ndihmojmë njerëzimin dhe fenë tonë duhet të shpëtojme nga ky egoizëm i fëlliqur. Njeriu mund të bëhet mbret por nuk mund të jetë njeri i devotshëm dhe zemërpastër, respektus i Krijuesit të tij. Ne muslimanët që të jemi të suksesshëm duhet të shtojmë ndjenjën e respektit ndaj Allahut, duhet të zhvishemi nga egoizmi dhe të marrim si shembull të dërguarin dhe sahabet. Vetëm atëherë mund të jemi të suksesshëm ashtu sikurse qenë gjeneratat e para të Islamit.

Ali Jakup Hoxha vdiq në muajin maj të vitit 1988 në moshën 75 vjeçare dhe u varros në Varrezët e Edirne Kapës. Allahu e mëshiroftë….

Shprehje dhe këshilla të tija….

Bëhuni të sinqertë, nuk bën pa pare, por edhe nuk jetohet pa to!

Frojdi e ka bërë njeriun kafshë…

Sikur të më japin të tërë botën nuk do t'ia hidhja sytë. Falënderoj Allahun që nuk i kam dhënë rëndësi dunjasë...

Të gjithë dashuritë janë boshe krahas dashurisë për Allahun dhe të dërguarin e tij...

Sejjid Kutupi nuk mund të shkruante një tefsir si ai i Xhelalejnit, por dua të them se në historinë islame nuk ka tefsirë ku të jetë shpjeguar thelbi i Islamit ashtu sikur se në "Fi dhilali Kur'an".

Unë dua më shumë atë që di pak dhe është i drejtë sesa atë që di shumë dhe është në rrugë tëgabuar.

Mysafirëve të Jordanisë! Pejgamberi ka qënë Arab prandaj i dua Arabët…

Dijetari nuk duhet të kërkojë para asnjëherë, nëse kërkon edhe nderi, edhe respektin që gëzon e humbet.

Duke bërë shenjë nga televizori thoshte se ditën e gjykimit njerëzit do të pendohen shumë për kohën që kanë humbur më kot..

Kur isha në shkollën fillore shënimet i mbaja në gjuhën Osmane…

I Dërguari i Allahut (s. a. s.) paralajmëron të gjithë kohërat!

Do vijë një kohë e tillë që...

"Ju jetoni në një kohë, që nëse njëri prej jush heq dorë prej gjërave me të cilat është urdhëruar, do të shkatërrohet. Pastaj do të vijë një kohë, që nëse njëri prej jush kryen vetëm një të dhjetën e asaj që është urdhëruar, do të shpëtojë." (Tirmidhi, Fiten, 79/2267)

"Do vijë një kohë, që nuk do të ketë gjë më të rëndësishme se këto tri gjëra: para, hallall, një vëlla që do të shoqërohet përzemërsisht, dhe një sunnet me të cilin do veprohet." (Hejsemi, I. 172)

"Do të vijë një kohë, që njeriu nuk do të shikojë (nuk do t'i interesojë) se në ç'mënyrë ka fituar pasurinë e tij, hallall apo haram..?" (Buhari, Sihr; 7)

Sipas Ebu Said El-Hudri transmetohet se i Dërguari i Allahut (xh. sh.) ka thënë: "Në mesin tuaj do të dalë një grup që do të nënvlersojë namazet e tyre pranë namazit tuaj, agjërimet e tyre pranë agjerimit tuaj dhe punët e tuaja të tjera pranë punëve të tyre. Ata lexojnë Kur-an, por leximi i tyre nuk u bën dobi. Ata dalin nga feja ashtu siç del shigjeta prej harkut." (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 36)

"Vaj halli për njerëzit, intriga e të cilëve po afrohet shumë. Njerëzit në mëngjes gdhijnë besimtarë, ndërsa në mbrëmje bëhen jobesimtarë. Fenë e tyre e ndërrojnë me interesat e kësaj bote. Ja pra, ata të cilët kanë mbetur të qëndrueshëm në fenë e tyre janë si ata që në duart e tyre mbajnë prush. {Ahmet b. Hanbel, Musned, II. 390; Për më tepër shih. Muslim, Iman 186; Tirmidhi, Fiten 30, (2196)}

"Do të vijë një kohë, që gjithë njerëzit do të punojnë me kamatë (fajde). Madje edhe ata të cilët ruhen prej saj do të mbeten të ndikuar nga ajo." (Nesai, Sihr 2; Ibni Maxhe, Tixharat 58; Ibni Hanbel, Musned, IV. 494; Bejhaki, Sunen, IV. 275)

"Do të vijë një kohë e tillë, që i drejti do të përgënjeshtohet, kuse gënjeshtari do të vërtetohet. Njerëzit e besueshëm do të konsiderohen si tradhtarë dhe tradhtarët do të konsiderohen si të besueshëm. Njerëzit do të dëshmojnë atë ç'ka nuk do t'u kërkohet dhe do të betohen për atë që nuk do t'u lypet." (Taberani, XXIII. 314)

"Do të vijë një kohë e tillë, që njerëzit nuk do t'i japin rëndësi të mirës dhe nuk do të ruhen nga të këqijat." (Hejsemi, Mexhmauz-Zevad, VII. 280)

Sevban (r. a.) transmeton se Profeti (a. s.) ka thënë: "Së shpejti do të vijë koha kur drejt jush do të sulmojnë popuj sikur sulmojnë bishat e uritura drejt ushqimit të vet. E pyetën: "A është kjo për shkak të asaj se do të jemi pak, o i Dërguari i Allahu?" Ai tha: "Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën nga ju, kurse në zemrat taja do të vë dobësinë? Ç'është dobësia,

Në mesin tuaj do të dalë një grup që do të nënvlersojë namazet e tyre pranë namazit tuaj, agjërimet e tyre pranë agjërimit tuaj dhe punët e tuaja të tjera pranë punëve të tyre. Ata lexojnë Kur'an, por leximi i tyre nuk u bën dobi. Ata dalin nga feja ashtu siç del shigjeta prej harkut.



Profeti (a. s.) ka thënë: "Së shpejti do të vijë koha kur drejt jush do të sulmojnë popuj sikur sulmojnë bishat e uritura drejt ushqimit të vet. E pyetën: "A është kjo për shkak të asaj se do të jemi pak, o i Dërguari i Allahu?" Ai tha: "Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën nga ju, kurse në zemrat taja do të vë dobësinë? Ç'është dobësia, o i Dërguari i Allahut? "Dahuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja" tha ai.

o i Dërguari i Allahut? "Dashuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja" tha ai. (Ebu Davud, Melahim 5/ 4297)

Transmeton Zubejr b. Adij duke thënë: "Shkuam tek Enes b. Malik dhe iu ankuam atij prej Haxhaxhit." "Duroni, tha ai, sepse ju do të takoni kohët e tilla që, çdo ditë e re do të jetë më e keqe se ajo që ka kaluar. Kjo gjendje do të vazhdojë deri sa të takoheni me Zotin tuaj. Unë këtë e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (xh. sh.)" (Buhari, Fiten 6; Tirmidhi, Fiten 35/2206)

"Juve do t'ju vijë një kohë e tillë që, në atë kohë, ju keni për të menduar, se njerëzit më të mirë do të jenë ata të cilët nuk thërrasin në mirësi dhe nuk ndalojnë nga të këqijat." (Ali El-Muttaki, Kenz, III. 686/8462)

Pejgamberi (a. s.) ka thënë: "Njerzëve do t'ju vijë një kohë e tillë që, zemra e besimtarit në atë kohë do të shkrihet siç shkrihet kripa në ujë. Kur u pyet se: "Përse do të shkrihet, o Dërguari i Allahut?". Ai u përgjigj: "Sepse të këqijat i sheh dhe nuk ka fuqi t'i ndryshojë ato." (Ali El-Muttaki, Kenz, III. 686/8463)

Përsëri, i Dërguari i Allahut (xh. sh.), në këto kohëra ku ka bërë të ditur se fetaria është e vështirë të mbahet si prushi në dorë, njofton edhe rrugëzgjidhjet... kështu që, ai vë në dijeni se të mirat e një njeriu në këto kohëra do të jetë e barabar-të më të mirat e 50-të përsonave në kohërat pa intriga.

Vini re se, paralajmërimet e të Dërguarit të Allahut (xh. sh.), tregojnë pushtetin e të këqijave, gabueshmërisë, parregullsisë e pa drejtësisë dhe kohën ku rregullimi i tyre është i vështirë. Bashkësia muslimane, i ngjason një bashkësie me tevbe, me urdhëresat për të mira dhe me ndalimet nga të këqijat. Megjithatë kjo mekanizëm shkatërrohet dhe kriteret mirësi-ligësi prishen.

I Dërguari i Allahut thotë: "Mbillni një fidan edhe po të shihni se po ndodhë (Dita e Gjykimit, Kijametit)." Profeti, thërret madje edhe në momentin e fundit. Lum ai që e dëgjon këtë thirrje në ç'do moment!

Evans Drishti

Pse e studiojmë jetën e Profetit Islam?

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Salat dhe selam qoftë mbi Allahun dhe mbi të Dërguarin e Tij Muhammedin (a. s.)!

Shprehja "I Dërguari i Allahut" mund të trajtohet në mënyra të ndryshme sipas vendit, zonave dhe kohërave. Njeriu tek myslimanët është më i respektuari mes krijesave dhe kështu që edhe i dërguari i Allahut është më i respektuari mes njerëzve. Ky, padyshim shihet si tipari më i veçantë i njerëzimit.

Jeta e njeriut është ndarë në dy pjesë të rëndësishme: në atë materiale dhe shpirtërore. Mundësimi i një përshtatjeje të ekuilibruar dhe dhënia e një shembulli të zbatimit të një jete të tillë do të ishte ideali i një njeriu që do të ishte udhëzues i njerëzve.

Historia është njohur me shumë mbretër, dijetarë dhe të shquar të panumërt, jeta e të cilëve ka qenë e mbushur me shumë shembuj të mrekullueshëm që kanë qënë me vlerë për t'u ndjekur. Pse e ndjejmë të nevojshme të studiojmë jetën e Muhammedit (a. s.), që është një njeri si gjithë të tjerët, megjithëse kanë kaluar afërsisht rreth katërmbëdhjetë shekuj që nga koha e ndarjes së tij nga jeta, megjithëse shkenca ka përparuar jashtë mase e në mënyrë të pabesueshme dhe megjithëse edhe vetë gjendjet e termat tona kanë pësuar ndryshime të theksuara?

Për një musliman, përgjigja e kësaj pyetjeje është tepër e thjeshtë. Një njeri që nuk ndjek rrugën e profetit Muhammed (a. s.) në jetën e tij, ai nuk mund të jetë musliman, por për një person që akoma nuk i di detajet e jetës së Profetit tonë Muhammed (a. s.) është me vlerë të kujtohen disa aspekte:

A) Mësimet e tij janë realizuar nën mbikqyrjen e Zotit dhe janë ruajtur për brezat e mëvonshëm në mënyrën më të sigurtë. Mes udhëzuesve të mëdhenj fetarë të ndryshëm, Muhammedi (a. s.) mesazhet dhe shpalljen e marrë nga Allahu herë pas here, nuk i transmetonte vetëm në rrethin e tij. Ai në të njëjtën kohë mendonte t'ua jepte edhe shkruesve për t'i shkruajtur dhe në këtë mënyrë të mundësonte shtimin e këtyre shembujve në mes sahabëve. Ruajtja e mësimve të tij dhe leximi i teksteve të shpallura gjatë adhurimeve janë bërë si një detyrë fetare parimore. Në këtë aspekt nevojitej mësimi përmendësh i teksteve hyjnore. Mësimi i këtyre teksteve ka vazhduar pa ndërprerje. Secila nga këto dy metoda (shembujt me shkrim dhe të mësuarit përmendësh) mbështesin njëra - tjetrën, përsa i përket pasqyrimit të mesazhit hyjnor. Ky tekst Kur'anor është

Historia është njohur me shumë mbretër, dijetarë dhe të shquar të panumërt, jeta e të cilëve ka qenë e mbushur me shumë shembuj të mrekullueshëm që kanë qënë me vlerë për t'u ndjekur. Pse e ndjejmë të nevojshme të studiojmë jetën e Muhammedit (a. s.), megjithëse kanë kaluar afërsisht rreth katërmbëdhjetë shekuj, megjithëse shkenca ka përparuar jashtë mase e në mënyrë të pabesueshme?

Për një musliman përgjigja e kësaj pyetjeje është tepër e thjeshtë. Një njeri që nuk ndjek rrugën e profetit Muhammed në jetën e tij, ai nuk mund të jetë musliman.

më gjithëpërfshirës sesa të mbledhësh së bashku Teuratin dhe katër Ungjillët. Atëherë të mos habitemi kur ai përmbledh urdhëresa dhe formula që lidhen me të gjitha fushat e jetës së njeriut.

B) Muhammedi (a. s.) asnjëherë nuk ka pretenduar të ketë përfshirë në monopolin e vet nderin e të qenurit i dërguar i Allahut. Përkundrazi, ai përherë ka theksuar se Allahu ka dërguar profetë të gjithë popujve. Ai ka theksuar emrat e disave perj tyre si: Ademi (a. s.), Idrisi (a. s.), Nuhi (a. s.), Ibrahimi (a. s.), Musai (a. s.) Davudi (a. s.) Isai (a. s.) etj. dhe gjithashtu ka theksuar se ka edhe shumë të tjerë, emrat e të cilëve nuk i ka përmendur. Ai ka theksuar se ka edhe detyra të tilla, si të ndërtojë përsëri vetëm jetën që s'ka fillim dhe mbarim dhe t'i bëjë çështje të ditës ato gjëra që u kanë predikuar njerëzve pejgamberët e mëparshëm, por që janë prishur dhe kanë humbur si rezultat i luftrave të ndodhura në periudhat më të vështira të atyre që vijnë nga gjiri i Ademit dhe i Havasë. Besimi i Muhammedit (a. s.) ishte i plotë përsa i përeket faktit që mesazhi hyjnor do të mbetet i pandryshuar dhe i paprishur deri në atë mënyrë sa nuk do të ndiehet nevoja e dërgimit të një të dërguari tjetër pas tij. Me të vërtetë, ne sot kemi në dorë faktet reale e të vërteta të Kur'anit e të Hadithit dhe kjo gjuhë akoma ruan origjinalitetitin dhe freskinë e saj.

**Që
në ditët e para të kumtimit, Muhammedi (a. s.) i bën thirrje gjithë botës: Ai nuk e ka kufizuar veten me asnjë popull apo periudhë; nuk ka vënë në dukje asnjë dallim kombësie apo klase; sipas Islamit barazia e plotë mes njerëzve dhe epërsia personale në punët e bëra me dëshirë janë themelore.**

C) Që në ditët e para të kumtimit, Muhammedi (a. s.) i bën thirrje gjithë botës: Ai nuk e ka kufizuar veten me asnjë popull apo periudhë; nuk ka vënë në dukje asnjë dallim kombësie apo klase; sipas Islamit barazia e plotë mes njerëzve dhe epërsia personale në punët e bëra me dë-shirë janë themelore.

e keqja e vetme ashtu sikurse sherri i vetëm, janë dukuri të veçanta që hasen pak në shoqëritë njerëzore dhe shumica e tyre futen në klasën "njeriu i mesëm" Muhammedi (a. s.) nuk e ka kufizuar ha-pësirën që interesohej "me engjuj" që ndodhen mes njerëz-ve. Predikimi i tij, në fakt, i drejtohet njerëzve të thjeshtë që përbëjnë shumicën e madhe të njerëzve. Me shprehjen e Kur-anit njeriu duhet të kërkojë mirësinë dhe të dobishmen si në këtë botë kalimtare ashtu edhe në botën tjetër.

E) Historia njerëzore nuk ka qëndruar larg mbretërve, sunduesve, reformatorëve, prijësve

Me çdo gjë që lidhej me jetën si personale ashtu edhe të përbashkët, si shpirtërore ashtu edhe të kohës, dhe përveç këtyre ka lënë edhe shembullin e tij të bukur.

Prandaj, para se të vendoset për jetën e tij, është e nevojshme të studiohet kjo jetë.

të mëdhenj etj. Por, secili prej tyre ka dhënë vlera të mëdha vetëm në fushën, në të cilën është interesuar. Mbledhja e të gjitha këtyre veçorive të ndryshme tek një person i vetëm - siç është rasti i Muhammedit (a. s.)- nuk mbetet vetëm thjeshtë si një rast i rrallë por në të njëjtën kohë përbën edhe një gjendje, që gjen mundësi zbatimi edhe nga njerëzit që i kanë mësuar mësimet e tij. Në këtë aspekt është shfaqur një mendim i ekuilibruar i përcaktuar me zbatimet e bazuara në prova.

F) Është e mjaftueshme të thuhet, se Muhammedi (a. s.), si një karakter reformist është një prijës i një feje, që është një nga fetë më të mëdha të botës së sotme, një fe që akoma e çon përpara ekzistencën e saj të freskët dhe që humbjet e saj duke u krahasuar me fitoret e përditshme mund të mos merren parasysh. Si një rob i dashur i Zotit dhe si një zbatues i urdhëresave hyjnore të urdhëruara vetes së tij, shohim që jeta e Muhammedit (a. s.) është e pafajshme dhe e palëkundshme. Si një organizator shoqëror, ne dimë se ai ka filluar punën që nga fillimi në një vend ku çdo gjë ishte tejet e ngatërruar dhe në fund të dhjetë viteve ka krijuar një shtet, që kishte një sipërfaqe rreth 3 milion km^2 dhe që përfshinte plotësisht gadishullin Arabik së bashku me zonat jugore të Irakut dhe Palestinës.Trashëgimtarët që i ka lënë porosi këtë shtet, brenda një kohe të shkurtër pesëmbëdhjetë vjeçare pas tij, e përhapën atë (shtetin) në tre kontinente si në Europë, Azi dhe Afrikë. Në luftërat e bëra në komandën e tij, humbjet e të dy anëve nuk i kanë kaluar disa qindra vetë dhe gjithashtu në të gjitha këto vende është mundësuar një bindje e mrekullueshme. Me të vërtetë, ai sundonte në shpirtrat e tyre më shumë sesa në trupat e tyre. Suksesi i arritur gjatë jetës, në detyrën e predikuesit, ka qënë i madh aq sa t'u bënte thirrje një grumbulli besimtarësh rreth 150.000 vetësh në Arafat gjatë Haxhit të Lamtumirës. Ndërsa në fakt, shumë muslimanë, në momentin e asaj ngjarjeje historike, patën mbetur në vendet e tyre pasi nuk e kishin të detyruar të shkonin çdo vit në Haxh.

G) Muhammedi (a. s.) asnjëherë nuk e shihte veten e tij mbi rregullat që ua transmetonte muslimanëve. Përkundrazi, ai falte namaz, agjëronte dhe jepte lëmoshë (zekat) shumë më tepër sesa i urdhëronte shokët e vet. Si në kohë paqeje ashtu edhe si në kohë lufte, ai sillej i drejtë dhe i mëshirshëm ndaj armiqve.

H) Përsa i përket gjërave që i jepte si mësim: ai interesohej me të gjitha drejtimet e jetës, me besimet, zbatimet shpirtërore, moralin, ekonominë, politikën. Shkurtimisht, me çdo gjë që lidhej me jetën si personale ashtu edhe të përbashkët, si shpirtërore ashtu edhe të kohës, dhe përveç këtyre ka lënë edhe shembullin e tij të bukur.

Prandaj, para se të vendoset për jetën e tij, është e nevojshme të studiohet kjo jetë.

Marrë nga libri "Pejgamberi Islam" i autorit Muhammed Hamidullah



Sa e duam ne atë?

Ata të cilët mundohen t'i gjejnë të meta atij, nuk bëjnë gjë tjetër veç se shfaqin dobësitë dhe të metat e tyre. Historia është e mbushur me fajsitë dhe padrejtësitë që popujt i kanë bërë ndaj profëtve të tyre.

Edhe në ditët e sotme Profetit (a. s.), po i bëhen shpifje të shëmtuara por në të vertetë ata nuk i përkasin atij. Ato shpifje nuk janë gjë tjetër veç se moralet e tyre të shëmtuara. Një dijetar me ëmrin Mevlana, sa bukur thotë: "Kur Allahu (xh. sh.) dëshiron t'ia heq perden dikuj dhe të dalin në pah të metat e tij, në zemër i vendos dëshirën për të sharë (kritikuar) të tjerët".

Shembull i vetëm, Profeti alejhi selam.

Zoti (xh. sh.) për të na këshilluar dhe për të na udhëzuar ka dërguar profetë. Numri i profetëve që kanë ardhur si mirësi dhe fisnikëri nga ana e Tij, që para 1400 vjetësh, është më shumë se 124.000. Ndërsa profetin më të zgjedhur, më të veçantë dhe që Zoti (xh. sh.) e donte më së shumti, e dërgoi në fund. Allahu (xh. sh.) çdo profet e ka dërguar për një komb, ai profet e udhëzonte atë popull sipas gjëndjes sociale të asaj kohe. Kurse Profeti (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë me të), është dërguar për të gjitha botrat. Ndërsa libri që i është dhënë, Kur'ani, është i vlefshëm deri në ditën e gjykimit.

Të verbërit gjejnë të meta edhe në diell.

Ai që nuk i ka sytë e verbëra patjetër që e sheh atë. Nëse nuk është i shashtisur, në të nuk gjen asnjë të metë. Ata të cilët mundohen t'i gjejnë të meta atij, nuk bëjnë gjë tjetër veç se shfaqin dobësitë dhe të metat e tyre. Historia është e mbushur me fajësitë dhe padrejtësitë që popujt i kanë bërë ndaj profëtve të tyre. Disa njerëz nuk iu përgjigjën të vërtetës që predikoi Profeti (a. s.), vetëm e vetëm se ra ndesh me dëshirat e tyre vetiake. Kështu që, ata me qëllim që të sigurojnë pranimin si të ligjshme dhe morale të jetës se tyre, janë dhënë pas vetes; dobësitë dhe cilësitë e tyre të shëmtuara, mundohen që t'ia atriubojnë Profetit (a. s.) Edhe në ditët e sotme Profetit (a. s.), po i bëhen shpifje të shëmtuara por në të vertetë ato nuk i përkasin atij. Ato shpifje nuk janë gjë tjetër veç se moralet e tyre të shëmtuara. Një dijetar me emrin Mevlana, sa bukur thotë: "Kur Allahu (xh. sh.) dëshiron t'ia heq perden dikuj dhe të dalin në pah të metat e tij, në zëmër i vendos dëshirën për të sharë (kritikuar) të tjerët".

Njerëzimi nuk duhet të merret me përgojimin e Profetit (a. s.) Përkundrazi, duhet të mendojë se si t'i shprehim atij falënderimet më të ngrohta; sepse zemra që nuk mbushet me ndjenjat e falendërimit për të, i cili që nga lindja e deri në vdekje u përpoq që të shpëtonte dhe të udhëzonte njerëzimin, nuk është një zëmër sensibile.

Interesimi i Profetit (a. s.) për ne.

Shiko se si Allahu (xh. sh.) tregon në suren Tevbe rreth përpjekjeve e Profetit (a. s.) për të na udhëzuar dhe për të na bërë gjithmonë të lumtur: "Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët" (Tevbe, 128). Ashtu që, dashuria e Profetit (a. s.) për ne

Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët. Unë jam Profeti më i apasionuar (pas punëve të njerëzve) dhe më i durueshëm ndaj shtypjeve dhe vuajtjeve të tyre.

është shumë më e madhe se dashuria e një nëne dhe një babai për fëmijët e tyre. Është ai Profeti i nderuar që ka thënë: "Unë jam Profeti më i apasionuar (pas punëve të njerëzve) dhe më i durueshëm ndaj shtypjeve dhe vuajtjeve të tyre." Dhe për këtë ndërgjegjja e tij, kurrë nuk u ankua. Por vuajtjet qe hiqte ummeti i tij ia dogjën zemrën. Ai është një Profet aq i mëshirshëm sa që nuk përpiqet vetëm për shpëtimin dhe faljen e gabimeve tona në këtë botë por edhe ditën e gjykimit, i përulur në sexhde poshtë arshit, do t'i lutet Allahut (xh. sh.) për ne dhe do të vazhdojë të derdhë lot deri sa të pranohet lutja e tij." (Shih. Buhari, Enbija: 3, 9; Muslim, Iman: 327, 328; Tirmidhi, Kijamet: 10)

A nuk duhet që ne sot, në shenjë falendërimi ndaj këtij Profeti (a. s.), i cili si në këtë botë ashtu edhe në ahiret, përpiqej për faljen e mekatëve tona (shefat), të përpiqemi për t'u bërë besimtarë të mirë ashtu siç dëshironte ai?

Për të qënë një pasues i tij, kërkohet një zemër e pastër.

Për të sigurar lumturinë tonë, në këtë botë të trazuar dhe në fushën e mahsherit (në ditën e gjykimit), duhet që në çdo hap të jetës sonë të marrim si shembull Profetin tonë të dashur. Duhet që atë ta marrim si shembull në çdo punë sociale, familjare apo vetiake (personale). Ai, është shembull për të gjithë, duke filluar nga shkalla më e ulët e deri tek shkalla më e lartë e njerëzve…

Si duhet ta marrim shembull atë? Duke e lexuar në letër? Jo. Mësimin e këtij shembullit do ta ushtrojmë në botën e zemrës sonë. Zoti (xhel-le xhelaluhu), e ka treguar qartë metodën e këtij mësimi, në suren Ahzab.

Kushti i parë i këtij mësimi është: Shpresimi për t'u takuar me Allahun (xh. sh.). Zemra të jetë gjithmonë me Allahun (xh. sh.) Në ajetin Kur'anor thuhet: " Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendimin rreth krijimit të qiejve e të tokës…" (Ali Imran, 191)

Duhet të ndjejmë se gjithmonë jemi nën vëzhgimin e kamerës hyjnore. Zoti është më afër nesh se sa damari i qafës. Po ne, sa afër Tij jemi? Për të formuar këtë afërsi me Allahun (xh. sh.), Profetin (a. s.) duhet ta marrim si shembull.

Kushti i dytë i këtij mësimi është: shpresimi për të fituar ahretin. Duhet të dimë se kjo botë është e përkohshme dhe së shpejti kësaj jetë do t'i vijë fundi. Sa bukur e shpreh Mevlana këtë: "Jeta e kësaj bote është thjesht një ëndërr. Të zotërosh pasuri në këtë botë, është sikur të gjesh një thesar në ëndërr. Pasuria, në këtë botë, trashëgohet brez pas brezi dhe përsëri mbetet e kësaj bote".

Kështu që, duhet të kuptojmë se ndodhemi brenda një bote, e cila është thjesht një sprovë. Për këtë arsye, dashuritë tona shpirtrore duhet që t'i hedhim tej. Zemra jonë duhet të ëndërrojë gjithmonë jetën e pafundme. Dhe për ta fituar

Si duhet ta marrim shembull atë? Duke e lexuar në letër? Jo. Mësimin e këtij shembullit do ta ushtrojmë në botën e zemrës sonë. Zoti xhel-le xhelaluhu, e ka treguar qartë metodën e këtij mësimi, në suren Ahzab.

këtë jetë, shëmbulli i vetëm është ndjekja e rrugës së Profetit tonë.

Shenjat e dashurisë për të.

Njeriu e përmend shpesh atë që do, në çdo rast përpiqet të flasë me dashuri për të dhe të tregojë nga virtytet e tij. Një biznesmen që është dhënë pas punës së vet, flet gjithmonë për tregti. Në këtë mall fitova kaq, e në atë mall humba aq. Këtu do të fitoj kaq… e kështu me radhë. Dikush e do shumë fëmijën e tij, në çdo kohë, në çdo vend tregon për të. Ndërsa, sahabet e nderuar dhe dijetarët, gjithmonë kanë prentenduar të flasin për të dërguarin e Allahut (xh. sh.) dhe nga kjo kanë ndier gjithmonë kënaqësi. Ata kanë ecur në rrugën e të Dërguarit (a. s.) aq sa Imam Neveviu nuk ka ngrënë shalqi, kurrë në jetën e tij, për shkak se s'kishte dëgjuar asnjë hadith që të tregonte se si Profeti (a. s.) e kishte prerë shalqirin.

Sahabet e nderuar dhe dijetarët, gjithmonë kanë prentenduar të flasin për të dërguarin e Allahut (xh. sh.) dhe nga kjo kanë ndier gjithmonë kënaqësi. Ata kanë ecur në rrugën e të Dërguarit (a. s.) aq sa Imam Neveviu nuk ka ngrënë shalqi, kurrë në jetën e tij, për shkak se s'kishte dëgjuar asnjë hadith që të tregonte se si Profeti (a. s.) e kishte prerë shalqirin.

Ebu Bekri r.a. pyeti:

-Aishe, bija ime, ç'farë është sot?

- E hënë, baba.

- Të lutem bijë, nëse vdes sot mos më vononi por më dërgoni dhe më varrosni menjëherë pranë të derguarit të Allahut (xh. sh.)

Ky është shembulli i dashurisë për t'u takuar me të dashurin e Zotit (xh. sh.) Allahu (xh. sh.) na i pasuroftë zemrat me dashurinë që kishin sahabet për Profetin (a. s.). I lutemi Allahut të Madhëruar, të na i zbukurojë zemrat me moralin e të dërguarit të Tij, Muhammedit (salallahu alejhi ve sel'lem).

Âmin…

E vërteta mbi errësirë

Jetoja mes errësirës dhe padrejtësisë
mendoja se isha në rrugë të drejtë
por, nuk isha aty
një gjë ma ndriti shpirtin
dritë e plot jetë
e kuptova se është një Zot i vërtetë
Kur'anin e lexova
të gjitha të vërtetat aty i kuptova
fillova të qaj e s'dija të pushoj
iu lusja Allahut, pendimin tim ta pranojë
në xhami fshehurazi fillova të shkoja
të afërmit s'më linin aty kohën ta kaloja
ah çdo ditë qaja, qaja me lot
doja të dilja nga kjo errësirë, nga kjo e padrejtë
tashmë namazin unë e fillova
me plot t'kqija nga njerëzit u përballova
së pari nga familja u përgjënjeshtrova
nga kjo rrugë të largohesha më thonin
çdo gjë që thoja, të heshtja më thonin
kinse unë nuk kisha të drejtë
por isha vetëm një fëmijë turp për t'ju sjellë
kur vinte ndonjë fqinjë për t'na vizituar
vetëm kishin për t'më ngacmuar e poshtruar
predikimet e mia s'donin fare t'i dëgjonin
thjeshtë donin, sa më shumë të më largonin.

Mbase është e vërtetë
mbase kanë devijuar nga rruga e drejtë
"kënd e largon Allahu nga rruga e drejtë
s'ka kush për ta udhëzuar"
filluan të më rrahnin
në kish më dhunë të më qonin
nga Islami në cdo formë donin t'më largonin.
Çdo të dielë shkonin në kishë
ndërsa të xhumanë se merrnin parasysh
para kryqit luteshin, por kot
s'e kuptonin se te Allahu
ndihmë duhet t'kërkojnë.
Ah sa shumë vite i ngujuar jetova
duke shpresuar te Allahu jetën e kalova.
Erdhi një ditë kur nëna në dhomë më trokiti
deshi të dijë për Allahun e madhëruar
për të vërtetën që Profeti kishte luftuar.
Një nga një fillova t'ia tregoj
kur sytë e nënës lot t'lëshojnë filluan
bisedën tonë te dera vëllezërit dhe babai e ndëgjuan
nga flalët e Kur'anit sa shumë u penduan.
Më në fund Allahu zemrat ua ndriti
me flalët e Kur'anit i ngjalli e i rriti.
Nga pendimi lotët rriedhnin pa kufi
për Allahun e madhëruar
e shenjta lumturi!

Gentiana Rexha

Roli i sunnetit në formimin e personalitetit islam

Cilët ishin këta faktorë ndryshues që e bënë këtë shoqëri njerëzish që të ngrihen nga ultësirat e mediokritetit dhe bestytnive deri në lartësitë e kthjellëta shpirtërore, të cilat shkatërruan dhe hodhën poshtë perdet shekullore të injorancës dhe i bëri këta njerëz të meritojnë një vend nderi në librin e Allahut dhe në librin e historisë njerëzore!?

Falënderimi i takon Allahut, atë e falenderojmë, ndihmë dhe falje prej tij kërkojmë. Allahut i kërkojmë të na mbrojë prej të keqijave dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon askush nuk e humb dhe atë që Allahu e humb askush nuk e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër perveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi (alejhi selam) është rob dhe i dërguari i Tij, të cilin e dërgoi me fenë e vërtetë, të përgëzojë njerëzimin dhe të veprojë si shembull për ta.

Me dërgimin e Profetit të fundit, gjithashtu lindi edhe një gjeneratë e tillë njerëzish, të cilët treguan se qenia njerëzore mund të ngrihet në ato lartësi ku edhe engjujt nuk mund të arrijnë.

Le të mendojmë për pak çaste dhe të pyesim veten: "Vallë, cili qe shkaku që kjo gjeneratë njerëzish pësoi një mutacion ideologjik dhe praktik kaq të shpejtë dhe ndikues për të gjitha kohërat e mëvonshme!? Ç'farë i bëri këta njerëz të ndryshojnë me vetëdije dhe dëshirë të plotë pothuajse rrënjësisht gjithë jetën e tyre duke filluar që nga besimet, zakonet, sjelljet e deri tek kuptimi i vetë jetës!?

Cilët ishin këta faktorë ndryshues që e bënë këtë shoqëri njerëzish që të ngrihen nga ultësirat e mediokritetit dhe bestytnive deri në lartësitë e kthjellëta shpirtërore, të cilat shkatërruan dhe hodhën poshtë perdet shekullore të injorancës dhe i bëri këta njerëz të meritojnë një vend nderi në librin e Allahut dhe në librin e historisë njerëzore!?

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun..." [Ali Imran, 110.]

Nuk ka dyshim se faktorët mund të jenë të shumtë, por këta faktorë mund t'i mbledhim në tre faktorë kryesorë, që pa të cilët kurrë nuk do të mund të ndodhnin të tilla ndryshime. Këto janë:

1. Kur'ani, kushtetutë e shpallur nga Allahu (xh. sh.)
2. Personaliteti i Muhammedit (alejhi selam).
3. Udhëzimet, veprimet dhe mësimet e përgjithshme të Muhammedit (alejhi selam) , të cilat me një emër të përbashkët quhen Sunnet.

Nga këto tri baza u edukuan sahabët, të cilët ishin shembull në besim, moral dhe virtyte njerëzore. Është e vërtetë se pa baza të tilla, (mësime metodike dhe praktike nga Kur'ani e Hadithi) muslimanët kurrë nuk do të ecin përpara. Zgjidhjet e huaja nuk ndihmojnë dhe janë të papërshtatshme. Atë që e gjejmë në jetën e sahabëve të Muhammedit (alejhi selam), si besimin dhe punën, moralin e lartë islam, shijen e besimtarit të vërtetë, trimërinë dhe bujarinë, mëshirën dhe sinqeritetin nuk janë vetëm si burim i leximit të Kur'anit, por në këtë ka dorë dhe rol të barabartë Sunneti i Muhammedit (alejhi

selam). Ai është peshojë me të cilën duhet të maten veprimet e këtij ummeti dhe drejtimet e tij në të gjitha fushat.

Duhet të dimë, se çdo shtrembërim i shfaqur tek ne është rezultat i mospërfilljes së Kur'anit dhe Sunnetit. Muslimanët e sotëm duhet të udhëzohen vetëm me atë që u udhëzuan të parët e tyre. Çdo herë duhet të kthehemi në zanafillë: Kur'an dhe Sunnet. Kthimi te Muhammedi (alejhi selam) d.m.th. nënshtrim ndaj tij, në kohën kur ishte gjallë dhe kthim te Sunneti, pas vdekjes së tij. Kur'ani na udhëzon për nënshtrimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Po të mos ishte kështu, urdhëri për nënshtrim, i përsëritur në të njëjtën formë, do të ishte i pafunksion. Muhammedi (alejhi selam) është model i jetës sonë dhe në të kemi shembullin më të mirë. Dashuria ndaj Allahut shprehet me dashurinë ndaj të Dërguarit

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun..."

të Tij dhe përfilljes së gjithë asaj që urdhëron dhe ndalon.

Allahu (xh. sh.) thotë:

"Thuaj: Nëse e doni Allahun, ejani pas meje që Allahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Ai që fal shumë, mëshiron shumë." [Ali Imran, 31]

Sunneti është përplot gjallëri dhe fuqi. I arsyeshëm për ndikim dhe përmirësim, në çdo kohë dhe vend. Urdhëron për të gjitha virtytet e mira dhe ndalon nga të këqiat, thërret që çdo herë të kthehemi në zanafillë dhe të largohemi nga novatoritë (bid'atet), të cilat nuk kanë mbështetje në Kur'an dhe Sunnet, ose nuk janë në përputhje me atë që vepruan sahabët e Pejgamberit (alejhi selam). Lufton të gjitha traditat e injorancës pa marrë parasysh cilës shoqëri i takojnë. Sunneti pra, thirri në Islamin e vërtetë dhe burimor, andaj për këto arsye dhe shumë të tjera është nevojë dhe domosdoshmëri e këtij ummeti.

Librat e shkencës së Hadithit ishin dhe mbetën bazë e burimeve islame. Të gjithë dijetarët islamë janë kompaktë se libri më i vërtetë pas Kur'anit është Sahihu i Buhariut, i cili përmban vet fjalët e arta të Muhammedit (alejhi selam), e veçori e tij është se të gjitha hadithet e përmbledhura në të janë të vërteta dhe i plotësojnë kushtet më të larta, të cilat i kanë caktuar kritikuesit e shkencës së hadithit. Të mësuarit e hadithëve përmendësh dhe klasifikimi i tyre e po ashtu edhe librat, të cilat u shkruan për interpretuesit e hadithit janë dëshmi për vërtetësinë dhe origjinalitetin e Sunnetit. Vargu i transmetuesve është veçori e këtij

"Thuaj: Nëse e doni Allahun, ejani pas meje që Allahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Ai që fal shumë, mëshiron shumë."

ummeti, i cili po të zbatohej në ndonjë shkencë tjetër, pak gjëra do të mbeteshin të vërteta në atë shkencë.

Pra, në këto dëshmi shohim rolin e shkencës së Hadithit në ruajtjen e fesë. Sa më shumë të jemi afër mësimeve të hadithit (sunnetit) aq më tepër vjen në shprehje jeta jonë si muslimanë të vërtetë dhe të ruajtur nga devijimet e ndryshme. Ky pra, është edhe një tregues kryesor i një personaliteti të vërtetë Islam.

Refereca:
-Mexhel-letul "Minhel", nr.484, viti 1990 (numër special për hadithin dhe terminologjinë e tij).
-Marrë nga libri "Sunneti bazë e Sheriatit".
-Nga një shkrim i Sulejman Osmanit.

Shembull i shkëlqyer

Tani padyshim që te i dërguari i Allahut ju keni një shembull të shkëlqyer për ta ndjekur, për atë që shpreson takimin me Allahun dhe në Ditën e Ahiretit dhe që e kujton Allahun shumë.

Allahu, si nevojë e provimit hyjnor, njeriun e ka pajisur me mosbindje dhe devotshmëri; atë e ka cilësuar me një gjendje të përshtatshme si për të mirën ashtu edhe për të keqen. Me këtë prestigj qëllimi i fesë është që, në këtë mënyrë, ndjenjat negative vetiake që janë të suksesshme te njeriu, t'i zbresë sa më shumë pothuajse plotësisht, të shfaqjet e kundërta, dhe sikundër kësaj, t'i dërgojë cilësitë ndriçuese në kulm. Por, për realizimin e këtij qëllimi, njeriu ka nevojë absolute për një shembull konkret, domethënë për një shembull më të bukur siç është bërë shprehje "Usve-i hasene". Një nga urtësitë në dërgimin e profetëve është, cilësia e të qenurit e tyre një shembull i shkëlqyer që do të ishte pasues nga njerëzit.

Kjo cilësi, ka formuar një kulm te i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem dhe për këtë arsye, Allahu në një ajet fisnik thotë kështu:

"Tani padyshim që te i dërguari i Allahut ju keni një shembull të shkëlqyer për ta ndjekur, për atë që shpreson takimin me Allahun dhe në Ditën e Ahiretit dhe që e kujton Allahun shumë". (Ahzab, 21)

Në histori, i vetmi Profet dhe i vetmi njeri që i verifikohet komplet jeta e tij deri në detajet më të imta është Muhammedi (salallahu alejhi ve selem). Të gjitha veprat, fjalët dhe ndjenjat e tij duke u rregjistruar në ç'do çast, kanë kaluar në histori, në një formë tabelë nderi.

Veçoritë në këtë krijim të lartë , janë lotët e Atij që pikojnë në inteligjencën tonë. E fshehta për të qenë i arritshëm te Allahu, është afrimi te tradita e lartë e dritës së qënies dhe librit të Allahut, domethënë, të mund të afrohesh me moral të lartë dhe me zemër të sinqertë sjelljeve të tij, me dashuri atyre që do Allahu dhe i Dërguari i tij.

Jeta e tij është shembull për brezat që do të vijnë deri në kijamet. Në suren Kalem të Kur'anit Fisnik për atë thuhet kështu:

"Padyshim, ti je mbi një moral të lartë".

Biografia dhe personaliteti i të Dërguarit të Allahut, vetëm me shfaqjet që strehohen te konceptimi njerëzor, formon kulmin më të pa arritshëm të shembujve e të sjelljeve. Sepse, Allahu (xh. sh.) atë qënie të shenjtë e ka krijuar si një "Usve-i hasene" domethënë si një shembull i shkëlqyer për të gjithë njerëzinë. Për këtë arsye, duke e bërë atë të fillojë nga fëmijëria jetime, që është më e ulta nga aspekti i paaftësisë brenda shoqërisë njerëzore, duke e bërë të kalojë nga të gjitha gradat e jetës nga aspekti i fuqisë dhe aftësisë, e ka lartësuar deri te pika më e lartë, domethënë deri te profetësia dhe udhëheqja e shtetit. Gjer

Cilësia jote le të jetë çfarë të jetë, në ç'do lloj gjendjeje që të ndodhesh, mbrëmje-mëngjez, do ta gjeshë Muhammedin salallahu alejhi ue sellem si një udhëzues më të shkëlqyer për veten tënde!

Dije se biografia e Tij, ishte një kopësht trëndafilash i zbukuruar me trëndafila me erë misku nga lule të rralla dhe të hijshme!

për ata të cilët gjenden në ç'do lloj vendi të gradave të njerëzisë, duke marrë shembull sjelljet veprore për veten e tyre nga ai, të realizojnë lumturinë e përhershme. Kjo është në lidhje me mbështjelljen për dashurinë që ndihet për të dhe ndjenjave shpirtërore të tij.

Është shembull me udhëheqjen fetare. është shembull si udhëheqës shteti. është shembull për ata që hyjnë te lidhja e dashurisë hyjnore. është shembull me falënderimin dhe modestinë e tij kur ka poseduar mirësitë e Zotit. Është shembull me durimin dhe nënshtrimin e tij në kohëra dhe vende të vështira. Është shembull me bujarinë dhe zemërbutësinë e tij ndaj plaçkës së luftës. Është shembull me dashurinë e tij ndaj familjeve të tij. Është shembull me mëshirën e tij ndaj të pafuqishmëve, të vetmuarve dhe skllevërve. Është shembull me faljen dhe tolerancën e tij ndaj fajtorëve.

Nëse je një person i pasur që posedon pasuri, mendo modestinë dhe bujarinë e atij Profeti të lartë, i cili udhëhiqte të gjithë Arabinë, dhe në përgjithësi i bindi të mëdhenjtë e Arabëvë me dashuri!

Nëse je një i dobët nga populli, merr shembull nga jeta e Profetit, që jetonte nën sistemin dhe administrimin e mushrikëve dhunues dhe uzurpator në Mekë!

Nëse je një çlirimtar fitues, merr mësim nga jeta trimërore dhe nënshtruese e Profetit, që i mposhti për në fitore armiqtë e tij në Bedir dhe Hunejn!

Zoti na ruajt, nëse ke pësuar disfatë, kujto Pejgamberin mbështetës (te Allahu) që sillej me trimëri në mes shokëve të tij që kishin rënë dëshmorë ose ishin shtrirë të plagosur përdhe në luftën e Uhudit!

Nëse je mësues, mendo Profetin, i cili ua mësonte urdhërat hyjnore banorëve të Soffas duke ua transmetuar begatitë e zemrës së tij të butë dhe të ndjeshme!

Nëse je student, përfytyro Pejgamberin i cili ishte i ulur përpara Xhibrailit besnik që i sillte shpalljen atij!

Nëse je një predikues që këshillon dhe një udhëzues besnik, dëgjo Pejgamberin i cili përhapte urtësi te shokët e tij në xhaminë e Profetit! Jepi vesh dhe zemër fjalëve të ëmbla të tij!

Nëse je i vetmuar, mendo jetimin e Abdullahut dhe Aminesë, të pafajshmin e vetmuar që i donte fëmijët, mendo yetimin prej drite!

Nëse je një i ri që dëshiron të krijoshë një vatër shpirtërore, ki kujdes jetën familjare dhe këshillat e Profetit salallahu alejhi ue sellem. Zgjedhja jote le të jetë devotshmëria ashtuqë të arrishë lumturinë e të dy botërave!

Nëse je një tregtar që udhëton me karvane tregtie, mendo gjendjen e individit i cili ishte më i nderuari i karvanit që shkonte nga Siria në Busra!

Nëse je gjykatës, mendo sjelljen e Tij të drejtë dhe kuptimplotë në çështjen e vendosjes së gurit të zi në Qabe, kur të mëdhenjtë e mekkës do të përlesheshin me njëri tjetrin!

Përsëri duke e kthyer syrin tënd nga historia, shiko Profetin i cili gjykonte në formën më të drejtë ndërmjet njerëzve, duke e mbajtur të varfërin dhe të pasurin të barabartë në prani të tij në kohë të vështirë duke qëndruar në Medine!

Nëse je një bashkëshort, ki kujdes biografinë e Atij individi të shenjtë i cili ishte bashkëshorti i të nderuarës Hatixhe dhe i të nderuarës Aishe, ndjeshmërinë e thellë të tij,

Biografia dhe personaliteti i të Dërguarit të Allahut, vetëm me shfaqjet që strehohen te konceptimi njerëzor, formon kulmin më të pa arritshëm të shembujve e të sjelljeve. Sepse, Allahu (xh.sh.) atë qënie të shenjtë e ka krijuar si një "Usve-i hasene". Domethënë si një shembull i shkëlqyer për të gjithë njerëzinë.

butësinë e tij, ki kujdes të gjitha sjelljet e tij me drejtësi ndërmjet bashkëshorteve të tij.

Nëse je prind, mëso gjendjen e tij në sjelljet ndaj atyre të këtij individi që ishte babai i Fatimes dhe gjyshi i të nderuarve Hasanit dhe Hysejnit!

Cilësia jote le të jetë çfarë të jetë, në çdo lloj gjendjeje që të ndodhesh, mbrëmje-mëngjez, do ta gjeshë Muhammedin salallahu alejhi ve sellem si një udhëzues më të shkëlqyer për veten tënde!

Dije se biografia e Tij, ishte një kopësht trëndafilash i zbukuruar me trëndafila me erë misku nga lule të rralla dhe të hijshme!

Për shkak të kësaj vlere të lartë të Tij, Allahu Teala thotë:

"O ju që keni besuar, mos vendosni para se të vendosë Allahu dhe i dërguari i tij dhe kini frikë Allahun. Me të vërtetë Allahu është dëgjues dhe i gjithëditur."

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit, as mos i flisni atij me zë të lartë në bisedë, siç flisni me njëri tjetrin, përndryshe punët e juaja do t'ju shkojnë kot dhe ju të mos e ndjeni."

Ky ajet fisnik, i thërret të gjithë besimtarët për edukatë ndaj Profetit salallahu alejhi ve sellem.

Aishja radijallahu anha duke e përshkruar dritën hyjnore te i dërguari i Allahut thotë:

"Fytyra e të dërguarit të Allahut, natën ndiçonte aq shumë saqë i ngjante hënës katërmbëdhjetëshe. Natën e shtija perin në gjilpërë në dritën e fytyrës së tij."

Duke marrë mësim nga personaliteti i shenjtë i tij, ushtarët shpirtërorë të popullit që gjejnë veten te Ai, deri në kijamet kanë ekspozuar shembujt më të bukur për dashurinë e të dërguarit të Allahut. Kanë gjetur jetë në të vërtetën e të Dërguarit të Allahut.

Pas gjashtëdhjetë e tre viteve, Sejid Ahmed Jesevi i cili është heroi i madh i dashurisë dhe i entuziazmit, duke i hapur vetes një vend si varr, duke ekzekutuar jetën dhe adhurimet e tij, ishte njëri nga ata që përkujtohet në rugën e gjetjes së vetes që thoshte: "Pas kësaj moshe është haram për mua të eci mbi tokë".

Vejsel Karanit kur i erdhi lajmi se Profeti salallahu alejhi ve sellem kishte thyer një dhëmb të tij në Uhud, për shkak se nuk dinte se cilin dhëmb kishte thyer, të gjithë dhëmbët e tij iu bënë të panjohur. Duke i shkulur të gjithë dhe duke hedhur sikletin e atij dhëmbi të paditur që do të prishte fshehtësinë e gjetjes së vetes te Ai dhe të qenurit njëllojë, u qetësua.

Një gruaje nga bijtë e Dinarëvë, në Uhud, i ranë dëshmorë bashkëshorti, vëllai dhe babaii saj. Kur u njoftua se kan rënë dëshmorë të tre, tha:

"Ju më trëgoni të dërguarin e Allahut. Atë të shoh".

Dhe kur iu paraqit asaj Profeti salallahu alejhi ve sellem tha:

"O i dërguari i Allahut! Pasi Ti të jeshë gjallë, ç'do fatëkeqësi nuk është asgjë për mua."

Zonjës Hansa, që arriti qetësinë duke u bërë muslimane pas një jete me shumë strese, kur iu dha lajmi se të katër bijtë e saj kanë rënë dëshmorë në luftën e Kadisijjes, në entuziazmin e pjekur të një besimi te madh, duke thënë:

"Edhe katër bijtë e mi le të flijohen për fitoren e Islamit" e falënderoi Allahun në gëzimin e bërjes së saj nënë të katër dëshmorëve.

Përgjatë historisë, besimtarët e bekuar që kanë marrë pjesë nga "Usve-i hasene" e Pejgamberit salallahu alejhi ue sellem, i kanë ngritur daljet e zhvillimit të besimit, duke i përsosur gëzimet e shenjta në krijim, janë bërë pishtarë të lartë për njerëzinë.

Nëse je një person i pasur që posedon pasuri, mendo modestinë dhe bujarinë e atij Profeti të lartë, nëse je një i dobët nga populli, merr shembull nga jeta e Profetit, nëse je një çlirimtar fitues, merr mësim nga jeta trimërore dhe nënshtruese e Profetit.

Nëse je mësues, mendo Profetin, i cili ua mësonte urdhërat hyjnore banorëve të Sufes. Nëse je student, përfytyro Profetin, i cili ishte i ulur përpara Xhibrailit besnik që i sillte shpalljen atij! Nëse je një predikues, dëgjo Pejgamberin i cili përhapte urtësi te shokët e tij.

Ndërsa Valide Sulltan, sa bukur e tregon se ushqimi i shpirtit është nga dashuria e të dërguarit të Allahut, duke thënë:

Muhammedi erdhi nga dashuria,

Ç'është dashuria pa Muhammedin?!

Shkruesi i mevludit Sulejman Çelebi, me vargun e tij, "Kush është kjo dritë e çuditshme, flutur dielli..." sa bukur shpreh qenien flutur të diellit për profetin dhe rrotullimi përreth tij, domethënë, edhe krijesat e pashpirtë janë të dashuruara me Atë.

Veçoritë në këtë krijim të lartë që u munduam ta përmbledhim me mundësitë e kufizuara të fjalëve këtu, janë lotët e Atij që pikojnë në inteli-gjencën tonë. E fshehta për të qenë i arritshëm te Allahu, është afrimi te tradita e lartë e dritës së qënies dhe librit të Allahut, domethënë, të mund të afrohesh me moral të lartë dhe me zemër të sinqertë sjelljeve të tij, me dashuri atyre që do Allahu dhe i Dërguari i tij, dhe të kundërve me urrejtje.

Përgjatë historisë, besimtarët e bekuar që kanë marrë pjesë nga "Usve-i hasene" e Pejgamberit salallahu alejhi ve sellem, i kanë ngritur daljet e zhvillimit të besimit, duke i përsosur gëzimet e shenjta në krijim, janë bërë pishtarë të lartë për njerëzinë.

O Zot! Duke e bërë shkak të mëshirës dhe begatisë për ne këtë bisedë që u munduam ta shpjegojmë me mundësi të kufizuara të fjalëve, na e bëj rrisk të marrim mësim nga e vërteta e Muhammedit salallahu alejhi ve sellem.

Amin...

Përktheu: **Fatmir Sulaj**

Mr. Hamdi Thaçi

MREKULLITË E KUR'ANIT

Të devotshmit do të mbështeten në jastëk të gjelbër, të mbuluar me qilima të një bukurie magjepëse. (Kur'an, Rahman 76) Mrekullia dhe komentimi i kur'anit në dritën e njohurive të reja interdisiplinare!

Bërthama e atomit dhe bërthama e elektronit, mu në skaj të universit dhe kuazarët janë, po ashtu, me ngjyrë të gjelbër. Që të vërehet bërthama e atomit, ne duhet të zmadhohemi dhe të zgjerohemi gjer në 17 milionë km. Parimi: - bëju, dhe ajo bëhet. (Kur'an 36/82)

Gjithashtu edhe kromozonet janë me ngjyrë të gjelbër, ndërsa neuronet e posaformuara tregojnë shkëlqimin e gjelbër.

Jashtëtokësorët janë një dukuri brilante, edhe ufo-ja dhe vilaje janë me ngjyrë të gjelbër. Një pjesë e syrit, sythi i bimës, klorofili, bila (vreri) është produkt, kërthiza, pankreasi dhe algat të gjitha janë me ngjyrë të gjelbër. Procesi i fotosintezës dhe amazona -mushkëritë e njerëzimit- po ashtu janë me ngjyrë të gjelbër. Diamanti i gjelbër - më i kushtueshmi.

Tri ngjyra monoteiste janë: ngjyra e kuqe, simbol i Krishterizmit; ngjyra e verdhë, simbol i Judeizmit; ngjyra e gjelbër, simbol i Islamizmit. P.sh.: Semafori me ngjyrë të kuqe ndalon çdo gjë; semafori me ngjyrë të verdhë ndalon çdo gjë; kurse semafori me ngjyrë të gjelbër qarkullon çdo gjë.

Rotacioni (ngjyra e gjelbër), simbolizon energjinë e erës, që është dominante në ndryshimin e klimës . . .

Shkronja "a" është energjia e erës. Ngjyra e gjelbër është në mes njërës dhe tjetrës, respektivisht, ndërmjet meje dhe teje.

A ka dëshmi më të madhe !

Vërejtje: Vallë a janë talibanët primitivë apo të verbër? Respektivisht, drejtësia - demokracia Islame në avokatin e zymtë. . .

19. 07. 2001 Prishtinë

SI U BËNË MUSLIMANË?

Muslimanët e Açe's jetojnë një jetë të thjeshtë, modeste dhe janë të lidhur ngushtë me fenë e tyre. Një nga vellëzerit tanë (muslimanë), që kishte shkuar për të dhënë ndihmesën e tij, tregon se muslimanët, atje, për qytetin e Açe's përdorin termin "Serambi Mekke", d.m.th. "Lulishtja e përparme e Mekës". Shitja e alkoolit është e ndaluar. Në shumë rrugë të këtij qyteti, gjenden pankarta të varura ku shkruhet "Nderojeni Islamin". Me këtë, ata duan të tërheqin vëmendjen e të huajve që vijnë për t'i ndihmuar, duke u dhënë atyre mesazhin se Açe'ja është një tokë muslimane dhe sipas kësaj duhet të sillen.

Indonezia, me një popullsi afërsisht 250 milion banorë, - 87 % e së cilës përbëhet nga muslimanët- është shteti me popullsi muslimane më të madhe në botë.

Tërmeti i vitit të kaluar (26 dhjetor 2004) me epiqendër në Sumatra, me një madhësi prej 9.0 ballësh dhe si pasojë e vërshimit të Tsunamit, duke shkatërruar bregdetin e zonave për rreth, kryesisht zonën e Açes në Indonezi, bëhet shkak i një fatkeqësie të madhe edhe për shtetet fqinjë. Shumë ishuj mbetën nën ujë duke u fshirë kështu nga harta.

Që nga ajo ditë, veçanërisht Indonezia dhe zona e saj Açe, të cilat u prekën më shumë nga kjo fatkeqësi janë berë një kronikë e rëndësishme për ne. Brengat dhe hidhërimet e tyre na shqetësojnë gjithmonë dhe na lëndojnë zemrat. Sepse këtë e kërkon historia dhe kultura që ne na bashkon me ta. Për herë të parë, në shekullin e 16-të, kur muslimanët e Açe-s kërkuan ndihmë nga Perandoria Osmane kundër pushtimit të Portugezëve, e deri në fillimin e

shek. 20-të, në mes të dy popujve (perandorisë Osmane dhe Indonezisë) janë themeluar marrëdhënie të ngushta materiale dhe shpirterore.

Muslimanët e Açe's jetojnë një jetë të thjeshtë, modeste dhe janë të lidhur ngushtë me fenë e tyre. Një nga vellëzerit tanë (muslimanë), që ka shkuar për të dhënë ndihmesën e tij, tregon se muslimanët, atje, për qytetin e Açe's përdorin termin "Serambi Mekke", d. m. th. "Lulishtja e përparme e Mekës". Shitja e alkoolit është e ndaluar. Në shumë rrugë të këtij qyteti, gjenden pankarta të varura ku shkruhet "Nderojeni Islamin". Me këtë, ata duan të tërheqin vëmendjen e të huajve që vijnë për t'i ndihmuar, duke u dhënë atyre mesazhin se Açe'ja është një tokë muslimane dhe sipas kësaj duhet të sillen.

Sot, muslimanët e Açe's, krahas fatkeqësisë që ata jetuan, po tregojnë një durim të madh, qëndrueshmëri dhe mbështetje (tek Allahu) përballë urisë, etjes, vetmisë, sëmundjeve ngjitëse dhe problemeve të tjera të ngjashme me ta. Shembujt e moralit të lartë, që ata kanë treguar gjatë shpërndarjes së ndihmave, padyshim që e kanë burimin nga Islami.

Disa historianë tregojnë se njohja e Indonezisë, po ashtu edhe e Açe'se me Islamin është

realizuar në shekullin e 12-të me anë të tregtarëve muslimanë.

Kur lexova në këndin e një gazete shkrimin e Mehmet Aksu "stofi që kushtonte 5 akçe", ku tregonte se cili ishte shkaku që Indonezia të njihej me Islamin, u impresionova së tepërmi.

Ejani të lexojmë sëbashku tregimin ku shpaloset shembulli dhe sjellja atë ditë e një muslimani që me një personalitet të lartë dhe një karakter të lidhur ngushtë me besimin e tij (Islam), sot është bërë shkak për udhëzimin e 200 milion banorëve:

"Stofi që kushtonte 5 akçe"

Ai ishte një tregtar i thjeshtë. E ngarkoi stofin e tij në anije dhe u nis për në Indonezi. Pas një udhëtimi të lodhshëm detar anija arriti në birgjet e një ishulli të vogël.

E zbriti stofin nga anija, mori një dyqan me qera dhe filloi tregtinë. Për të zgjidhur problemin e gjuhës dhe për t'u shërbyer sa më lehtë klientëve të tij, punësoi një punëtor vendas.

Stofi ishte i një cilësie të lartë. Ashtu siç e kërkonte populli i atij vendi. Edhe ai vetë ishte shumë modest. Besonte në mbarësi. Ecte me parimin "fitim i pakët, por i pastër".

Brenda një kohe të shkurtër arriti të njihej dhe të duhej nga të gjithë. Dyqani pothujase gumëzhinte nga klientët.

Një ditë nuk ishte në dyqan. Erdhi me vonesë në vendin e punës. Punëtori kishte kryer një shitje të mirë. Nga malli i shitur kishte dalë mjaft fitim.

U bë kureshtar dhe pyeti punëtorin e tij: "nga cili stof ke shitur?"

-"Nga ky stof, zotëri"-u përgjigj punëtori.

-"Sa e shitë metrin?"

-"Dhjetë akçe"

-"Çfarë? Si ka mundësi", u zemërua tregtari. Si e shite 10 akçe stofin që kushton 5 (akçe)?! Shumë shtrenjtë e ke shitur. Ke mashtruar edhe klientin. I kemi hyrë në hak njeriut të shkretë. Po ta shikosh e njeh dot?"

- "Po zotëri, ishte njëri që e njoh."

- "Atëherë, shko menjëherë, gjeje njeriun dhe sille këtu.

Punëtori iku menjëherë, e gjeti klientin dhe e solli tek tregtari.

Pronari i dyqanit sapo e pa klientin i kërkoi falje, atij iu lut që t'ia bënte hallall dhe tha: "Na falni, punëtori ynë gabimisht stofin që kushtonte 5 akçe jua ka shitur për 10-të, të kemi hyrë në hak." Më pas i zgjati klientit pjesën e tepërt të parave dhe tha: "Kjo është sasia e parave që ju keni dhënë tepër, na e bëni hallall".

Klienti u çudit. Ishte hera e parë që përballej me një sjellje të tillë. Kurrë, më parë nuk kishte dëgjuar për një rast si ky dhe as fjalë të tilla. "Çdo me thënë ma bëj hallall?" Si ka mundësi një gjë e tillë? Copën e stofit e kishte marrë me pëlqimin e tij. Megjithatë e falënderoi tregtarin për sjelljen dhe doli nga dyqani i çuditur.

Ngjarja filloi të përcillej gojë më gojë dhe brenda një kohe të shku-rtër u dëgjua në të gjithë qytetin. Të gjithë i tregonin njëri-tjetrit për këtë ngjarje. Pa kaluar shumë çështja i ra në

"Unë" tha tregtari, "jam musliman". Jam një njeri që besoj. Feja Islame kështu urdhëron. Atë stof e kisha marrë 4 akçe dhe e shisja 5. Por punëtori im e kishte shitur 10 akçe. Kështu që, unë i kisha hyrë në hak klientit dhe për këtë shkak, në mallin tim ishte përzierë edhe fitimi haram. Unë vetëm rregullova një gabim të bërë.

Mbreti i bëri disa pyetje të njëpasnjëshme: "Çështë Islami, çështë Muslimanizmi, çështë morali Islam? Tregtari ia dha një nga një përgjigjet e duhura të të gjitha pyetjeve. Mbreti, për herë të parë, po dëgjonte për ekzistencën e një feje të tillë. Pa kaluar shumë kohë ai e pranon Islamin. Gjithashtu edhe populli i tij bëhet musliman.

"Tregtari i drejtë dhe i besueshëm, ditën e gjykimit, do të jetë bashkë me profetët, dëshmorët dhe të sinqertët."

vesh mbretit dhe vendosi që ta thërrasë shitësin e stofit në sarajet e tij. Ai dëshironte të mësonte se si qëndronte puna. Në mbretërinë e tij, për herë të parë, ndodhte një gjë e tillë. Brenda popullit të tij ishte e pamundur të ndodhte një gjë e tillë. Sepse gjithkush e shiste mallin e tij sipas dëshirës. Çfarë mund të ishte urtësia, që e shtynte këtë tregtar të huaj të bënte një veprim të tillë të çuditshëm?

Mbreti e pyeti: "Këtë veprim që ju keni bërë, ne as e kemi parë, as e kemi dëgjuar më parë. Si është e vërteta e kësaj sjelljeje? Cili është shkaku që ju shtyn të bëni një sjellje të tillë ?

"Unë" tha tregtari, "jam musliman." Jam një njeri që besoj. Feja Islame kështu urdhëron. Atë stof e kisha marrë 4 akçe dhe e shisja 5. Por punëtori im e kishte shitur 10 akçe. Kështu që, unë i kisha hyrë në hak klientit dhe për këtë shkak, në mallin tim ishte përzierë edhe fitimi haram. Unë vetëm rregullova një gabim të bërë.

Mbreti i bëri disa pyetje të njëpasnjëshme: "Ç'është Islami, ç'është Muslimanizmi, çështë morali Islam? Tregtari ia dha një nga një përgjigjet e duhura të të gjitha pyetjeve. Mbreti, për herë të parë, po dëgjonte për ekzistencën e një feje të tillë. Pa kaluar shumë kohë ai e pranon Islamin. Gjithashtu edhe populli i tij bëhet musliman.

Ja pra kjo është urtësia e pranimit të Islamit nga Indonezia që zotëron sot një popullsi prej 200 milion banorësh (muslimanë). Thjeshtë, një copë stofi që kushtonte 5 akçe dhe shembulli i një tregtari musliman, që besimin (imanin) e kishte reflektur në jetën e tij.

Po sikur dhe ne të tregonim epërsitë e moralit Islam dhe bukuritë e besimit me veprat tona? Atëherë pasuesit e besimeve të ndryshme do e përqafonin Islamin në grupe, ndoshta disa kontinente dhe disa shtete do të hynin në fenë Islame dhe kështu do të arrinin të kuptonin urtësitë e paqes dhe dashurisë.

Një gjë e vetme kërkohej për të arritur këtë sukses: "Të jetosh ashtu siç beson dhe të ndash mirësitë e kësaj feje me ata që të rrethojnë. "Përgëzimi i të Dërguait të Allahut (a. s.) është i hapur për të gjithë: "tregtari i drejtë dhe i besueshëm, ditën e gjykimit, do të jetë bashkë me profetët, dëshmorët dhe të sinqertët."

Ndoshta nuk ishte nevoja për të qënë shumë i ditur, shumë i pasur,shumë i njohur apo për të shëtitur shumë vende. Ajo që duhej bërë, ishte thjeshtë shpalosja e veprave të cilat do të shërbenin në jetën, moralin dhe besimin e të tjerëve.

Duhej vetëm të kuptonim se "Fjala e veprës është gjithmonë më ndikuese se fjala e gjuhës". Domethënë, nuk ishte ndikuese ajo që thuhej, por ajo që bëhej. Kërkohej më shumë të zbatohej sesa të flitej.

Kjo është urtësia e suksesit që na e mëson feja jonë...

Përktheu: **Luan AFMATAJ**

Ndoshta nuk ishte nevoja për të qënë shumë i ditur, shumë i pasur. Ajo që duhej bërë, ishte thjeshtë shpalosja e veprave të cilat do të shërbenin në jetën, moralin dhe besimin e të tjerëve.

Duhej vetëm të kuptonim se "Fjala e veprës është gjithmonë më ndikuese se fjala e gjuhës". Domethënë, nuk ishte ndikuese ajo që thuhej, por ajo që bëhej. Kërkohej më shumë të zbatohej sesa të flitej.

Përse rinia bie ne depresion?

Problemi i parë i një të riu, që parimeve të ndryshme u jep vlerë ose vlerat që ka punuar për stabilizimin e njeriut, që është munduar të eliminojë arsimet e ndryshme dhe që ka filluar të nxjerrë përplasje të brendshme shpirtërore.

Në përgatitjen që bëjnë të rinjtë tanë, ndoshta a mund të kuptojnë furtunat e botës së brendshme dhe a mund t'i afrohen atij? Jeta e tij dhe për të stabilizuar shkakun që shikimi negativ kundër njerëzve, me atë sa kemi bashkëpunuar? Ose a i dhamë ambient të sigurt që mund t'i strehonte me qellim, që ata vet të largohen nga problemet e brendshme?

Ja, kjo dhe probleme të ngjashme, për disa shkaqe që ka në brendësi mundohemi t'i afrohemi rinisë.

Një arsim me standart të dyfishtë

Të rinjtë gjenden përballë programeve arsimore si detyre për ta. Mundësia për të ushtruar veten ne këto dije kërkon përvojë, gjë që e cila mungon tek ata. Është e domosdoshme për ta te ecin ne rrugët dhe dijet e vendosura nga dijetaret e mëdhenj.

Ana me e rëndësishme e arsimit gjendet ne mënyrën se si përshtatet me shpirtin njerëzor. Si ne mënyrën arsimit ashtu dhe ne dijet e paraqitura më e rëndësishme është se si strukturën ta paraqes në mënyrën më të përshtatshme. Por dijet dhe metodat e shumëllojshme që ndiqen pengojnë rehabilitimin dhe fitimin e dijeve te përshtatshme për ta. Kështu që problemi i parë i të riut "parimet e ndryshme"e dhëna dhe kur njëri mundohet për të përcaktuar vlerat, tjetri mundohet t'i prishë ata dhe kështu fillon mosmarrëveshja midis tyre. Kjo mosmarrëveshje shkon deri aty sa të komplikojë dhe te ngatërrojë mendjen dhe aq me tepër kur kjo mendje është një mendje e pastër.

Vlerat e ndryshme te arsimit ne shkolla dhe familje dhe pikëpamjet e ndryshme te ekspozuara sjellin shume probleme në ambiente dhe sipas pikëpamjes islamike këto probleme prekin me shumë fëmijët e familjeve fetare. Ata te cilët janë larg vlerave islamike nuk janë te ndikuar nga ky ngatërrim, ngatërrimi i atyre është ne një mënyrë tjetër.

Pakësimi i njeriut shembullor

Ngatërresë tjetër e te riut ndodhet ne mungese te një njeriu shembullor dhe të besueshëm. Mungesa e paket e njerëzve me ide dhe sjellje te njëjtë po lëkund besimin ndaj njerëzve përreth. Shumica e njerëzve me sjellje jo shembullorë shihet ne mënyrë me te shumtë tek ata që janë oratorë të shkëlqyer dhe ata që njihen si më shembullorët.

Personat duken sikur nën personalitetin sipërfaqësor përmbajnë një indititet tjetër. Këto sjellje hipokrite jo vetëm që nxisin te riun por bëhen edhe një hije në idealet e tij.

Muslimanet te cilët gjatë gjithë historisë se tyre kane treguar vlerat e tyre, tani për tani akuzohen si të prapambetur në kohë. Edhe përse nga aparenca nuk mund te kenë ngjyrat e kërkuara në brendësi, kemi djem të mrekullueshëm dhe me shpirtra të pastër. Ende më shumë brendësia e tyre është me përsosur dhe me e kompletuar se brezat e tyre te mëparshëm. I riu, në këto kolektive artificiale dhe ne një botë te rreme, në qoftë se dallon njeriun musliman i ngjitet atij dhe nuk ndahet më prej tij.

Kultura vendase dhe e huaj

Në një shkallë më të largët, i riu do të dallojë një fenomen, atë të grupimeve të kulturës vendase dhe të huaj. Në një kohë kur Islami ka qenë mbizotërues me kalimin e kohës ngaqë jemi larguar nga burimet themelore e shikojmë që kultura vendase na është ngatërruar me zakonet. Nga ana tjetër Islami nuk përfaqësohet dot nga një pjesë njerëzish që e jetojnë ashtu siç duhet atë. Pavarësisht kësaj, këta njerëz që bëhet fjalë për ata janë përfaqësues të një kulture që është e tyre dhe vendase. Nga ana tjetër është një kulturë e huaj qe zakonet dhe parimet e saj njihen me vështirësi për tu integruar në shoqëri.

Grupet politike me zgjedhjet e tyre të gabuara ndaj filozofisë se huaj formojnë dhe mendimet e tyre të gabuara. Në anën tjetër pëlqimi i kulturës Islame dhe grupeve te tjera merr pjese një kulturë e huaj e cila ka pak ndryshim nga ajo e para. Dhe sepse tregojnë disa ndryshime nga njëra tjetra me këto kultura të huaja që punojnë për të prishur kulturën vendase, gjithnjë ndikojnë tek rinia.

Mendimi i kulturës vendase nga ana e përfaqësuesve të kulturës së huaj po mundohet të eliminohet i gjithë.

Këto veprime po përgatisin kushtet e duhura psikologjike për ta detyruar rininë që t'i kthejë shpinën besimeve dhe kulturës së tyre duke ndikuar dhe duke e shtypur. Kjo shtypje po nxjerr në pah politiken, nga ana tjetër ndikimet psikologjike dhe sociale. Por në rast se rinia ka mbështetjen e një familjeje islame këtyre propagandave u rri larg.

Kjo shtypje kulturore e cila nuk shikohet por ndihet, ndikon tek rinia që ka shumë pak forcë të përballojë këto probleme të tilla, dhe nuk është i kënaqur sepse po jeton mes dy kulturave të ndryshme.

Personaliteti i pa kompletuar

Nuk mund të thuhet që rinia duke qenë në shtypjen e ndikimeve të ndryshme që ekzistojnë në familje, shoqëri dhe edukim ka arritur të kompletojë personalitetin e duhur. Mund të themi se qëllimi, parimet dhe mënyra e jetesës, të kulturës së huaj dhe vendase kanë arritur të krijojnë një rini pa personalitet ose me një personalitet gjysëm të kompletuar.

Për depresionin e personalitetit që po jetojnë të rijntë mund të japim këtë shembull:

Vlerat e ndryshme të arsimit në shkolla dhe familje dhe pikëpamjet e ndryshme të ekspozuara sjellin shumë probleme në ambiente dhe sipas pikëpamjes islamike këto probleme prekin më shumë fëmijët e familjeve fetare. Ata të cilët janë larg vlerave islamike nuk janë të ndikuar nga ky ngatërrim, ngatërrimi i atyre është në një mënyrë tjetër.

Këta të rinj janë në rrugë të gabuar. Ngaqë nuk janë në dijeni të parimeve të tyre. Në shumë raste nuk mund të përcaktojnë ashtu siç duhet kufirin e veprimeve. Veprat e tyre nuk janë serioze. Në mënyrën e të folurit, e bërjes se shakave dhe e sjelljeve janë shume ndryshe nga paraardhësit e tyre.

Shoqëria që krijohet nga njerëz të tillë është një shoqëri me të cilën te rinjtë me personalitet nuk ambientohen dot. Për këto grupe që shikohen në këtë mënyrë nga jashtë, nuk mund të thuhet që janë të lumtur dhe në brendësi të tyre. Sepse nuk i marrin seriozisht marrëdhëniet midis tyre.

Përfundim

I riu i ditëve të sotme është i vetëm në ambient dhe jo i kënaqur brenda luksit dhe lehtësive që ka sjell teknologjia. Në ato vende ku bëhen fjale për marrëdhëniet sociale, ato janë të zhvilluara edhe aty po ndikon humbja e vlerave njerëzore. I riu nuk mund të zgjedhë për shkak të kënaqësive të veta, shumë herë nuk gjen shpresë në besimin e tij.

Sot, nga njëra anë, shumica që vazhdon të përkrah traditat, në qoftë se pjesa tjetër e vërtet dhe si rrjedhim i një jetesë me gjallëri; është një zgjim i Islamit. Për drejtimin e të rinjve tanë drejt Islamit, mund të themi se kemi sjellë për ata zgjidhje për shumë probleme.

Personaliteti Islam

Personaliteti më i lartë gjatë gjithë historisë, pa dyshim se ka qenë Muhammedi (a. s.), i cili është radhitur nga njëqind njerëzit prej më të dalluarve. Dërgueshmëria e Muhammedit (a. s.) ka qenë një revolucion. Ai transformoi shumë synime, ndryshoi sistemet dhe njerëzit i udhëzoi në rrugën e drejtë. Pa dyshim, ai ka qenë figura më e lartë në personalitetin Islam.

Personaliteti më i lartë gjatë gjithë historisë, pa dyshim se ka qenë Muhammedi (a. s.), i cili është radhitur nga njëqind njerëzit prej më të dalluarve. Dërgueshmëria e Muhammedit (a. s.) ka qenë një revolucion. Ai transformoi shumë synime, ndryshoi sistemet dhe njerëzit i udhëzoi në rrugën e drejtë. Pa dyshim, ai ka qenë figura më e lartë në personalitetin Islam.

Me punën e tij jashtëzakonisht intensive, sakrificës dhe qëndrueshmërisë së Muhammedit (a. s.), njerëzimi iu përgjigj thirrjes së tij, ku Allahu (xh. sh.) në një ajet të Kur'anit thotë:

"Thuaj (Muhammed): O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahu, që vetëm i Tij është sundimi i qiejve dhe i tokës, nuk ka të adhuruar tjetër pos Atij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje. Pra, besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Profetin e pa shkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij sa ta gjeni të vërtetën." (El-A'raf, 158)

Në këtë bazë u vendos qytetërimi më i lartë për të cilën ndonjëherë ka njohur njerëzimi. Qytetërimi e civilizimi i vërtetë që njerëzimit i ka sjellur paqe e siguri, progres dhe bollëk sepse janë vërtetuar fjalët e Allahut të Madhëruar:

"E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, ne do t'ju japim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtruan. Prandaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan." (El-A'raf, 96)

Por sot, shumë njerëz thonë se jemi muslimanë por, në të vërtetë janë shume larg nga rruga e Allahut (xh. sh.). Muslimani e ka humbur personalitetin e vetë të vërtetë, i ka lënë pas dore parimet e veta burimore dhe i ka harruar synimet jetësore.

Me të vërtetë, çdo popull ka personalitet, çdo personalitet ka çelësin e vet. Nëse dëshiron që ta hapësh një derë, nuk mundesh ta hapesh vetem me çelësin e vet, vetëm nëse është falso, origjinaliteti nuk hapet vetëm se me të vetin. Çelësi i këtij populli është besimi. Mbështetja është në emër të Allahut, në emër të Islamit e në emër të besimit. Pa këto populli nuk mundet të gjejë veteveten dhe as që të bëjë diçka nga ajo.

Është e domosdoshme të formojmë përsonalitetin Islam në të gjitha karateristikat e veta dhe me shpirt të vërtetë që disa

Ë shtë e domosdoshme të formojmë përsonalitetin Islam në të gjitha karateristi-kat e veta dhe me shpirt të vërtetë... Shtylla kryesore e saj është që ta besosh Allahun se është një Zot dhe nuk ka tjetër pos Tij dhe mos t'i besh Atij shok. Modeli më i mire për personalitetin Islam është të besuarit e Allahut (xh. sh.).

muslimanë nuk i njohin, se shumica nga ata nuk janë në gjendje as t'i kuptojnë...

Profeti, në asnjë situatë nuk e ka lëshuar rastin pa shpjeguar ndonjë parim muslimanëve që i parashtron korrnizat e qenies së tij. Kështu që në një hadith ka thënë:

"Musliman i vërtetë është ai që nga gjuha dhe duart e tij muslimanët janë të qetë", duke i përcaktuar normat dhe parimet etike për të sjellurit e muslimanëve në jetë. Po ashtu në një hadith tjetër ka thënë:

"Muslimani me musliman është sikurse themeli i një ndërtese që njëra-tjetrën e mban dhe e forcon." Kështu pra, e ka shpjeguar hollësisht frymën vëllazërore dhe solidaritetin që i karakterizon besimtarët. Për atë, hapi i parë në rrugën tonë për t'i caktuar idealet e vërteta të përsonalitetit Islam të formuara nga Kur'ani, është që muslimanët mos t'i lëmë në injorancë.

Pengesa kryesore, që pengon muslimanët të ndjekin rrugën Islame është, njohuria e pa mjaftueshme e Islamit.

Kushti i parë në të cilin mbështetet personaliteti Islam, është të besuarit se gjithësia (kozmosi) ka Krijuesin e vet, i vetmuar në atributet e përsosura dhe i pangjashëm me krijesat e veta në esencë dhe atribute. Ku, Allahu (xh. sh.) në një ajet të Kur'anit thotë:

"O ju njerëz, ruani me mirënjohje të mirat që Allahu u dhuroi! A ka ndonjë Zot tjetër që u furnizon ju nga qielli e toka? Nuk ka Zot tjetër përveç Tij. E si pra, atëherë e ktheni shpindën?" (el-Fatir, 3)

Është e çuditshme që në kohën tonë kur njerëzimi ka arritur një shkallë të lartë të zhvillimit në fushën e kulturës e të civilizimit, mëgjithatë, progresi material nuk u përcjell paralel me progresin shpirtëror që njerëzimit i prezenton faktet e ekzistencës dhe para atij i hapen sekretet e jetës. Por, shumë njerëz sot janë larguar nga ajo që është hyjnore, duke vrapuar nga ajo materiale. Ndërsa muslimani i vertete beson se Allahu i Madhëruar nuk e ka braktisur këtë botë pasi e ka krijuar. Ai vazhdimisht sundon në kozmos, i rregullon gjërat në të, kujdeset për njerëzit dhe mbi to është ligji i Allahut (xh. sh.) ku thotë:

"Vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës dhe vetëm tek Allahu kthehen të gjitha çështjet." (el-Hadid, 5)

Pra, njerëzit dyshojnë në Zotin e vetë. Ndërsa çdo send është në duart e Tij, si dhe fati në dispozicionin të Tij.

"Thuaj: "O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do, e lartëson atë që do dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!" (Ali- Imran, 26)

Dobësia dhe injoranca e njeriut ia marrin sytë, ashtu që rrugën e drejtë e bëjnë të pa ditur. Të krishterët së bashku me Allahun i besojnë edhe Isaut, birit të Merjemes, po ashtu edhe nënës së tij. Tek ata nuk ka dallim mes njeriut dhe hyjnisë, mes njeriut si krijesë e Zotit dhe përsosmërisë e madhërisë hyjnore. Ndërsa, Kur'ani e përshkruan Isanë (a. s.) kështu:

"Dhe kur Allahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njërzëve u the: "Më besoni mua dhe nënën time dy zota përveç Allahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua të them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, e unë nuk di ç'ka në Ty. Ti je më i dijshmi i të fshehtave!" Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, përveç asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send!" (el-Maide, 116-117)

Shtylla kryesore e personalitetit Islam është që ta besosh Allahun se është një Zot dhe nuk ka tjetër pos Tij dhe mos t'i bësh Atij shok. Modeli më i mirë për personalitetin Islam është të besuarit e Allahut (xh. sh.).

Ismail Ozxhan

Edukimi i njeriut

Nëse mendon për një vit mbill farë,
Nëse mendon për dhjetë vjet mbill pemë,
Nëse mendon për me shumë se njëqind vjet, atëherë eduko njerëz.

Nëse një personi i jep një peshk, ia mbush barkun vetëm një herë.
Por, nëse e mëson të peshkojë, ia mbush barkun përherë.

Këto janë fjalët e një poeti kinez, që ka jetuar para 2000 vjet dhe mendojmë se e ka shprehur shumë bukur çështjen, qëllimin e edukimit dhe atë që pritet prej tij.

Edukimi, është një profesion që e përgatit njeriun në mënyrën më të mirë për jetën e tij, e shpëton nga egoizmi dhe të këqijat, e çon në të mira dhe e lartëson në grada të larta. Nëse e shohim edukimin nga ky këndvështrim, është më e lehtë të kuptosh se përse ka kaq shumë rëndësi në islam dhe pse pikërisht kjo ishte detyra më kryesore që Allahu (xh. sh.) e ngarkoi Profetit tonë (a. s.).

Islami, ka sjellë parime të përshtatshme për çdo aspekt të jetës tonë. Këto parime, sistemojnë në një masë të caktuar çdo sjelle tonën. Më i rëndësishmi prej këtyre parimeve është ai i edukimit të njeriut, qoftë direkt apo indirekt. Në përgjithësi, këto parime synojnë edukimin e njeriut në një mënyrë të përshtatshme brenda suazave hyjnore.

Të gjithë ajetet në Kur'an të cilët fillojnë me fjalët "...o ju njerëz! o ju njerëz!" dhe që tregojnë për çdo çështje mënyrën e sjelljes, në fund të fundit janë nga një parim i edukimit.

Njeriu është krijuar në mënyrën më të përsosur dhe është deklaruar si krijesa më e mrekullueshme "eshref-i mahlukat". Në Kur'anin Famëlart, tregohet se shumica e bimëve nxirren nga toka për njeriun dhe në të njëjtën mënyrë thuhet qartazi se shumca e krijesave, qofshin ato me shpirt, apo pa shpirt, janë krijuar për t'i shërbyer kësaj krijese të përsosur.

Njeriut gjithashtu i janë treguar prej Allahut (xh. sh.) historira, ndodhi, dhe mrekulli të ndryshme me qëllim që të marrë mësim prej tyre dhe të gjejë rrugën e drejtë, rrugën e shpëtimit. Dhe padyshim që këto nuk janë gjëra të kota, por secila prej tyre e ka nga një qëllim të caktuar. Dhe ky qëllim e çon njeriun në gradën e devotshmërisë, të cilën na e tregon ky ajet Kuranor në të cilën thuhet: " Më i miri ndër ju është ai i cili është më i devotshëm"

> **Islami, ka sjellë parime të përshtatshme për çdo aspekt të jetës tonë. Këto parime, sistemojnë në një masë të caktuar çdo sjelle tonën. Më i rëndësishmi prej këtyre parimeve është ai i edukimit të njeriut, qoftë direkt apo indirekt. Në përgjithësi, këto parime synojnë edukimin e njeriut në një mënyrë të përshtatshme brenda suazave hyjnore.**

Kjo gradë nuk arrihet vetëm me adhurm. Muslimani padyshim që duhet t'i kryejë ibadetet, por përveç tyre ai gjithashtu duhet të kryejë edhe vepra prej të cilave njerëzit kanë dobi. Gjithashtu, ai duhet të dijë që të gjitha ato që posedon, qoftë dituri, mjeshtëri apo të ngjashme janë dhunti prej Allahut (xh. sh.) dhe këto nuk duhet të bëhen shkak që të harrojë se një ditë do të kthehet tek Ai.

Çdo gjë që ai posedon, duhet ta konsiderojë si mjet e jo si qëllim. Ky është ndryshimi mes muslimanit dhe jomuslimanit. Kjo do të thotë që, gjërat që për të tjerët janë qëllim, ndërsa për muslimanin nuk janë asgjë tjetër vetëm se shkak për të arritur diçka.

Pra, qëllimi i edukimit në Islam është, mposhtja e nefsit (egos) që të nxit për të këqija dhe të mundësojë mbizotërimin ndaj tij. Këtë punë të rëndësishme më së miri e ka realizuar

Një besimtar, si shumë të tjerë, i ndikuar nga trazirat mes muslimanëve, vjen tek Aliu (r. a.) dhe i thotë: "O Ali, përse në kohën tënde po ndodhin fitne që nuk kanë ndodhur në kohën e Ebu Bekrit dhe Omerit (r. anhum)? "Aliu (r. a.) i jep një përgjigje mjaftë kup-timplote: "Në kohën e tyre ishim edhe ne, ndërsa në kohën tonë ata nuk janë."

Profeti Muhammed (a. s.) me ndihmën e Allahut (xh. sh.) edhe pse nuk ka qenë i shkolluar. Ai këtë e ka realizuar, në një kohë të shkurtër, tek një popull i shthurur dhe i zhytur në batakun e të këqiave siç ishte populli Arab i asaj kohe.

Ai e shëndrroi atë bashkësi të shthurur njerëzore në një shembull të mirëfilltë për popujt e tjerë. Në këtë popull disa individë, që para Islamit nuk janë njohur në asnjë fushë, pas hyrjes në Islam dhe pas kalimit nëpër duart e Profetit (a. s.), arri-tën grada të larta në shumë fusha, qoftë në dituri apo në ato shtetërore.

Nuk ka dyshim se Profeti (a. s.), për nga suksesi gjatë jetës së tij, radhitet në krye të Profetëve. Në këtë sukses, rolin kryesor e ka luajtur personaliteti, durimi dhe përpjekja e tij. Por, njëkohësisht në këtë sukses, rol të pamohueshëm kanë luajtur edhe sahabët (shokët) e tij.

Në kohën e kalifatit të tij, Omeri (r. a.), në një tubim me sahabët e mëdhenj, iu drejton një pyetje me ç'rast u thotë: "Nëse do të ishit të sigurt se lutja që bëni do të pranohet, çfarë do të kërkonit nga Allahu (xh. sh.)?"

Njëri prej tyre tha: "Unë do të doja të kisha filan luginë me flori dhe atë ta harxhoja në shërbim të Islamit." Kurse një tjetër tha: "Do të doja të kisha shumë bagëti për t'i përdorur në rrugë të Allahut." Të gjithë të pranishmit thanë gjëra të ngjashme me këto por, Omeri (r. a.) nuk pëlqeu as edhe njërin prej këtyre mendimeve. Atëherë të pranishmit e pyetën Omerin (r. a.) duke i thënë: "Po ti o njeri, çfarë do të dëshiroje?" Omeri (r.a) iu përgjigj në këtë mënyrë: "Unë do të doja që të shtoheshin njerëz si Salimi, Ebu Ubejde dhe Muadh bin Xhebeli, që me ndihmën e tyre t'i shërbej Islamit."

Siç dihet, në kohën e kalifatit të Aliut (r. a.) ka pasur disa trazira mes muslimanëve. Një besimtar, si shumë të tjerë i ndikuar nga këto ngjarje vjen tek Aliu (r. a.) dhe i thotë: "O Ali, përse në kohën tënde po ndodhin fitne që nuk kanë ndodhur në kohën e Ebu Bekrit (r. a.) dhe Omerit (r. a.)?" Aliu (r. a.) i jep një përgjigje mjaftë kup-timplote: "Në kohën e tyre ishim edhe ne, ndërsa në kohën tonë ata nuk janë".

Përktheu: **Adem Pizga**



MIQËSIA

Miqësia e ngushtë buron nga kolektiviteti në cilësitë pozitive dhe negative.

❖ ❖ ❖

Dy vëllezër besimtarë janë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën, njëlloj si muhaxhirët dhe ensarët.

❖ ❖ ❖

Miqësia e ngushtë është një linjë përçuese mes dy zemrave. Me këtë rrymë, pra, çdo gjendje e të dashuruarit i shfaqet të dashurës si rezultat i dashurisë.

❖ ❖ ❖

Qënia e një personi së bashku me të dashurën do të thotë të qënurit me të në fjalë, në sjellje, në ndjenja, në mendime dhe në mënyrën e të jetuarit, pra, të ekzistuarit e ngjashmërive dhe anëve të përbashkëta të cilat e tregojnë "dashurinë"

❖ ❖ ❖

Miqësia e ngushtë dhe e vërtetë e realizuar për hir të Allahut është të jetuarit në një zemër të dy trupave të ndarë.

❖ ❖ ❖

Dallimi i lëkurës nuk çon në ndarjen e shpirtrave, përkundrazi i afron edhe më tepër me njëri-tjetrin, i bën një të vetëm.

❖ ❖ ❖

Rruga e miqësisë hyjnore është dashuria, është imitim i të dashurve.

❖ ❖ ❖

Të dashuruarit i mbartin përherë në shpirtra ata që duan dhe nuk i harrojnë asnjëherë.

❖ ❖ ❖

Robi vetëm kur tejkalon pengesat e tij nefsore mund ta shijojë shijen e vërtetë të dashurisë dhe miqësisë.

❖ ❖ ❖

Dashuria që ekziston në zemra, nëse është një dashuri që përfshin të gjitha krijesat, e bën të zotin e saj një besimtar të pjekur, ose e thënë ndryshe e bën një të dashuruar të vërtetë, pra, e bën atë mik të ngushtë të Krijuesit.

❖ ❖ ❖

Janë të verbëra ato zemra që nuk arrijnë të shohin fytyrën e mikut të ngushtë të fshehur në natyrë. Shpirti i njeriut që nuk arrin të flasë me natyrën është pa gjuhë.

Ata që janë pjesë e miqësisë së ngushtë, së drejtësisë fytyrën e qeshur të miqësisë së ngushtë nuk e shohin vetëm tek njerëzit, por edhe te krijesat e tjera.

❖ ❖ ❖

Shpirti i një besimtari që është i mbushur me dashurinë për Krijuesin ka nëvojë të përqafojë me mëshirë dhe dhembshuri të gjitha krijesat e Tij.

❖ ❖ ❖

Ata që vënë në qendër të miqësisë së ngushtë Allahun dhe Profetin e Tij, bëhen miq të ngushtë me të gjitha krijesat.

❖ ❖ ❖

Miq të ngushtë të Zotit si Mevlana dhe Junusi, që kanë arritur deri në burimin e miqësisë së ngushtë, si miq të ngushtë edhe të njerëzve janë si një lule Xhenneti me fytyra të qeshura që duhen nga të gjithë.

❖ ❖ ❖

Dukuritë e fuqive të mëdha në natyrë dhe shfaqja e dashurisë hyjnore janë shkallë të larta që i çojnë qëniet artificiale drejt Krijuesit të Gjithësisë. Ata që i tejkalojnë këto shkallë, shijojnë shijen e miqësisë së ngushtë të vërtetë.

❖ ❖ ❖

Për mbrojtjen e zemrës nga çdo gjë që të largon prej Krijuesit dhe për të qënë përherë pranë punëve të dobishme është e nevojshme të qenurit bashkë me njerëzit e besueshëm dhe që kanë një shprit të mirë, që mund të marrin fryte nga gjendja shpritërore e tyre.

❖ ❖ ❖

Për të drejtuar dashurinë tek ai që i takon e armiqësinë drejt atij që e meriton dhe ai që bën të kundërtën vlerësohet sipas asaj mase që ka vepruar.

❖ ❖ ❖

Të dashuruarit janë të detyruar të mirëpresin atë që vjen nga i dashuri i tyre. Robi me një dashuri të madhe për Allahun, çdo gjë që vjen nga Zoti, e përqafon me shpirt si rezultat i dashurisë së tij.

❖ ❖ ❖

Rruga drejtë Allahut nuk kalon nga shkatërrimi i shpirtrave, por nga kënaqësia shpirtërore.

❖ ❖ ❖

Rritja e nivelit të ideve e mendimeve dhe të kuptuarit në mënyrë të drejtë të mirësive në fletët e gjithësisë është punë e luftëtarëve të dashurisë hyjnore që arrijnë të jenë të suksesshëm për të jetuarit e miqësisë së ngushtë të vërtetë vetëm duke u thelluar në botën shpirtërore.

Përktheu: **Evans Drishti**

Cilin nga ne do më shumë i Dashuri i Allahut?

Hz. Fatimeja dhe Hz. Ali po bashkëbisedonin…

Jeta e nënës tonë, Hz. Fatime është një jetë e mbushur me mësime, dhe me një moral të denjë, të lartë dhe shembull për të gjithë femrat që do të vijnë deri në Ditën e Gjykimit. Martesa e saj, paja, shkathtësia e saj në punët shtëpiake, talenti, respekti që tregonte ndaj bashkëshortit, shërbimi i mbushur plot dashuri, sjellja me fqinjët, dituria, devotshmëria dhe dhënia për hir të Allahut, të gjitha këto i përngjajnë një pishtari udhëzues në ditët e sotme. Ajo nuk u bë asnjëherë shërbyesja e plaçkës apo skllave e saj, por gjithmonë u mundua të ishte e devotshme, ashtu sikurse e dëshironte i Dërguari i Allahut. Gjithë jetën e kaloi me këtë qëllim. Lëvdata e gjithësisë e donte shumë vajzën dhe nipat e tij. Për t'i parë ata, shkonte shpesh herë tek shtëpia e dhëndrrit të tij. Një herë vajti deri tek dera e tyre dhe u kthye pa hyrë brenda. Hz. Fatimeja u shqetësua shumë nga ky gjest. Kur erdhi Hz. Ali në shtëpi, vërejti se bashkëshortja e tij ishte e dëshpëruar dhe e pyeti se cili qe shkaku. Hz. Fatime u përgjigj: "O Ali, i Dërguari i Allahut erdhi deri tek dera e shtëpisë dhe u kthye pa hyrë brenda." Me këtë përgjigje u dëshpërua shumë edhe Hz. Ali. Për të mësuar shkakun e moshyrjes, ai vrapoi për te i Dërguari i Allahut dhe ia tregoi dëshpërimin e Hz. Fatimes. Dielli i dy botëve, me një qortim të vogël u përgjigj: "O Ali, ç'lidhje kam unë me këtë botë? Çfarë lidhje kam unë me perdet e zbukuruara?" Hz. Ali e kuptoi shkakun dhe direkt u kthye tek Hz. Fatma dhe ia shpjegoi mospëlqimin dhe moshyrjen e të Dërguarit të Allahut në shtëpi. Hz. Fatima u përgjigj duke thënë: "Çfarë më urdhëron të bëj me perden?" Për këtë, Hz. Ali vajti përsëri të pyes të dërguarin e Allahut. Hz. Pejgamberi iu përgjigj: "Thuaji Fatimesë, që atë perde t'ua jap fëmijëve të filanit. Me këtë lajm perdja, direkt, u hoq nga aty dhe menjëherë u dërgua tek nevojtarët. Një gjë që nuk e dëshiron i Dërguari i Allahut ata të dy nuk e dëshirojnë kurrë. Dëshira më e madhe e Hz. Fatimes ishte lumturia e babait të saj të dashur, të Dërguarin e Allahut. Prandaj ajo mundohej, që në respekt dhe dashuri, të mos lë asgjë mangut. Edhe zotëriu ynë e donte shumë vajzën dhe dhëndërrin e tij, për këtë shkak i vizitonte herë pas here.

Dëshira më e madhe e Hz. Fatimes ishte lumturia e babait të saj të dashur, të Dërguarin e Allahut. Prandaj ajo mundohej, që në respekt dhe dashuri, të mos lë asgjë mangut. Edhe zotëriu ynë e donte shumë vajzën dhe dhëndërrin e tij, për këtë shkak i vizitonte herë pas here.

Cili nga ne është me i Dashur tek Ti?

Një herë Hz. Ali dhe Hz. Fatimeja po bashkëbisedonin, i bënin komplimente njëri-tjetrit. Me je qeshje të ëmbël pyesnin njëri-tjetrin: Cili është më i dashur tek i dërguari i Allahut e bija apo dhëndrri? Në të njëjtën kohë erdhi i dërguari i Allahut dhe kur i pa të gëzuar u gëzua edhe ai vetë personalisht. E dashuruar shumë pas babait të saj Hz. Fatimeja duke buzëqe-

Hz. Aliu ishte porta e qytetit së diturisë, luani i pafrikshëm i mejdanit të luftës, dijetar dhe trim. Hz. Fatimeja ishte një diamant që rrezatonte dritë, një grua fatbardhë dhe e lumtur në botkuptimin e saj.

shur i tha të dërguarit të Allahut: "Babai im i dashur. Unë edhe Aliu ishim duke folur se cili nga ne është më i dashur tek ju, unë apo ai? Pejgamberi i mëshirës për të shfaqur dashurinë që ushqente për vajzën dhe dhëndrrin e tij u përgjigj: "Vajza ime. Ti je më e dashur sesa Aliu në aspektin e dashurisë natyrore që ka babai për fëminë e tij, por Aliu është më i rëndësishëm dhe më fisnik në syrin tim. Kështu shprehu faktin se ai i donte që të dy në aspekte dhe pikëpamje të ndryshme. Gjithmonë u mundua të shtonte dashurinë mes tyre. Hz. Aliu ishte porta e qytetit së diturisë, luani i pafrikshem i mejdanit të luftës, dijetar dhe trim. Hz. Fatimeja ishte një diamant që rrezatonte dritë, një grua fatbardhë dhe e lumtur në botkuptimin e saj. Sipas një transmetimi që vjen nga Nëna jonë Hz. Aishe thuhet: "Më e respektuara dhe e dashura tek i Dërguari i Allahut ishte Hz. Fatimeja. Kur Fatimeja hynte brenda i dërguari i Allahut çohej në këmbë në shenjë respekti dhe e ulte atë në vendin e vet. Kur do nisej për ndonjë udhëtim, në radhë të parë shkonte në faltore falte dy rekate namaz, pastaj shkonte te vajza e tij e e dashur dhe bisedonin për pak kohë.

Edhe Hz. Fatimeja e donte shumë babain e saj, gjithmonë donte ta ndiqte pas sikurse ndjek hija personin. Në luftën e Uhudit kur degjoi se Babai i dashur është plagosur duke i ditur vështërsit nuk beri mbrapsht por vrapoi dhe e arriti babain e dashur, ia pastroi gjakun që i rridhte në fytyrë, duke i hedhur pluhur u mundua ta mjekonte dhe ia ndaloi gjakun që po i rridhte në fytyrë.

Familja e Hz. Aliut dhe Hz. Fatimes ishte e pajisur me merita të veçanta. Për vazhdimin e gjeneratës së ndritshme, meritat më të dalluara të kësaj martese ishin: komplimenti, respekti, sjellja, nderi, vlerësimi i tjetrit etj. I respektonin shumë mendimet e njëri-tjetrit, edhe nëse kishin mendime te ndryshme bashkoheshin në atë të përbashktin. Kishin formuar një familje të ngrohtë, sinqertë dhe të vetdijshme. Bashkimi i tyre familjar ishte shndërruar në një vatër dashurie. Kishin një dashuri të atillë që dëshirat dhe pëlqimet kalimtare kurre nuk ndikuan mbi të. Gjëja më përparimtare tek ata ishte të marrin pëlqimin e Allahut dhe të fitojnë botën e amshueshme. Nuk ushqenin veten por ushqenin të tjerët. I varfëri që vinte tek dera nuk kthehej mbrapsht, edhe pse ishin nevojtar vetë më parë ju jepnin të tjerve pastaj vetes. Këto bukuri, sjelleje dhe bujarinë e tyre në kohët më të vështira Allahu i Lartësuar e ka përmendur në Kuranin Famëlartë. Sipas një transmetimi: Një radhë kur Hz. Aliu dhe Hz. Fatimeja po agjëronin nafile në kohën e iftarit tek dera e tyre u afrua një i varfër, duke thënë: "Për hir të Allahut kërkoj diçka." Ata ushqimin që e ki-shin përgaditur për iftarin e tyre ashtu siç ishte ia dhanë lypësit. Tri ditë radhazi në kohën kur thirrej ezani i akshamit, tek dera e tyre vinte një njeri me rroba të grisura dhe kërkonte diçka duke thënë: "Per hir të Allahut." Edhe ky çift i lumtur tri netë rresht, ushqimin që kishin përgatitur për veten e tyre, ia jepnin lypësit, kështu që vazhduan agjërimin e tyre tri ditë vetëm duke pirë ujë pa ngrënë asgjë. Allahu e pëlqen këtë sjellje të mirë të tyre, zemërgjerësinë dhe dashurinë që ata kishin për të dhënë lëmosha për hir të Allahut kështu që i lavdëroi ata në Kur'anin Famëlartë:

"S'ka dyshim se të devotshmit do të pijnë nga gota që

Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim.

Unë, Allahun e dua me mendje dhe besim (iman), juve me shpirt dhe besim, Fatimen e dashuroj kurse Hasanin e Husejnin me dashurinë e babait për fëmijët". Dielli i dy botëve buzëqeshi dhe tha: O Ali këto fjalë nuk janë gjë tjetër vetëm se frute te vjelura nga pema hyjnore.

përziejra brenda saj është nga kafuri (aromatik). Eshtë një burim prej të cilit pijnë robërit e Allahut dhe e bartin atë kutë duan. Ata janë që zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një dite dëmi i së cilës ka përmasa të mëdha. Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë" (Insan : 5-10)

Pasi plotësohet shpallja e këtij lajmi hyjnor (vahj) dielli i dy botëve ia tregoi vajzës dhe dhëndrrit të tij. Të dy me të dëgjuar këtë ajet e harruan përnjëherë vështirësit që kishin përjetuar gjatë tre ditëve duke agjëruar vetem me ujë pa asnjë ushqim tjetër. Hz. Fatimeja kishte përjetuar shumë nga djepi i vahjit. Meqë ajo ishte edukuar nga i dërguari i Allahut, ishte pajisur me merita të veçanta si dituri, edukatë, ndërsa zemrën e kishte mbushur me devotshmërinë e bollshme të Resulullahut.

Një ditë i dërguari i Allahut e pyeti Hz. Alinë: "O Ali a e do Allahun?" Ai u përgjigj: "Po e dua." Po të dërguarin e Allahut a e do?" "Po, -u pergjigj Aliu i emocionuar. Dielli i dy botëve e pyeti: "Vajzën time Fatimen a e do?" Ai pa ngurruar fare u përgjigj: "Po." Po Hasanin dhe Husejnin? "Po i dua,-u pergjigj Hz. Aliu." I Dërguari i Allahut tha: "O Ali zemra është një. Si ka mundësi të mbaj katër dashuri?" Hz. Aliu nuk mundi të pergjigjej dhe u kthye në shtëpi menduar. Hz. Fatimeja kur e pa bashkëshortin e saj të kredhur në mendime u shqetësua. Për të marr vesh se ç'kishte ndodhur dhe se çfarë blu-ante me mendje. Ajo në një mënyrë te dhimbshme u afrua dhe i tha: "O Ali po të shoh të shqetësuar, çfarë është ajo që të ka hidheruar? Pasi hyri në bisedën e këtë mënyrë ajo shtoi: "Nëse është ne lidhje me këtë bote nuk ia vlen të shqetësohesh, nëse është në lidhje me botën e amshueshme atëherë çfarë është ajo që të shqetëson? Hz. Aliu nuk dëshiron ta lë pa përgjigje pyetjen e bashkëshortes së nderuar dhe ia tregoi se çfarë i ka ndodhur me të Dërguarin e Allahut dhe se nuk kishte mundur t'i përgjigjej pyetjes së tij. Hz. Fatimeja kur e mësoi pyetjen buzëqeshi. O Ali, shko tek im atë dhe pyetjes së tij përgjigju në këtë mënyrë. Hz. Aliu i gëzuar nga shpjegimi që i bëri bashkëshortja e tij e dashur dhe me zemër të gëzuar vrapoi për tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Njeriu ka katër drejtime djathtas, majtas, anën e parme dhe anën e prapme. Edhe zemra ka këto drejtime: "Unë Allahun e dua me mendje dhe besim (iman), juve me shpirt dhe besim, Fatimen e dashuroj kurse Hasanin e Husejnin me dashurinë e babait për fëmijët." Dielli i dy botëve buzëqeshi dhe tha: "O Ali këto fjalë nuk janë gjë tjetër vetëm se frute të vjelura nga pema hyjnore."

Vajza ime ki durim…

Hz. Fatimeja ishte shumë e ndjeshme dhe zemërbute, nuk dëshironte të dëshpërohej dikush, nuk duronte që dikush të vuante. Në kohën kur i Dërguari i Allahut filloi të shqetësohej nga dhimbjet ajo vraponte në një mënyrë të shqetësuar duke thënë: "O Babai im i dashur, o i mjeri Babai im!.."

Dielli i dy botëve iu përgjigj: "O bija ime, duro se durimi është me vlerë." Me këto fjalë u mundua ta ngushëllonte të bijën. Një ditë kur ju shtua tem-

peratura në trup Dielli i dy botëve ju tha te pranishmëve: "O ju njerëz ju nuk mundeni të gjeni argument kundër meje, sepse unë atë që Allahu e lejoi në librin e tij edhe unë e lejova, atë që e ndaloi në librin e tij edhe unë jua ndalova atë juve. Dhe vazhdoi ligjërimin me këto fjalë: "O bija ime Fatime, o halla ime Safije! Veproni vepra të pranueshme tek Allahu, duke më besuar si ndermjetes mos neglizhoni asgjë. Sepse unë nuk mund t'ju shpëtoj as juve nga ndëshkimi i Allahut.

I dërguari i Allahut duke u shprehur në këtë mënyrë tregoi haptas se njeriu do të shpërblehet vetem për atë që ka vepruar, se njeriun vetëm besimi i pastër dhe veprat e mira do të mund ta shpëtojn. Edhe pse dhimbjet vinin duke ju shtuar i Dërguari i Allahut mendonte akoma për ummetin dhe dëshironte ti shpëtonte të gjithë nga zjarri i xhehennemit. Prandaj të pranishmëve ju përsëriste sa herë: Faleni namazin, vazhdoni namazin" Ai kështu theksonte se shtylla kryesore e Islamit pas tevhidit (njësimit të Zotit) është namazi.

Ajo që do më arrij mua e para do jesh ti!

Pejgamberi i mëshirës një

ditë kur dhimbjet e sëmundjes ju shtuan urdhëroi dhe thirri të bijën Fatimen. Ajo kur pa babanë e saj të dashur në atë gjendje briti: "O i mjeri Babai im!" Dielli i dy botëve i tha vajzës së tij të afrohej se do i thoshte diçka në vesh. Ajo u perkul dhe pasi dëgjoi fjalët që i tha në vesh i dërguari filloi të qante. I dërguari i tha të përkulej për së dyti herë dhe i tha diçka tjetër. Këtë herë Hz. Fatimeja buzëqeshi. Hz. Aisheja u habit kur e pa këtë. Ajo e pyeti Hz. Fa-timen se cili ishte shkaku që ajo njëherë qau, kurse herën e dytë buzëqeshi. Hz. Fatimeja i kërkoi ndjesë se nuk mund t'ia tregonte shkakun dhe u largua. Dielli i botëve bijës së tij i kishte thënë: "Xhebraili çdo vit më kontrollonte leximin e Kur'anit nga një herë, ndërsa këtë vit ma kontrolloi dy herë. E kam kuptuar se më është afruar vdekja." Ky ishte shkaku që Fatimeja kishte qarë. Kurse herën e dytë i kishte thënë se njeriu i parë që do e arrinte të Dërguarin në xhennet prej rrethit të tij familjar do të qe Fatimeja. Ky ishte shkaku i buzëqeshjes.

Fatimja kur shikonte dhimbjet që shtoheshin dhe rritjen e temperaturës së trupit te i Dërguari, ndjente sikur t'i digjej trupi i saj. Përvëlimi që ndiente në zemër për babanë e saj e shprehte me këto fjalë: " O babai im i dashur, o babai im i mjerë!" Zotëria ynë për ta ngushëlluar sadopak të bijën i thoshte: "O bija ime. Babai juaj nuk do të vuaj më pas kësaj dite. Bija ime kur unë të vdes

Dielli i dy botëve i tha vajzës së tij të afrohej se do i thoshte diçka në vesh. Ajo u perkul dhe pasi dëgjoi fjalët që i tha në vesh i dërguari filloi të qante. I Dërguari i tha të përkulej për së dyti herë dhe i tha diçka tjetër. Këtë herë Hz Fatimeja buzëqeshi.

Xhebraili çdo vit ia kontrollonte leximin e Kur'anit nga një herë, ndërsa këtë vit ia kontrolloi dy herë. E kam kuptuar se më është afruar vdekja." Ky ishte shkaku që Fatimeja kishte qarë. Kurse herën e dytë i kishte thënë se njeriu i parë që do e arrinte të dërguarin në xhennet prej rrethit të tij familjar do të qe Fatimeja. Ky ishte shkaku i buzëqeshjes.

ki kujdes e mos qaj, por thuaj Ne vetëm të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi".

Elegji e zemres se djegur…

Në momentin që i dërguari i Allahut u nda nga kjo botë dhe udhëtoi për në botën e amëshuar Fatimeja e vajtoi me këto vargje:

O Babai im që vrapon në pergjigje të ftesës së Allahut
O Babai im që vend banimi ke Firdevsin
O babai im që lajmin e vdekjes e more drejt prej Xhebrailit
O Babai im që më i afërmi te Allahu je…

Dhimbjet e Fatimes nuk kishin të mbaruar, zjarri në zemrën e saj nuk fikej që nga dita kur u nda nga jeta i Dërguari i Allahut. Ftyra e saj nuk qeshi më kurrë. Varrin e të Dërguarit ajo e para e vizitoi para me lot në sy dhe teksa sytë ia kishte ngjitur atij, i tha Aliut: "O ali. Si të bëri zemra të hedhësh dhe mbi trupin e të dërguarit?" Dhe vazhdoi vajin me këto vargje:

Mbi mua kanë rënë fatkeqsi të tilla, sikur të binin mbi ndriçimin e ditës, do te errej dhe të bëhej natë.

Hz. Fatimeja vazhdonte ta ngushëllonte veten me sekretin që i kishe lënë i dërguari i Allahut. Edhe pse rreth saj vinin rrotull e silleshin pesë femijët e saj të dashur (3 vajza dhe 2 djem). Ajo ishte në pritje të plotësimit të caktimit të Allahut.

Nga dita që vdiq pejgamberi i mëshirës kishin kaluar pesë muaj. Fatimja u sëmure dhe ra në shtrat. Ishte viti i njëmbëdhjetë i hixhrit, muaji i Ramazanit.

Kur dhimbjet erdhën duke ju shtuar atëherë ajo kerkoi nga Aliu që ti nxirrte jashtë fëmijët.

Dhimbjet e Fatimes nuk kishin të mbaruar, zjarri në zemrën e saj nuk fikej që nga dita kur u nda nga jeta i Dërguari i Allahut. Ftyra e saj nuk qeshi më kurrë. Varrin e të Dërguarit ajo e para e vizitoi para me lot në sy dhe teksa sytë ia kishte ngjitur atij, i tha Aliut: "O ali. Si të bëri zemra të hedhësh dhe mbi trupin e të dërguarit?

Brenda në banesë hynë u futen Ummu Rafi dhe Esma Binti Umejs. Hz. Fatimeja kërkoi nga ato që ta ndihmonin të merrte abdes dhe ta linin vetëm në dhomë. "Dua ti lutem Allahut" u kishte thënë atyre. Në momentin që i lutej Allahut me plot devotshmëri shpirti i saj udhëtoi drejt Allahut. Hz. Fatimeja la pas vetes në këtë jetë pesë fëmijë Hasanin 8vjeç, Husejnin 7 vjeç, Ummu Gulthumin 5vjeçe, Zejnepen 3vjeçe, Rukijen 2 vjeçe dhe sytë e përlotur të Hz. Aliut. Emrat e tri motrave të saja i përjetoi tek vajzat e saja. Një fëmijë i kishte vdekur që në moshë të vogël. Transmetoi nga i dërguari 18 hadithe. Vdiq në moshën 28 vjeçare (Allahu e mëshiroftë). Pak ditë para se të vdiste Fatimeja i kishte thënë Esmasë se kur të vdiste kishte frikë se mos e nxirrnin të mbuluar vetëm me qefin, pasi kjo ishte praktika e deriatëhershme. Esmaja kishte dëgjuar se në Etiopi për xhenazet e grave përgatitej një tabut i thurur me degë hurme. Kur Fatimja e dëgjoi këtë gjë kishte kërkuar që edhe për të përgatitej një tabut i këtillë. Kështu që Fatimja ishte gruaja e parë myslimane që u vendos në tabut. Sipas amanetit që la para se të vdiste u varros natën në varrezat Xhennetu'l-baki nga Hz. Aliu, Hz. Abbasi dhe djali i tij Fadli.

Përktheu: **Tasim Darsi**

O Njeri/ Ja Sin

O njeri
O bardhësia e fytyrës, vezullimi i shpirtit
I bukur si një lëmoshë e pranuar
Një ndjenjë po ma mbështjell zemrën kur po të kujtoj ty
Me tokën ku ke shkelur më lave syrin tim
Tani edhe dielli më duket i errët
O bardhësia e fytyrës, vezullimi i shpirtit

Kur qaja vetveten, a qante edhe Uhudi
E pash të mërzitur Hira-n, nuk munda ta pyes
A kishte ndonjë shqetësim tjetër përveç mallit për ty?

O njeri
Ty t'i dedikoj
të gjitha lulet që i kam rritur brenda vetes
Jaseminat, manushaqet
Tulipani të më ngel mua
Kam turp
të paraqes lulen më të errët para teje

Se mos dalin sevdatë në qiellin ku s'dalin duatë?
Në këtë kopësht universal që ka humbur bilbilin
edhe gjëmbat janë të bukur, vetëm trëndafil mbajnë erë

O njeri
Nxënësi i qiejve, o mësuesi i tokëve
Ti ia mësove gurit të folurën
Përshëndetjen pemës
Ndarjen hënës, hapjen tokës
Formimin qiejve, ndalimin kohës
Dashurinë gjarpërit dhe devesë
Të jetosh dhe të vdesësh ti ia mësove njeriut

A është burim ai ujë i jetës që vërshoi nga syri yt?
Burimi i behareve dhe vështruesi i rrugëve?
A vetëm unë qenkam dëshmitar i sevdasë dhe ky rrap?

O njeri
Sekreti yt
Qenka i fshehur në përbërjen e lotëve
Këtë të vërtetë e mësova nga buza e një deti
Në një pjesë të natës tek qante një i dashuruar
Tek ia kushtonte qenien e tij një qenie femër
Në duart e një burrit
Tek hidhte peshqirin vdekja
Kishte të drejtë!

Më thuaj zemër, a më ngel për në mahsher kjo sevda?
Duke të ngarkuar fjalë të zakonshme në krahun tënd
Nëse e fluturoj drejt tij, a e merr pranë tij?

O
O Ins
O Insan
Ma shpalos mërinë mbi mërinë time
Ma shpalos dhimbjen mbi dhimbjen time
M'i depërto duart e tua prej pamuku në hallkat e zemrës sime
Nëse dëshiron këmbën tërhiqe pranë teje
Nëse dëshiron hidhe në tokë

Mustafa Islamoglu
Përktheu: **Artur Tagani**

Dua Mamin

Javën e kaluar, bëra një mbledhje me prindërit. Ndërsa po vazhdonin edukimin e tyre, patëm mundësinë të prezantoheshim me prindër të rinj, të cilët kishin marrë pjesë në mesin tonë, në mbledhje me prindër që kishim bërë dhe trajtonim tema të ndryshme. Fëmijët ishin shumë të gëzuar nga ardhja e nënave të tyre në shkollë, dhe më pas vazhduan të luanin me gëzim e hare. Përveç njërit, Serpilit.

Mamaja e Serpilit, për shkak se ishte në punë, nuk pati mundësi të vinte në mbledhje. Serpilin, e kishte mërzitur shumë, madje nuk kishte luajtur me shokun më të dashur të tij, Denizin dhe ishte ulur në një cep dhe ishte zhytur në botën e tij.

Më vonë, u takova me mamanë e tij, në lidhje me këtë çështje. Mamaja e tij tha se punonte që fëmija e saj të kishte një të ardhme më të mirë dhe se nuk donte që ai të kishte ndonjë gjëndje të ngushtë materiale. Gjithashtu ajo, rrëfeu se i kishte marrë lodra më të mira dhe rroba më cilësore dhe se i kishte siguruar atij të bano-nte në një shtëpi të mirë e të bukur. Ajo përpiqej t'i bënte të lumtur fëmijët me këto gjëra materiale, nga që nuk i shikonte fëmijët gjithëditën.

Një ditë Serpili erdhi në shkollë shumë i pikëlluar, po ta prekje, ishte gati në të qarë. Kur e pyeta për shkakun e kësaj, filloi të qante, e përqafova fortë, e çova në klasë dhe bisedova me të. Mua më tha kështu dhe kjo më mërziti shumë: "Mësuese, unë juve ju shikoj mëshumë sesa prindërit e mi." Një fëmijë gjashtë vjeçarduhet të kishte menduar shumë këtë çështje për të ma treguar këtë dhe duhet të ishte i shqetësuar nga kjo. Me të vërtetë kështu ndodhi. Kur po bisedonim ne, erdhi një prind tjetër dhe biseda jonë mbeti përgjusëm. Serpilit i thashë se doja të flisja pëesëri me të të nesërmen, dhe ai pranoi.

Serpili është i mençur, punëtor dhe një fëmijë i shoqërueshëm, nuk i nxirrte në plan të parë si rezultat i mungesës së dashurisë dhe me kalimin e kohës mbyllej në vetvete. Ndërsa, po mendoja të gjitha ato që kishte brenda, më erdhi në mendje një ide. Të regjistroja në magnetofon bisedën që do të bëja nesër me Serpilin. Dhe ashtu bëra. Serpili, gjatë bisedës qau dhe i tha të gjitha ato që kishte brenda, pa mbetur t'i thoshja ndonjë gjë. Gjëja më e rëndësishmë që tha ishte: "Madje edhe në reklama, i pyesin prindërit dhe u thonë, se cila është më e rëndësishme për ju puna, paraja, apo fëmijët tuaj. Gjëja më e rëndësishme për mamin dhe babin tim, është puna e tyre. Por unë dua mamin."

Të nesërmen thirra prindërit e Serpilit, duke u thëne se ka ndodhur diçka të rëndësishme dhe se duhet të vinin patjetër, dhe ata erdhën. Pas një bisede të shkurtër, hapa magnetofonin dhe kërkova prej tyre të dëgjonin. Pasi mbaruan fjalët në magnetofon, qëndruan, një moment, pa zë, panë njëri-tjetrin dhe mamaja e Serpilit filloi të qante. Fëmija, deri më sot, atyre nuk mund t'i thoshte këto gjëra, por duke u sjellur si fëmijë dhe duke bërë ndonjë prapësi, ka dashur t'i tërhiqte dashurinë dhe vëmendjen. Ndërsa mamaja, gjithnjë ankohej nga prapësitë dhe sjelljet si fëmijë, por nuk pyeste se pse i bënte këto veprime.

Atë ditë, morën leje nga puna dhe e kaluan ditën bashkë duke marrë edhe serpilin. Kurse në mbrëmje, pasi të flinte Serpili, kishin biseduar gjatë dhe kishin vendosur që mamaja e Serpilit të linte punën. Mamaja, të nesërmen, pasi solli Serpilin shkoi në vendin e punës, pronarit i tregoi gjëndjen dhe i tha se do të linte punën, por ai, nga që nuk donte të humbiste një punonjëse të mirë dhe kishte rregulluar, përsëri, orët e punës së saj. Kështu që në mes doli një tabllo që do të bente të kënaqur të gjithë. Që tani e tutje, edhe mamaja e Serpilit, si mamatë e fëmijëve të tjerë, vjen në kohën e daljes dhe atij i ndante më shumë kohë. Më e rëndësishmja është, që ajo ishte në dijeni se puna më e rëndësishme është të jeshë nënë (mama).

Përktheu: **Arjan Ymeraj**

Mjekësia në Egjiptin e lashtë

Në Egjipt ka shkolla që trajnojnë doktorë. Në Sais dhe Heliyoplis, janë gjetur rrënojat e shkollave të tilla. Regjistrimet mjeksore të mbetura nga ajo kohë, kanë siguruar suksesin e mëtejshëm në këtë fushë për brezat pasardhës. Ndërkohë, ata që kanë dhënë kontribute të mëdha në këtë qytetërim, janë hyjnëzuar nga vet bashkëkohorët e kryesisht nga brezat pasardhës dhe një sërë suksesesh u janë atriubuar këtyre hyjnive.

Feja ka një vend të rëndësishëm në zhvillimin e mjekësisë në Egjipt. Njerëzit, për të kërkuar shërim nga një perëndi që i besonin, shkonin në tempuj dhe këtu, me mjekimin e murgjëve, përpiqeshin të gjenin shërim. Me kalimin e kohës, ka patur njerëz që e kanë profesionalizuar këtë dhe këta kishin zënë vende të rëndësishme në pallatet mbretërore. Doktorët, të sëmurët i vizitonin falas, nga që ishin nënpunës të shtetit.

Veç kësaj, dihet se në Egjipt ka shkolla që trajnojnë doktorë. Në Sais dhe Heliyoplis, janë gjetur rrënojat e shkollave të tilla. Regjistrimet mjeksore të mbetura nga ajo kohë, sado të ndryshme e primitive të jenë dhe madje sado të përmbajnë metoda të gabuara mjekimi nga të sotmet, kanë siguruar suksesin e mëtejshëm në këtë fushë për brezat pasardhës. Ndërkohë, ata që kanë dhënë kontribute të mëdha në këtë qytetërim, janë hyjnëzuar nga vet bashkëkohorët e kryesisht nga brezat pasardhës dhe një sërë suksesesh u janë atriubuar këtyre hyjnive. Shembujt më të mirë për këtë janë Tot, Hwy, Seshet, dhe Imphotep. Imphotep, pranohet se është mjeku i parë i mirëfilltë i Egjiptit. Dokumentat që kanë arritur deri në ditët e sotme:

Feja ka një vend të rëndësishëm në zhvillimin e mjekësisë në Egjipt. Njerëzit, për të kërkuar shërim nga një perëndi që i besonin, shkonin në tempuj dhe këtu, me mjekimin e murgjëve, përpiqeshin të gjenin shërim.

1) Koleksionet e Chester Beatty: 1200 (p. k.)

2) Papisusi Medikal i Berlinit 1300 (p. k.) Sëmundjet e brendshme, kirurgji, gjinekologji.

3) Papirusi Medikal i Londrës: 1350 (p. k.) Bën fjalë për terapi me magji.

4) Papirusi Medikal i Erbesit: 1500, 877 (p. k.) Bën fjalë për recetat, diagnozë klinike dhe mbi kurimin e 47 sëmundjeve.

5) Papirusi Medikal i Hearstit: 1550 (p. k.) Kirurgji dhe ortopedi.

6) Papirusi Medikal i Edwin Smith (papirusi kirurgjikal): 1600 (p. k.) Në kapitullin kryesor bëhet fjalë për zemrën dhe sistemin e qarkullimit të gjakut, kurse në kapitullin kryesor bën fjalë për kirurgjinë. Ndërsa në kapitujt e tjerë, marrin pjesë njohuri mbi thyerjet, daljet, tumoret dhe veçanërisht mbi plagët në

kokë dhe në qafë, si dhe njohuri mbi mënyrën e kurimit prej tyre.

7) Papiruset e Ramesseumit. 2000 - 1785 (p. k.) Flet për lehonitë, fëmijët e sapolindur, reumatizmat dhe për disa sëmundje ngjitëse.

8) Papirusi Kahunik: 1900 (p. k.) Përfshin temat si gjinekologji dhe veterinari.

Veç kësaj, në shek. 28 (p. k.) në një tekst në lidhje me një vdekje, siç janë gjetur shkrime që i përkasin doktoratës, ashtu edhe jepet një informacion për ekzistimin e një kryemjeku. Ngjarja zhvillohet kështu:

"Mbreti Neferkere, shkon për të vizituar një ndërtesë që po bëhej në Thebes, ndërkohë kryeinxhinieri bie papritmas në tokë i pajetë. Sundimtari, menjëherë thërret t'i vijnë nga bibliotekat shkrime mjekësore si dhe kryemjekë. Këta të fundit bënë të ditur se kryeinxhinieri kishte vdekur."

Mësohet se, tekstet mjekësore e viteve 3000 (p. k.) janë fshehur në biblioteka. Por, asnjëra nuk ka mbërritur në ditët tona.

Degën e mjeksisë në Egjiptin e lashtë, mund ta studiojmë mbi tri themele:

1. Njohuri mbi trupin e njeriut dhe funksionet e tij.

Pavarësisht nga zhvillimi i balsamimit në këtë periudhë, nënkuptohet se nuk ka përparime të shumta në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me trupin e njeriut. Shkaku i kësaj është formimi i një klase të veçantë nga doktoraturat, që merren me balsamime. Doktorët janë interesuar shumë pak për organet e brendshme të trupit të njeriut. Veç kësaj, doktorët, për shkak se hulumtimet mbi trupin e njeriut ishin të ndaluara nga aspekti fetar, kanë marrë për bazë më shumë njerëzit e gjallë sesa anatominë. Zemra dhe zorrët pranoheshin si qendrat e inteligjencës. Ndërsa, eshtrat e skeletit, i kanë përshkruar pothuajse në përputhje me origjinalen.

Degën e mjeksisë në Egjiptin e lashtë, mund ta studiojmë mbi tri themele:

1. Njohuri mbi trupin e njeriut dhe funksionet e tij.

2. Llojet e sëmundjeve, plagët dhe kurimi i tyre.

3. Mjetet mbrojtëse nga sëmundjet.

Sipas papirusit Ebres, cilido organ të prekte doktori, aty ndiente ekzistencën e zemrës dhe lëvizjet e saj. Pranohej se funksiononte rregullisht, duke mbushur damarët e gjakut me ajër të pastër. Ajri i pistë ngurtësonte këto damarë, i bllokonte dhe i nxehtë. Ja pra, në këto momente të tilla, doktori me ilaçe përmirëson situatën, atyre u jep një gjallëri dhe elasticitet. Ndërsa në momentin e vdekjes, kur ky shpirt që jep jetë, del bashkë me zemrën dhe kur gjaku të lihet pa ajër mpikset dhe kështu që duke u zbrazur damarët njeriu, të cilit i merret fryma vdiste.

2. Llojet e sëmundjeve, plagët dhe kurimi i tyre.

Sëmundjet e banorëve të Egjiptit të lashtë, pothuajse janë të ngjashme me sëmundjet e njerëzve që jetojnë në Egjiptin e sotëm.

Sipas shkrimeve në papiruse dhe sipas rezultateve që dolën nga studimi i mumjeve, egjiptianët e lashtë u janë dorëzuar sëmundjeve të syrit, veremit të kockave, paralizës së fëmijëve, anemisë (dobësi), lisë, reumatizmës, sëmundjes së apandesitit, stomakut, barkut dhe fshikëzës, ulcerës dhe çibanit, çibanit të Nilit dhe flamës, prishjes së dhëmbëve dhe shumë sëmundjeve të tjera. Ekzistojnë edhe tekste që përfshijnë sëmundjet gjinekologjike dhe lindjet. Por, shumica e tyre është e mbushur me formula magjike.

Sëmundjet e dhëmbëve, janë zbuluar në mumjet më të vjetra. Ndërsa në mumjet që iu përkasin epokave të më vonshme, vihet re përdorimi i kurave. Si pasojë e këtyreve, mund të kuptojmë përparimin e mjekësisë. Në papirusin e Smithit, diagnoza dhe etapat e kurimit janë

Sipas papirusit Ebres, cilido organ të prekte doktori, aty ndiente ekzistencën e zemrës dhe lëvizjet e saj. Pranohej se funksiononte rregullisht, duke mbushur damarët e gjakut me ajër të pastër. Ajri i pistë ngurtësonte këto damarë, i bllokonte dhe i nxehtë. Ja pra, në këto momente të tilla, doktori me ilaçe përmirëson situatën, atyre u jep një gjallëri dhe elasticitet. Ndërsa në momentin e vdekjes, kur ky shpirt që jep jetë, del bashkë me zemrën dhe kur gjaku të lihet pa ajër mpikset dhe kështu që duke u zbrazur damarët njeriu, të cilit i merret fryma vdiste.

shpjeguar me detaje. Ndërsa në papirusin e Ebres, janë rekomanduar 700 ilaçe për shumë sëmundje.

Elementët që përdoren për ilaçe:

a) Çdo lloj bime që nga barishtet më të thjeshta e deri te pemët më të larta.

b) Ato që janë të tipit mineral, çdo lloj mineral dhe guri prej kripës së detit. Disa cilësi që ka guri memfis, janë shkruar dhe është regjistruar se një operacion kirurgjikal kryhet lehtësisht pa shkaktuar dhembje, kur ai vendoset në një pjesë të trupit.

c) Disa organe të kafshëve, në gjendje të gjallë, apo edhe gjakra të sapo thara, janë përdorur si ilaç. P.sh.: gjaku i hardhucës, dhëmbët dhe veshët e derrit, truri i breshkës dhe qumështi i gruas me lehoni janë më interesantet.

3. Mjetet mbrojtëse nga sëmundjet.

Egjiptianët, duke bërë kanalizacione, popullin e tyre e kanë mbrojtur nga shumë sëmundje. Pastërtisë, i kushtonin shumë rëndësi për shkak të besimeve fetare. Ndërsa gjendja e murgëve që dilnin nga mesi i doktorëve, ishte interesante. Flokët i prisnin një herë në tri ditë. Ndërsa larjes dy herë në ditë dhe dy herë në darkë, i ishin nënshtruar. Këta njerëz që veshin rroba të bardha, nuk hanin gjëra të papastërta, ujin e pinin të vluar dhe të filtruar.

Përktheu: **Arjan Ymeraj**



Arti i kaligrafisë

Vepra e durimit, mundit dhe qëndrueshmërisë

Stambolli, mbasi u çlirua nga Osmanët, u kthye në një qëndër të rëndësishme të artit të kaligrafisë. Kjo e vërtetë ka gjetur shprehjen më të bukur në këto fjalë "Kur'ani Kerim u zbrit në Hixhaz, u këndua në Egjipt dhe u shkrua në Stamboll." Për të mësuar kaligrafinë, e tërë bota Islame vraponin drejt Stambollit.

Fjala Hatt vjen nga Arabishtja dhe do të thotë "shkrim, vijë, gjurmë, rrugë". Ndërsa nga ana terminologjike përdoret për të treguar shkrimin estetik arab (husn-i hat), d.m.th. bukurshkrimin, i cili bazohet në rregulla dhe forma të caktuara. Kjo falë është cilësuar edhe si "gjeometri shpirtërore që merr formë prej veglave materiale". Në botën perëndimore, për të shprehur "husn-i hat" (bukurshkrimin) përdoret fjala calligrafy (kaligrafi).

Duke pasur parasysh se shkrimi arab para se të përhapej, por edhe mbasi të ishte përhapur ne Mekë dhe Medine, cilësohej me shumë emra. Fillimish ky shkrim njihej me emrin "xhezm". Në Medine duke marrë emrin "medeni" ndahet në dy stile të ndryshme. "Mail" që përbën grupin e shkronjave vertikale dhe të pjerrëta nga e djathta në të majtë dhe "meshk" që përbën grupin e shkronjave horizontale paksa të zgjatuara. Aliu (r. a.) pasi caktoi Kufen si qendër të shtetit Islam, shkrimi arab filloi të zhvillohet dhe mori emrin "kufi". Që nga kjo kohë fjala "kufi" është përdorur në mënyrë të përgjithshme për të shprehur edhe emrat "medeni" dhe "mekki" të cilat ishin përdorur që nga lindja e Islamit e deri në kohën e Abbasitëve.

Në periudhën Abbasite, në sajë të ministrit dhe hattatit (njeri që merret me hatt (bukurshkrim) të njohur Bagdatas, Ibn Mukle (v. 940) i cili arriti që me anë të diturisë së gjeometrisë, të cilën e zotëronte të caktojë me sukses përmasat kryesore të shkrimit, u arrit sistematizimi i shkrimit. Për të zbukuruar shkronjat, pranoi një standart të cakuar. Për pikat, elifin dhe rrethorët etj. Brenda këtyre përmasave arriti të vendosë rregullat e gjashtë stileve të shkrimit: Muhakkak, Rejhani, Sulus, Nesih, Tevki dhe Rika. Duke i përmbledhur në një emër te vetëm morën emrin "aklam-i sitte (gjashtë lapsa)"

Më vonë, përsëri nga dora e një tjetër kaligraf Bagdadas, Ali bin Hilal (v.1032) u perfeksionuan edhe më tepër. Ndërsa u zbukuruan nga rregullat që vendosi kalifi Abbasit, Yakut el-Mustasim (v.1298).

Më 1258, kur Abbasitët mbaruan së ekzistuari, përparësinë në shkrim e morën kaligrafët Turq dhe Iranian. Ndërsa Osmanët, në artin e kaligrafisë arritën të formonin një disiplinë (shkollë) që është vështirë të arrihet.

Në shekullin e XVI ai i cili është cilësuar edhe si babai i hattatëve Turko-Osman, Shejh Hamdullah i dha "aklam-i sittes" një bukuri dhe formë, që deri në atë kohë nuk ishte parë. Në kohën e Shejh Hamdullahit (v.1520), prej "aklam-i Sulus dhe Nesih, meqënëse u përshtatej më shumë gustove të turqve, njohu një përhapje të shpejtë saqë në shkrimin e mushafëve (Kur'an) filloi të përdorej vetëm shkrimi Nesih.

Në gjysmën e dytë të shekullit XVII, Hafiz Osman (v.1698), duke e rishikuar metodën e shkrimit të Shejh Hamdullahit, vendosi një metodë hati të vetën. Ndërsa një shekull më vonë Ismail

Në kaligrafi, përputhja dhe bukuria qëndron para lexueshmërisë. Por kjo nuk lejon pakuptimshmërinë. Arti i kaligrafisë, arrin estetikën pa lëshuar pe në përmasat delikate.

Arti i kaligrafisë ka ekzistuar dhe do të ekzistojë bashkë me fenë Islame.

Zyhdy (v. 1806) dhe vëllai i tij Mustafa Rakëm, duke u frymëzuar nga ai, formuan metodën e vetë. Edhe ustai i "xheli" Sami Efendi që vjen mbas Rakëmit, duke i aplikuar shkronjat "sulus" të Ismail Zyhdyit në "xheli", i dha metodës se Rakëmit një formë të re.

Mësuesi është vëtëm një tregues i rrugës. Përvojën që ka fituar ia trasmeton nxënësit me fjalë apo me shembuj. Ndërsa nxënësi, arrin sukses në atë masë sa ka punuar dhe zbatuar këto fjalë.

Stambolli, mbasi u çlirua nga Osmanët, u kthye në një qendër të rëndësishme të artit të kaligrafisë. Kjo e vërtetë ka gjetur shprehjen më të bukur në këto fjalë "Kur'ani Kerim u zbrit në Hixhaz, u këndua në Egjipt dhe u shkrua në Stamboll." Për të mësuar kaligrafinë, e tërë bota islame vraponin drejt Stambollit.

Një vështrim edukatës së kaligrafisë.

Arti i kaligrafisë, aq sa kërkon aftësi, kërkon edhe dëshirë. Rakëm Efendi është diplomuar në moshën 12 vjeçare. Ky është një shembull i aftësisë. Por dituria nuk njeh moshë. Duke qënë i durueshëm dhe duke dhënë shumë mund e punë, më në fund mund të arrish sukses. Mësuesi është vëtëm një tregues i rrugës. Përvojën që ka fituar ia trasmeton nxënësit me fjalë apo me shëmbuj. Ndërsa nxënësi, arrin sukses në atë masë sa ka punuar dhe zbatuar këto fjalë. Çdo zanat është zbulimi i një aftësie. Në të njëjtën kohë kjo është edhe një arsye për të edukuar shpirtin.

E fillojmë meshkën duke thënë: "Bismilah, Rabbi jes'sir". Më pas, duke provuar shumë herë, në mendje e në dorë na nguliten përmasat më elegante dhe të bukura. Nxënësit, që i është stërvitur shpirti dhe dora, tashmë i ka ardhur koha të marrë diplomën. Tashmë ai është në gjendje të japë vepra që u drejtohen zemrave dhe shpirtrave. Rruga e shkrimit është si një zambak. E bukur dhe e gjatë...

Edhe leximi është sikur t'i marrësh erë këtij zambaku. Në kaligrafi, përputhja dhe bukuria qëndron para lexueshmërisë. Por kjo nuk lejon pakuptimshmërinë. Arti i kaligrafisë, arrin estetikën pa lëshuar pe në përmasat delikate. Kjo pra, është edhe ana më e vështirë e kaligrafisë. Arti i kaligrafisë ka ekzistuar dhe do të ekzistojë bashkë me fenë Islame. Ashtu sikur jeta ka zbritjet dhe ngritjet e saj edhe arti i kaligrafisë, herë pas here, ka patur rënie dhe shkëlqimet e tij. Por, si do që të ndodhë, ai gjithmonë do të ekzistojë.

Përktheu: **Ilir Hoxha**

Liria e mendimit të mos ngjallë urrejtje!

Liderët që shqyrtojnë krizën e krijuar nga karikaturat, theksojnë se liria e mendimit duhet të mos bëhet shkak urrejtje. Në këtë mbledhje, në kryeqytetin Doha të Katarit morën pjesë sekretari i përgjithshëm i OKB-së Kofi Anan, i cili njëkohësisht ishte drejtues i mbledhjes, dhe me ftesën e tij morën pjesë gjithashtu edhe ministri i punëve të jashtme të Turqisë Abdullah Gyl, sekretari i përgjithshëm i lidhjes arabe Amër Musa, sekretari i përgjithshëm i Këshillit Islamik, Ekmeltin Ihsanoglu, ministri i punëve të jashtme të Spanjës Miguel Moratinos dhe ai i Katarit Shejh Hamad et-Tani, të cilët ishin të mendimit se "liria e të mënduarit duhet të mos ngjallë urrejtje".

Anan, për shkak të krizës së karikaturave që ka sjellë përçarje ndërmjet qytetërimeve, bëri thirrje për mirkuptim dhe qytetërim. Ai theksoi se vlera e lirisë së mëndimit është universale dhe urrejtja ndaj saj të mos përhapet, të mos përdoret si mjet poshtërimi; dhe të gjithë ne duhet ta përdorim të drejtën në mënyrë të ndërgjegjshme.

Anan tha se muslimanët, për shkak të karikaturave, janë prekur jashtë mase. Ndërsa pjesa më e madhe e protestave u zhvilluan në mënyrë paqësore.

Zjarri i ngacmuar po përhapet.

Ndërsa lideri shii Sader, thërriste për drejtësi, fjalët e El-hakemit: "Këmbëngulësit kanë vrarë 80.000 shii", kanë mbledhur reagime.

Liderët suni dhe shii kërkojnë bshkëpunim.

Për shkak të sulmit kundër tyrbes El-askeriye, të cilën muslimanët irakienë e quajnë si të shenjtë, mosmarrveshjet ndërmjet grupëve shiite dhe sunite janë acaruar. Dhuna dhe urrejtja nuk mund të frenohën. SHBA, për ngjarjet e fundit ngriti shqetësimin që ka ndodhur si pasojë e sulmimit ndaj tyrbes El-askeriye dhe tha se ngjarja mund të shkaktojë probleme edhe për shtetet e tjera. Është frikë, që për shkak të tensionit të lartë, problemet të përhapen edhe në rajon. Shiitë kanë filluar protestat në Pakistan, Kashmir dhe Iran. Në qytetet Bagdat, Kerbela dhe Dijala, për një ditë janë vrarë afërsisht 40 persona.

Dari tha që kjo është një luft e brëndshme. Kryetari i lidhjes së dijetarëve suni Haris

ed-Dari, duke e quajtur fajtor qeverinë e Bagdatit, tha se në njërën anë kjo është një luftë e brendshme që është shpallur. Prapa kësaj skene janë forcat e qeverisë, para shtëpive tona ishin forcat e qeverisë.

Bashkëpunim kundër dhunës

Liderët e grupëve suni dhe shii, kanë bërë thirrje për bashkpunim në lidhje me sulmin kundër xhamive dhe të pengohet vrasja e anëtarëve të sekteve të tjera.

Në xhaminë Ebu Hanife të qytetit Bagdat u takuan përfaqësuesit e Mukteda Saderit, lidhja e dijetarëve suni dhe anëtarët e frontit pajtues të Irakut, me liderin shii Xhevat el-Harisi. Pas takimit, Abdusselam Kubejsi, më anë të një sqarimi me shkrim, qorton lidhjen e dijetarëve suni për shkak të sulmeve që u janë bërë vëndeve të shenjta. Në këtë sqarim të dyja palët ranë dakord për ndalimin e vrasjeve të shiive dhe sunive. Ndërkohë, Sader, u ka ndaluar veshjen e rrobave të zeza pjesëtarve të ushtris se Mehdiut.

Me iniciativën e kryetarit të Bashkësis Islame të Turqisë Prof. Dr. Ali Bardakoglu dhe antarëve të këshëllit Islamik të Euroazisë do të shkojnë në Irak ku do të takohen me liderët e xhemateve. Shkak i kësaj vizite janë mosmarrëveshjet që kanë nisur ndërmjet sekteve. Kjo mbledhje duhët të jetë shkas që të bëhët armëpushim ndërmjet tyre, të ndalet dhuna që ka kapluar vendin dhe më anë të kësaj të ndertohet demokracia në Irak.



Bosnje

Milosheviçi vdiq, por sistemin që ka formuar me anë të gjenocidit është ende në fuqi.

Ish kryeministri i Bosnjës Haris Slagjiq ka kritikuar rreptësisht mospërfilljen e Unionit Ndërkombëtar ndaj vazhdueshmërisë së sistemit të formuar në Bosnje me marrëveshjen e Dejtonit. Politikani boshnjak Slagjiq, ka vlerësuar zhvillimin e diskutimeve të marrëveshjes së Dejtonit, e cila po shqyrtohet në Washington me shpresë të ndryshojë. Ai thotë që "Marrëveshja e Dejtonit" është marrëveshje e bërë nën presion. Në Bosnje është bërë gjenocid dhe të gjithë prisnin paqe. Edhe pse nuk ka qenë e drejtë marrëveshja, të gjithë janë detyruar ta pranojnë atë. Në atë kohë ishte më shumë e nevojshme paqja se sa drejtësia.

Slagjiq, duke shtruar pyetjen "Pse është ende marrëveshja në tryezë që prej 10 vitesh?"I përgjirgjet kështu: "Sepse është e

vështirë të ndryshohet." Nuk është e natyrshme ndarja e Bosnjës në dy pjesë; Regjimi i Beogradit duke përdorur forcën ka bërë gjenocid.

Millosheviçi që ishte në krye të regjimit vdiq në Lahej, por projekti i tij akoma është në fuqi.

Në lidhje me marrëveshjen e Dejtonit i është bërë një pyetje në të cilën thuhet: "Kujt i është bërë më shumë shtypje në Dejton?". "Tani ka kaluar koha të flitet për këtë çështje" përgjigjet Slagjiq dhe thekson se këto shtypje kanë filluar që nga shtatori i vitit 1991. Kombet e Bashkuara, duke vënë sanksione, na ka detyruar që ta mbajmë veten. Më pas Millosheviçit i është dhënë e drejta e çdo veprimi kundër nesh. Në të vertetë "Marrëveshja e Dejtonit" nuk është nënshkruar në Dejton, por para shumë kohësh. Marrëveshjet janë bërë sipas fushëbetejës.

"Marrëveshja e Dejtonit" është marrëveshje e bërë nën presion. Në Bosnje është bërë gjenocid dhe të gjithë prisnin paqe. Edhe pse nuk ka qenë e drejtë marrëveshja, të gjithë janë detyruar ta pranojnë atë. Në atë kohë ishte më shumë e nevojshme paqja se sa drejtësia.

Serbëve i ka konvenuar ndërhyrja e Amerikës

Deri diku është e saktë, se ndërhyrja e Amerikës në Bosnjë eshtë vlersuar pozitivisht edhe nga serbët. E para punës ndërhyrja është e vonuar. Por, është e vërtetë që kanë dashur paqe. Të gjithë janë lodhur nga kjo gjë. Kjo gjë, nga që është bërë problem edhe për perëndimin, është marrë vëndim për paqe. Por, shteti në mënyrë të padrejtë është ndarë. Ai theksoi se në kohën kur forcat tona po merrnin përfundime pozitive është bërë ndërhyrja e përëndimit.

Përktheu : **Alija Barlovic**

U hodh në treg Kur'ani më i vogël

Kohët e fundit doli në treg Kur'ani më i vogël në botë, i cili është prodhuar më anë të një mikroçipi me përmasa 11x18 milimetra. Libri i shënjtë është projektuar në formë gjerdani dhe krijon lehtësi të mbahet i tëri. Çmimi i këtij produkti varjon nga 150 $ e sipër.

Masa e produktit "Nano Teknologji" është sa një e miliarda e metrit. "Gold Antalya" në një panair ka ekspozuar varse, serm, xhevahir, orë si dhe Kur'anin më të vogël në botë, ku u ka tërhequr vëmendjen shumë vizitorëve. Firma "Art Bulut" që ka zhvilliuar Kur'anin e kristaltë me varsë bënë të mundur që çdo njëri që e vëndosë në trup të jep atmosferë shpirtërore (mistike).

Sonmez pasi tregon se produkti është ekspozuar për herë të parë në Antalja thotë: "Kohët e fundit vlerat fetare kanë filluar të dalin në plan të parë. Produktin e kemi bërë në mënyrë të veçantë dhe mendojmë që ta ekspozojmë edhe në vendet e tjera muslimane."

Siemensi ka zhvilluar një sistem për parkimin e automjeteve

Siemensi ka zhvilluar një sistem për parkimin e makineve, i cili sapo të gjejë vend të lirë, në mënyrë automatike, parkohet vetvetiu. Inxhinierët e firmës Siemens kanë zhvilluar një sistem, që krijon lehtësim tek shoferët që kanë probleme për parkimin e automobilave të tyre. Ky sistem i ri mundëson që makinat të parkohen vetvetiu. Testimi që iu bë sistemit në Gjermani, përcakton fushën e lirë për parkim.

Si një pilot automatik.

Sipas këtij sistmi, shoferi sapo të afrohet në zonën ku do të parkohet, kontrolli i makinës, vetvetiu, drejtohet nga piloti automatik. Piloti automatik, duke bërë disa manevrime, makinën, e bën të lëvizë në drejtim vertikal të anës së shasisë. Parkimin që do të bëjë makina, edhe sikur të jetë i ngushtë vendi, mund të futet pa problem. Sistemi që përbëhet nga vëzhgues nate, kamer termike, censorë dhe kompjuteri, gjatë manovrimit gabim, i jep dridhje timonit ose ndizet alarmi.

Kutija e zezë edhe për automjetet

Të rinjët e Middle East Technical University në Turqi, kanë zhvilluar një mjet, që vrojtohet për 24 orë më anë të kamerave pas montimit të tyre në automjet. Mjeti që quhet "Auto Cam" pasi të vëndoset në automjet regjistron ngjarjet, e veçanërisht përplasjet e makinave. Studenti i universitetit Middle East Technical, në fakultetitin inxhinieri në vitin e dytë i quajtur Deniz Can Erday në bashkpunim me studentin e fakultetit ekonomik Bahadir Ozdemir.

Studenti që është në vitin e dytë në fakultetin inxhinierik të universitetit Middle East Technical, quhet Deniz Can Erday dhe në bashkpunim me Bahadir Ozdemir student në fakultetin ekonomik vlersojnë lart punën e këtij aparati që xhiron pamjet gjatë kohës që automjeti është në lëvizje. Deniz Can Erfay pasi që ka fituar garën, Middle East Technical University, atij i ka dhë-në një zyrë për të bërë kërkime në "research and development" të Teknosit. "Auto Cam" bën të ditur se ky projekt do të vihet në jetë brenda një kohe të shkurtër.

Sistemi i kamerave aktivizohet më ndezjen e makines dhe pamjet e xhiruara prej këtij sistemi regjistrohen në kartën e makinës ose në hard disc. Gjithshtu më anë të sistemeve të zhvilluara GSM / GPRS pamjet që janë xhiruar mund të shihen më anë të kompjuterave. Po ashtu me anë të internetit mund të bëhet e ditur shpejtësia e levizjes se automjetit. Erday pohon vendosjen e muduleve të reja në aparat dhe thotë, se me anë të skanimit të shënjave të gishtrinjve që do të ndezë makinën, mund të përcaktohet fare lehtë përdoruesi i automjetit.

Pas internetit edhe televizorin do ta kini në xhep

Televizori po hyn në celular

Disa pohojnë, se në të ardhmen njerëzit nuk do të dëshirojnë të shikojnë televizor. Për këtë arsye firma celulare Nokia dhe përfaqësuesit e firmës Endemol, bënë marrëveshje për Celular TV. Të dy firmat janë të mendimit se, Celular TV, në tregun e konsumatorëve do të bëhet hiti i tyre.

Zv/drejtori i firmës Nokia, Mark Selby pohon se, me anë të internetit, televizori mund të shitet më lehtë. Puna e mirë e tij mbështetet me anë të analizave. Firma e këshillit teknologjik Strategy Analytics supozon se deri në vitin 2009, rreth 50 milion vetë do të përdorin Celular TV dhe do të ketë 8 miliard €.